



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Rehabilitim
Fizioterapeutik në Sport”**

ofruar nga

Universiteti i Sporteve të Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Irena KOLA

Prof. Asoc. Fatjona KAMBERI

Qershor / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Sporteve të Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Kineziologjisë (Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 446, datë 14.08.2023.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	N/A
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 Kredite
11	Forma e studimit:	Kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2023-2024: 13/1 PAE/PAK
18	Numri i studentëve:	2023-2024: 23
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST) është një Institucion publik i Arsimit të Lartë. UST është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 123, datë 17.02.2010. Institucioni është krijuar mbi bazën e Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”, e krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 266, datë 25.05.2000, dhe mbi bazën e Institutit të Lartë të Kulturës Fizike “Vojo Kushi”, e krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 394, datë 14.09.1960.

Universiteti i Sporteve të Tiranës është institucion publik i arsimit të lartë, me karakter akademik, shkencor dhe sportiv, me status të veçantë, VKM Nr. 57, datë 29.01.2020. UST, si institucion i arsimit të lartë, zhvillon veprimtari akademike në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fushën e edukimit fizik dhe shëndetësor, sporteve, rekreacionit, turizmit sportiv dhe rehabilitimit.

Universiteti i Sporteve të Tiranës përbëhet nga 4 (katër) njësi kryesore dhe 12 (dymbëdhjetë) njësi bazë dhe ofron programe studimi në tri cikle.

Njësitë Kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranës janë:

- 1) Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes;
- 2) Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit;
- 3) Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit;
- 4) Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit.

Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, ku ofrohet dhe programi i studimit Master Profesional “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”, ka në përbërje 3 departamente:

1. Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane;
2. Departamenti i Rehabilitimit;
3. Departamenti i Kineziologjisë.

Departamenti i Kineziologjisë (DK) është njësi bazë që ofron programin e studimit Master Profesional “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”. Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit është në raportin 13/1 PAE/PAK përkatësisht: 3 PAE me titull Profesor Doktor, 6 PAE me titull Profesor i Asociuar, 4 PAE Lektor me gradën Doktor/Docent dhe 1 PAK me titullin Profesor i Asociuar.

Programi i studimit Master Profesional “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” ofrohet që prej vitit 2023, bazuar në UMAS Nr. 446, datë 14.08.2023 dhe i përket nivelit shtatë (7) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” që ofrohet nga Departamenti i Kineziologjisë (DK) i Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit, në Universitetin e Sporteve të Tiranës (UST), filloi me marrjen e dokumentacionit të ofruar nga Institucioni, si dhe ndarjen e punës për vlerësimin e dokumentacionit, përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë. ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UST, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Në kuadër të procesit të jashtëm të vlerësimit, është përgatitur agjenda nga ASCAL dhe është kryer vizita në datat 27-28 Janar 2025. Dy ekspertët e përzgjedhur shoqëroheshin nga një specialist i ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm kishte në përbërje **Prof. Dr. Irena Kola dhe Prof. Asoc. Fatjona Kamberi**. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Msc. Arbri Ndreka.

Bazuar në agjendën e përgatitur nga ASCAL, u zhvilluan takimet me: Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit, Përgjegjësën e Departamentit të Kineziologjisë, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të angazhuar në programin e studimit, studentët e programit të studimit dhe vizita në sekretarinë mësimore. Ditën e dytë të vizitës institucionale, u zhvilluan takimet me përfaqësues të: Sektorit të Burimeve Njerëzore, Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Marrëdhënieve me Studentët, Komisionit të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore dhe Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave. Paralelisht, u zhvillua vizita në ambientet e institucionit, që konsistoi në vëzhgimin e infrastrukturës, përfshirë auditorët, laboratorët, shërbimet për studentët dhe vizitën në bibliotekë. Kohëzgjatja e takimeve dhe veprimtarive të tjera u zhvillua sipas parashikimeve në agjendë.


Me përfundimin e takimeve, GJV takoi Drejtuesin e Departamentit, ndërsa eksperti i ASCAL do të informonte koordinatoren Institucional mbi nevojën për dokumenta shtesë. Në përfundim të vizitave, ekspertët, në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, takimeve të zhvilluara, si dhe vizitës në ambientet e Institucionit, hartuan Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti i Sporteve të Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 21.05.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr.11/5 Prot, datë 21.05.2025. IAL njofton në ASCAL më datë 27.05.2025, me anë të shkresës me Nr. 1374/1 Prot, datë 26.03.2025 “Kthim përgjigje për Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST) është një institucion publik i arsimit të lartë, i pavarur, i akredituar, me karakter akademik, shkencor dhe sportiv, me status të veçantë që prej vitit 2022. Sipas Statutit dhe Rregullores së UST-së, të gjitha programet e studimit të ofruara, përmes fokusit akademiko-olimpik, janë në funksion të promovimit të sportit elitare në Shqipëri dhe rajon, në mbrojtje të interesave kombëtare, në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në garantim të autonomisë universitare dhe lirisë akademike <i>Ref. 3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	UST-së ka si vizion të jetë dhe mbetet qendra model e arsimit të lartë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter akademik, shkencor e sportiv, me status të veçantë, i njohur me ligj si i tillë. Në përputhje me misionin e tij, UST ofron programe studimi të të gjitha cikleve, përfshirë programe me karakter profesional në fushën e edukimit fizik dhe sporteve, aktivitet fizik për shëndet, menaxhim sportiv, rekreacion dhe rehabilitim. Programi i Ciklit të Dytë të studimeve Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” ka për qëllim formimin e specialistëve dhe profesionistëve të fizioterapisë, të aftë të zotërojnë njohuri dhe aftësi profesionale në trajtimin fizioterapeutik të pacientëve të traumatizuar të ekipeve sportive, shërbimeve primare, sekondare dhe terciarë, me drejtim traumatologjik, ortopedik dhe kirurgjik. Fusha e veprimtarisë së programit të studimit përfshin gjithashtu rritjen e kompetencave profesionale të fizioterapistëve me trajtimet specifike të specializuara, si mjekësia sportive, patologjitë osteomuskulare, menaxhimin e dhimbjes, nutricionin sportiv dhe kontrollin fizioterapeutik në sport, në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit.



	<i>Ref. 3. Statuti i Universitetit te Sporteve;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Sipas strategjisë së UST-së, objektivi kryesor është formimi i profesionistëve të aftë, me përgatitje rigoroze akademike dhe kërkim shkencor të thelluar përmes qasjes edukative me studentin në qendër. Programet e studimit në UST synojnë konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare përmes kualifikimit akademik dhe shkencor në fushën e edukimit fizik, shëndetësor dhe sporteve, veprimtarisë fizike, shëndetit, rekreacionit, turizmit, menaxhimit sportiv dhe rehabilitimit, thellimin e kualifikimit profesional dhe shkencor të specialistëve të lartë në këto fusha, ofrimin e shërbimeve ndaj të tretëve dhe konsulencë në fushën e veprimtarisë së edukimit fizik, shëndetësor dhe sportiv, si dhe përgatitjen dhe stërvitjen e sportistëve elitare. Rregullorja e Programit të Ciklit të Dytë të studimeve Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” ka të përcaktuara qartë objektivin, qëllimin, bazën ligjore dhe normativën e funksionimit të programit. Rregullorja e programit dëshmon se programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të Statutit dhe Rregullores së UST-së, në përputhje me Planin Strategjik të institucionit. Ky fakt u konfirmua edhe nga takimet me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë gjatë vizitave në institucion. <i>Ref. 3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref. 4. Plani Strategjik FSHR 2021-2026;</i> <i>Ref. 4.1. Plani strategjik UST 2021-2026;</i> <i>Ref. 4.2. Plani Strategjik UST 2021-2025;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>-Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës	Programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” është zhvilluar në përputhje me strategjitë kombëtare. Ai ofrohet sipas vizionit dhe strategjisë për mbështetje të interesave kombëtare, duke siguruar mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe mësimi gjatë gjithë jetës. Gjithashtu, ai kontribuon në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke integruar kërkimin shkencor në ambientin akademik dhe nxitur bashkëpunimet, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, siç është përcaktuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë

vendas dhe atë ndërkombëtar.	22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Programi është krijuar pas një analize të detajuar të tregut të punës në nivel global, duke u mbështetur në bashkëpunimin dhe partneritetin institucional me Federatën Shqiptare Sportive, Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, universitetet partnere brenda dhe jashtë vendit, si dhe informacionet nga Federata Ndërkombëtare e Fizioterapisë Sportive. Ky program ka si qëllim zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve të fizioterapisë sportive profesionale në nivele të ndryshme shërbimesh, si qendra spitalore, klinika private, fizioterapeutike dhe klube sportive. <i>Ref. 3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref. 4. Planit Strategjik FSHR 2021-2026;</i> <i>Ref. 4.1. Planit strategjik UST 2021-2026;</i> <i>Ref. 4.2. Planit Strategjik UST 2021-2025;</i> <i>Ref. 4.3. Studimi i tregut të punës;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 10. Ligji i Arsimit të Lartë;</i> <i>-Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë.</i>			
Konkluzione	<i>Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST) është një institucion publik i pavarur dhe i akredituar, me karakter akademik, shkencor dhe sportiv. Me status të veçantë që prej vitit 2022, UST promovon sportin elitë në Shqipëri dhe rajon, duke mbrojtur interesat kombëtare dhe garantuar autonominë universitare dhe lirinë akademike, në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. UST ka vizion të jetë qendra model e arsimit të lartë, duke ofruar programe studimi në fushat e edukimit fizik, sporteve, menaxhimit sportiv dhe rehabilitimit. Programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” synon formimin e specialistëve të fizioterapisë për trajtimin e pacientëve të traumatizuar në sport, duke ofruar njohuri dhe aftësi profesionale në fushat e mjekësisë sportive, patologjive osteomuskulare, menaxhimit të dhimbjes etj. Programi i studimit është i hartuar në përputhje me misionin, qëllimet, rregulloret dhe strategjinë e UST-së, duke ofruar mundësi për zhvillim profesional dhe shkencor për të gjithë studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X



Standardi I.2					
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.					
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	I krijuar mbi baza solide dhe tradita, fillimisht Institutit të Lartë të Kulturës Fizike "Vojo Kushi" (Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.394, datë 14.09.1960), më pas Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve "Vojo Kushi" (Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.266, datë 25.05.2000), UST është institucion me përvojë dhe kapacitetet e burimet e duhura në fushën akademike përkatëse për ofrimin e Programit të Studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport". Ndërkohë, që zanafilla e institucionit është edhe më e hershme, që përkon me hapjen e "Degës së Edukimit Fizik" në vitin 1958 pranë Institutit dyvjeçar Histori-Filologji. Me një histori rreth 65-vjeçare, UST është një institucion i arsimit të lartë i akredituar (Akredituar me VBA Nr. 2, datë 07.01.2022), që disponon infrastrukturën e nevojshme dhe të mjaftueshme për ofrimin e programit të studimit Master Profesional "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport". Dokumentacioni i dorëzuar dhe vizita në mjediset e institucionit konfirmojnë këtë fakt. Aktualisht, UST ka në përbërje të tij 4 Fakultete dhe Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit (FSHR) përmes Departamentit të Kineziologjisë, janë përkatësisht njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit. Ndërkohë, programi i studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" mbështetet gjithashtu edhe nga Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane dhe Departamenti i Rehabilitimit, pjesë përbërëse të FSHR. Njësia kryesore që ofron këtë program studimi ka gjithsej të angazhuar 9 Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe në nivel programi studimi gjithsej 14 personel akademik të angazhuar, ku 13 janë Personel Efektiv Akademik (PAE) dhe 1 është Personel Akademik me Kontratë (PAK), me shpërndarjen e mëposhtme: <table border="1"> <tr> <td>Kategoria tituj/grada</td><td>Personel akademik në Nivel njësie Kryesore (FSHR)</td><td>Personel akademik në nivel programi studimi</td></tr> </table>		Kategoria tituj/grada	Personel akademik në Nivel njësie Kryesore (FSHR)	Personel akademik në nivel programi studimi
Kategoria tituj/grada	Personel akademik në Nivel njësie Kryesore (FSHR)	Personel akademik në nivel programi studimi			

	Personel Akademik Efektiv (PAE)	Personel Akademik Efektiv (PAE)	Personel Akademik me Kontratë (PAK)
Profesor Doktor	2	3	
Profesor i Asociuar	4	6	1
Lektor me gradën Doktor/Docent	3	4	
Asistent Lektor	0		
Gjithsej	9	13	1

Ref. 3. Statuti i Universitetit të Sporteve;
Ref. 7. Rregullore UST;
Ref. 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore;
Ref. 23.1. Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit;
Ref. 23.5. Të dhëna tabelore për infrastrukturën, laboratore;
Ref. 23.5.1. Të dhëna për infrastrukturën;
Ref. 23.6. Të dhëna tabelore për infrastrukturën mbështetëse për procesin mësimor;
Ref. 31.1. Rregullore e DK.

Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	UST është i vetmi Institucion publik i Arsimit të Lartë në Shqipëri që ofron programe studimi në fushën e edukimit fizik dhe sporteve, aktivitetit fizik për shëndet, menaxhimit sportiv, rekreacionit dhe rehabilitimit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit (FSHR), i cili ofron këtë program studimi. FSHR ka në përbërje 3 departamente, përkatësisht: 1) Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane, 2) Departamenti i Rehabilitimit dhe 3) Departamenti i Kineziologjisë, i cili është edhe departamenti përgjegjës për programin Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”. Sipas Statutit dhe Rregullores së UST, të gjitha programet e studimit që institucioni ofron hartohen në strukturë dhe përmbajtje në përputhje me standardet e parashikuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane, në respektim të kornizës shqiptare të kualifikimeve. Programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në
---	--

	Sport” i përket nivelit shtatë (7) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Planet mësimore dhe modelet e programit të studimit pjesë e dokumentacionit të vlerësimit, dëshmojnë se programi i studimit ka të gjitha elementët e klasifikimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Por në rregulloren e FSHR ishin të përfshira vetëm programet e ciklit të parë të studimeve dhe nuk kishte të dhëna për mënyrën e organizimit dhe strukturën e programeve të ciklit të dytë. Për këtë, sugjerohet të bëhet përditësim i rregullores ku të integrohet informacion për mënyrën e organizimit dhe strukturën e programeve të ciklit të dytë që tashmë ofrohen nga kjo njësi kryesore. <i>Ref. 3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 8. Rregullore FSHR;</i> <i>Ref. 5. VKM Nr 41 IAL 24.01.2028;</i> <i>Ref. 14. Plan i mësimor 2023-2024;</i> <i>Ref. 23.4. Tabela përmbledhëse, model programi.</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Departamentit të Kineziologjisë, njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Programi i studimit zhvillon veprimtarinë e tij në bazë të parimeve të lirisë dhe cilësisë akademike, duke u bazuar në objektivat strategjike të departamentit, të cilat janë përgatitja e specialistëve të aftë për të përballuar sfidat në fushën e rehabilitimit fizioterapeutik dhe bashkëpunimi me institucione rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare të mësimit dhe kërkimit. Fusha e përgjithshme e programit të studimit është në përputhje edhe me programet e ofruara nga departamentet e tjera të FSHR, të cilat bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për përmbushjen e objektivave që lidhen me programet e studimit që ofrohen, përfshirë programin e studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”. Edhe pse programi i studimit nuk është një program ndërdisiplinor, marrëveshjet e bashkëpunimit me Federatën Kombëtare të Futbollit dhe klubet sportive, kryesisht për zhvillimin e praktikave profesionale, janë dëshmi e fushës së gjerë të veprimtarisë së këtij programi në rehabilitim sportiv. Ky fakt u konfirmua edhe nga

	studentët dhe stafi akademik i angazhuar në programin e studimit gjatë vizitës në institucion. <i>Ref. 3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 23.2. Të dhëna tabelore për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e DK;</i> <i>Ref. 31. Rregullore e DSHBH;</i> <i>Ref. 24.1. Marrëveshje bashkëpunimi me Federatën Kombëtare të Futbollit;</i> <i>Ref. 24.2. Marrëveshjet me klubet sportive për organizimin e praktikave profesionale;</i> <i>-Vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin akademik të angazhuar në programin e studimit.</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Jo e aplikueshme.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	UST raporton se zhvillon rregullisht aktivitete trajnuese në bashkëpunim me punëdhënësit, kryesisht me Federatën Kombëtare të Futbollit dhe klubet sportive. Institucioni organizon aktivitete të ndryshme si për studentët aktualë dhe për të diplomuarit, dhe ka marrë pjesë aktive në Panairin Work and Study. Ndërkohë, raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit evidenton rritjen e mundësive të studentëve për trajnimet dhe punësimet me federatat dhe klinikat e fizioterapisë në fushën e rehabilitimit. Zhvillimi i aftësive praktike, profesionale dhe eksperiencës për studentët që ndjekin programin e studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” mundësohet edhe nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në projekte shkëmbimi dhe kërkimore-shkencore. Organizimi i aktiviteteve që mbështesin trajnimet profesionale të mëtjshme të studentëve u konfirmua dhe në takimin e zhvilluar me autoritetet drejtuese, stafin akademik dhe vetë studentët që ndjekin programin e studimit, ku pjesa më e madhe e të cilëve kishin ndjekur në UST edhe ciklin e parë të studimeve.

	Ref. 29. Kalendar i aktiviteteve FSHR për vitet 2023-2024; Ref. 24.1. Marrëveshje bashkëpunimi me Federatën Kombëtare të Futbollit; Ref. 24.2. Marrëveshjet me klubet sportive për organizimin e praktikave profesionale; Ref. 25. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit; Ref. 25.1. Raport mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, projekti E - PHYSIO; -Vizita në institucion, takimi me autoritetet drejtuese, studentët dhe stafin akademik të angazhuar në programin e studimit.			
Konkluzione	UST, me një histori rreth 65-vjeçare, ka kapacitetet akademike dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e programeve akademike, përfshirë programin Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport". UST ka në përbërjen e vet 3 Njësi Kryesore, përfshirë Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit. FSHR ka në përbërje 3 departamente, përkatësisht: 1) Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane, 2) Departamenti i Rehabilitimit, dhe 3) Departamenti i Kineziologjisë, i cili është edhe departamenti përgjegjës për programin e studimit. Në nivel programi studimi janë të angazhuar gjithsej 14 persona akademikë, ku 13 janë PAE dhe 1 është PAK. Pavarësisht kapaciteteve dhe traditës, institucioni ka nevojë për përmirësim në mbështetje të mësimdhënies dhe përditësimin e rregullores së FSHR për të përfshirë edhe programet e ciklit të dytë. Ky program përgatit specialistë për rehabilitimin fizioterapeutik në sport, duke bashkëpunuar me institucione si Federata Kombëtare e Futbollit dhe klube sportive dhe ofron mundësi shkëmbimi, punësimi dhe pjesëmarrje në projekte kërkimore-shkencore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit,	Hartimi, mbikëqyrja dhe mbarëvajtja e programit të studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" mundësohet në radhë të parë nga njësia bazë që e ofron atë, përkatësisht

siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Departamenti i Kineziologjisë në bashkëpunim të ngushtë me njësitë e tjera përbërëse të FSHR, përkatësisht Departamentin e Shkencave Biomekanike dhe Humane dhe Departamentin e Rehabilitimit. Bashkëpunimi është i mirëpërcaktuar në dokumentat dhe aktet rregullatore të institucionit, përfshirë Statutin e UST, rregulloren e UST, rregulloren e FSHR dhe rregulloret e çdo njësie baze, pjesë e FSHR. Në organigramën e UST janë të përcaktuara qartë të gjitha Njësitë Akademike dhe Njësitë administrative, përfshirë Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Të gjitha këto njësi që janë në funksion të mbarëvajtjes së programeve të studimit që institucioni ofron, kanë rregulloret e tyre të funksionimit dhe bashkëpunojnë më njëra-tjetrën në bazë të detyrave të përcaktuara për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe ruajtjen dhe përmirësimin e standarteve të cilësisë. Rezultatet e punës dhe bashkëpunimit midis njësive të institucionit në funksion të mbarëvajtjes së programeve të studimit, përfshirë dhe programin e studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”, janë pjesë integrale e analizave periodike dhe vjetore të çdo njësie akademike dhe joakademike. Edhe takimet me përfaqësues të njësive kryesore, njësive baze, stafit akademik dhe njësive administrative në funksion të mësimdhënies dëshmuar frymën e mirë të bashkëpunimit midis tyre. <i>Ref. 3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 8. Rregullore FSHR;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e DK;</i> <i>Ref. 31. Rregullore e DSHBH;</i> <i>Ref. 9. Rregullore e brendshme e administratës;</i> <i>Ref.13. Rregullore Administrateës (Drejtoria Juridike Prokurime);</i> <i>32.7. Rregullore e NJSBC;</i> <i>Ref. 18.1. Model analize vjetore FSHR;</i> <i>Ref. 18. Model analize vjetore e DK;</i> <i>Ref. 32.3. Model raporti i FSHR, NJSBC;</i> <i>Ref. 28.1. Pasqyrat financiare vjetore 2023;</i> <i>Ref. 28. Pasqyrat financiare vjetore 2023 Tab 18;</i> <i>-Vizita në institucion, takimet me përfaqësues të njësisë kryesore, bazë, njësive adiminstrative, stafin akademik dhe studentët të angazhuar në programin e studimit.</i>
Kriteri 2. Për realizimin e	UST për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe statusin e veçantë të tij që lidhet me misionin e institucionit dhe fushën e

objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	veprimtarisë në konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare përmes kualifikimit akademik dhe shkencor në fushën e edukimit fizik, shëndetësor dhe sporteve, veprimtarisë fizike, shëndetit, rekreacionit, turizmit, menaxhimit sportiv dhe rehabilitimit, thellimin e kualifikimit profesional dhe shkencor të specialistëve të lartë në këto fusha, ofrimin e shërbimeve ndaj të tretëve dhe konsulencë në fushën e veprimtarisë së edukimit fizik, shëndetësor dhe sportiv, si dhe përgatitjen dhe stërvitjen e sportistëve elitare, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione partnere brenda dhe jashtë vendit. Në total, UST referon gjithsej nënshkrimin e 26 marrëveshjeve të bashkëpunimit me IAL kombëtare dhe ndërkombëtare. Paralelisht, UST ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Federatën Kombëtare të Futbollit, me klubet sportive për organizimin e praktikave profesionale. GVJ e konsideron nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve shumë të rëndësishme dhe me impakt pozitiv në realizimin e programit të studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”. Ky fakt u pohua edhe nga vetë studentët e programit të studimit gjatë takimeve në institucion. Institucioni synon dhe ka prioritet (Plani strategjik UST) edhe instalimin e bashkëpunimeve me partnerë strategjikë me impakt në programet e studimit që institucioni ofron. Kjo u theksua edhe gjatë takimeve në institucion me autoritetet drejtuese. Gjithashtu, institucioni nga konsultimi i dokumentacionit të dorëzuar, demonstroi edhe praktikën e mirë të kryerjes së analizës së përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit duke evidentuar frytshmërinë dhe impaktin e tyre në realizimin e objektivave të procesit mësimor.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan	Realizimi i programit të studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” mbështetet edhe nga marrëveshjet e nënshkruara midis Institucioneve të Arsimit të Lartë



marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.

(IAL) brenda dhe jashtë vendit, të cilat janë më shumë të fokusuara në aspektin akademik. Për realizimin e objektivave praktike të programit të studimit, institucioni ka instaluar marrëveshje bashkëpunimi me Federatën Kombëtare të Futbollit dhe klubet sportive për organizimin e praktikave profesionale. Nga takimet me pedagogët që drejtonin studentët gjatë praktikave profesionale, u evidentua bashkëpunim shumë i mirë me klubet sportive, veçanërisht në angazhimin aktiv dhe mbikëqyrjen e praktikës të studentëve nga stafet e këtyre klubeve. Ky fakt u pohua edhe nga vetë studentët gjatë takimeve në institucion. Gjithashtu, studentët pohuan se klubet u ofronin mundësi për kryerjen e stazhit ose punësim të pjesshëm edhe gjatë periudhës së ndjekjes së studimeve. Ndërkohë që kryerja e praktikave mësimore në subjekte private realizohej përmes sponsorizimit. Në mungesë të marrëveshjeve të shkruara, realizimi i praktikave profesionale rregullohej nga rregullorja e institucionit. Edhe pse FSHR synon për periudhën 2021-2026 nënshkrimin e kontratave të shkruara me klube sportive dhe qendra rehabilitimi për praktikantë sportive, gjë që GVJ e konsideron pozitive dhe me impakt për programin e studimit, nuk ka një listë të mirëfilltë të kontratave të nënshkruara deri më tani me subjekte private të rehabilitimit. GVJ vëren se kjo është një pikë që institucioni dhe njësisia bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të punojnë më shumë për konkretizimin dhe evidentimin e impaktit të këtyre marrëveshjeve në programin e studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”. Gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët e angazhuar në programin e studimit, u pohua se ata ishin pjesë aktive e projekteve kërkimore shkencore dhe mobiliteteve, kryesisht jashtë vendit. GVJ evidentoi një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me IAL të huaja dhe pjesëmarrje të UST si partner në projekte kërkimore - shkencore ndërkombëtare.

Ref. 24. Lista e Marrëveshjeve kombëtare ndërkombëtare;

Ref. 24.1. Marrëveshje bashkëpunimi me Federatën Kombëtare të Futbollit;

Ref. 24.2. Marrëveshjet me klubet sportive për organizimin e praktikave profesionale;

Ref. 4. Plani Strategjik FSHR 2021-2026;

Ref. 4.1. Plani Strategjik UST 2021-2026;

Ref. 4.2. Plani Strategjik UST 2021-2025;

Ref. 25. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit;

	<i>Ref. 26. Miratimi i projekteve shkencore 2023-2024;</i> <i>Ref. RVB (Raporti i Vlerësimit të Brendshëm në FSHR)</i> <i>-Takime në institucion me autoritetet drejtuese, stafin akademik dhe studentët.</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Rritja e bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare është pjesë integrale e planit strategjik të UST dhe ndërkombëtarizimit të institucionit. Në këtë kuadër, institucioni ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi me IAL brenda dhe jashtë vendit, Federatën Kombëtare të Futbollit dhe klube sportive. Përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimit hartohen në mënyrë periodike në formën e analizës vjetore specifike për marrëveshjet ose si pjesë e integruar e analizës vjetore të institucionit sipas parashikimeve ligjore. Nga raportet e vendosura në dispozicion, kryesisht të marrëveshjeve të bashkëpunimit, evidentohet se rezultatet dhe përfitimet e mundshme akademike-shkencore, strukturore dhe sociale-komunitare janë të cilësuar, por të përshkruara në nivel të përgjithshëm pa cilësime për përfitime specifike për programet e studimit. E njëjta situatë paraqitet edhe me raportimin e projekteve kërkimore shkencore, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Nuk është shumë e qartë se sa aktiv ka qenë Departamenti i Kineziologjisë, përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”, në këto projekte dhe si rrjedhojë edhe impakti dhe përfitimet e tyre në programin e studimit. Për këtë arsye, GVJ sugjeron se Departamenti i Kineziologjisë, përgjegjës për programin e studimit, duhet të përfshijë në analizën vjetore raport të detajuar të përfitimeve dhe rezultateve të bashkëpunimeve, mobiliteteve dhe projekteve kërkimore të lidhura specifikisht me programet e studimit që ofron. <i>Ref. 4. Plani Strategjik FSHR 2021-2026;</i> <i>Ref. 4.1. Plani Strategjik UST 2021-2026;</i> <i>Ref. 4.2. Plani Strategjik UST 2021-2025;</i> <i>Ref. 25. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit;</i> <i>Ref.25.1. Raport mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, projekti E - PHYSIO;</i> <i>Ref. 26. Miratimi i projekteve shkencore 2023-2024;</i> <i>Ref. 38. Përcjellje e raportit vjetor 2023 në nivel rektorati;</i> <i>Ref. RVB (Raporti i Vlerësimit të Brendshëm në FSHR);</i> <i>Ref. 18.1. Model analize vjetore FSHR;</i>

	Ref. 18. Model analize vjetore e DK; -Takime në institucion me autoritetet drejtuese dhe stafin akademik.			
Konkluzione	Programi i studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" menaxhohet nga Departamenti i Kineziologjisë në bashkëpunim me departamente të tjera të Fakultetit të Shkencave të Sporteve dhe Shëndetit. UST ka krijuar një rrjet të gjerë bashkëpunimesh që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së programit dhe zhvillimin profesional të studentëve. Pavarësisht kësaj, nuk ka ende një listë të plotë të kontratave me subjekte private të rehabilitimit. Institucioni nga konsultimi i dokumentacionit të dorëzuar, demonstroi edhe praktikën e mirë të kryerjes së analizës së përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit duke evidentuar frytshmërinë dhe impaktin e tyre në realizimin e objektivave të procesit mësimor. Por GVJ vëren se ky është një sektor që ka nevojë për më shumë angazhim për të dokumentuar impaktin e këtyre marrëveshjeve specifikisht në programet e studimit. Për më tepër, GVJ sugjeron që Departamenti i Kineziologjisë të përfshijë raporte të detajuara për përfitimet e bashkëpunimeve dhe projekteve kërkimore për një vlerësim më të qartë të ndikimit të tyre në programin e studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e	Programi i studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" është hapur datë 14.08.2023, UMAS Nr.

programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	446. Programi i studimit është i ciklit të dytë, me kohë të plotë, me gjithsej 60 kredite dhe kohëzgjatje 1 vit akademik. Programi është i organizuar sipas legjislacionit në fuqi dhe sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve, Niveli 7 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë në përputhje me rregulloren e UST-së (neni 55, neni 59) sipas së cilës programet e ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional, janë të organizuara në module dhe të vlerësuara në total me 60 kredite. Një kredit është i barabartë me 25 orë dhe në total në vit, një student zhvillon 1500 orë. Veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” janë hartuar në përputhje me Rregulloren e UST-së (neni 84) dhe përbëhen nga forma të mësimdhënies, të cilat ndahen në: mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime praktike në terren, laboratore, praktika profesionale jashtë institucionit, etj.), studim individual (ushtrime/detyra kursi), përgatitje për provime apo tezës së diplomës. Veprimtaritë formuese të programit janë të grupuara në kategoritë e mëposhtme: • A. Lëndë bazë të programit të studimit; • B. Lëndë karakterizuese; • C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese; • D. Lëndë plotësuese; • E. Detyrime përmbyllëse. Elementët e programit të studimeve janë të përcaktuara qartë edhe në Rregulloren e Njesisë Kryesore, FSHR. Në përputhje me Rregulloret e UST dhe FSHR, programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” në strukturë dhe përmbajtje ka të parashikuar lëndët dhe modulet, si dhe kreditet për secilën lëndë/modul. Referuar planit mësimor të programit të studimit, janë parashikuar: 6 kredite për lëndët bazë (A), 20 kredite për lëndët karakterizuese (B), 18 kredite për lëndët ndërdisiplinore (C), 6 kredite për praktikën profesionale (D) dhe 10 kredite për detyrimet përmbyllëse – provimin përfundimtar (E). Detyrimi përmbyllës për programin e studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” i përcaktuar në planin mësimor të programit është provimi përfundimtar. <i>Ref. 3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i>
---	---

	<i>Ref. 8. Rregullore FSHR;</i> <i>Ref. 14. Plani mësimor 2023-2024;</i> <i>Ref. 20. Dosja e programeve-syllabuse;</i> <i>Ref. 23.4. Tabela përmbledhëse, model programi.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” synon të përgatisë profesionistë të fizioterapisë të aftë në njohuri, aftësi dhe shkathtësi të thelluara profesionale në fushën e rehabilitimit. Ata mund ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre në ekipet sportive, shërbimet primare, sekondare dhe terciare me drejtim traumatologjik, ortopedik dhe kirurgjikal, të bazuar në dëmtimet sportive. Në përfundim të programit të studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”, studentët, në sajë të mësimdhënies, do të mund të zhvillojnë njohuri dhe aftësi të përparura profesionale në trajtimin fizioterapeutik të pacientëve të traumatizuar, njohjen e protokolleve, teknikave dhe metodave fizioterapeutike specifike për dëmtimet sportive traumatike dhe kronike. Në këtë aspekt, programi i studimit mundëson përfitimin e një game të gjerë aftësish dhe njohurish profesionale që reflektojnë dhe larmishmërinë për punësim në fushën e rehabilitimit sportiv të studentëve që përfundojnë këtë program studimi. Të gjitha mundësitë që programi i studimit ofron, si në aspektin profesional dhe zhvillimin e kapaciteteve intelektuale në të kuptuarit kritik dhe parimet akademike të rehabilitimit në fushën e sporteve, janë të përcaktuara qartë në rregulloren dhe planin mësimor të programit të studimit. Ky fakt u dëshmuar edhe nga studentët e programit, të cilët kishin bërë zgjedhje të informuara lidhur me këtë program, duke theksuar gamën e gjerë të mundësive për punësim që ky program ofronte. GVJ e konsideron këtë fakt si praktikë të mirë, pasi mbështet edhe më shumë rëndësinë e hapjes së këtij programi studimi, nga perspektiva e studentëve. <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 14. Plani mësimor 2023-2024;</i> <i>Ref. 20. Dosja e programeve-syllabuse;</i> <i>Ref. 15. Suplementi i Diplomës MP;</i> <i>Ref. 23.4. Tabela përmbledhëse, model programi;</i> <i>-Takimi në institucion me studentët e programit të studimit.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e	Programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”, në përputhje me Rregulloren e UST, zhvillohet brenda një (1) viti akademik me një numër total 60

praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	kredite. Programi i studimit është i organizuar në lëndë të grupuara në 5 kategori, të emërtuara dhe me numër kreditesh sipas kuadrit ligjor, përkatësisht: • A. Lëndë bazë të programit të studimit - 6 ECTS; • B. Lëndë karakterizuese - 20 ECTS; • C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese - 18 ECTS; • D. Lëndë plotësuese - 6 ECTS; • E. Detyrime përmbyllëse - Provimi përfundimtar - 10 ECTS. Programi i studimit është i organizuar në 2 semestra, dhe shpërndarja e krediteve është 30 ECTS për secilin semestër. Një kredi ekuivalentohet me 25 orë mësimore të studentit, të cilat përfshijnë veprimtari mësimore brenda (leksione, seminare, ushtrime, detyra kursi, etj.) dhe jashtë auditorit (orë pune individuale të studentit). Në planin mësimor të programit është e përcaktuar qartë ngarkesa e çdo veprimtarie formuese për secilin modul të programit. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 5. VKM Nr 41 IAL 24.01.2018;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 14. Plan mësimor 2023-2024;</i> <i>Ref. 20. Dosja e programeve-syllabuse;</i> <i>Ref. 23.4. Tabela përmbledhëse, model programi.</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Jo e aplikueshme.
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të	Jo e aplikueshme.



krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST) është një institucion publik i arsimit të lartë, me karakter akademik, shkencor dhe sportiv, i krijuar me vendimin nr. 123, datë 17.02.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", me status të veçantë, VKM Nr. 57, datë 29.01.2020. UST-ja, si institucion i arsimit të lartë, zhvillon veprimtari akademike në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fushën e edukimit fizik dhe shëndetësor, sporteve, rekreacionit, turizmit sportiv dhe rehabilitimit. Ai gëzon status të veçantë lidhur me: a) <i>Organizimin e programeve të studimeve në cikle studimi që përfundojnë me marrjen e diplomave ose certifikatave, sipas rastit.</i> b) <i>Ofrimin e procesit promovues, vlerësimin konkurrues dhe përfundimin me sukses të programit përkatës të formimit/trajnitimit.</i> c) <i>Veprimtarinë profesionale dhe sportive të realizuar nga personeli akademik, të cilat konvertohen në veprimtari shkencore, që shërbejnë për të vlerësuar performancën akademike vjetore, sipas përcaktimeve në statutin e UST-së.</i> d) <i>Punësimin e personelit akademik me kohë të plotë, sipas kriterëve të përcaktuara nga njësia bazë e të miratuara nga rektori, përveç arritjeve akademike dhe shkencore të kandidatit, si dhe vlerësimin e karrierës profesionale sportive, sipas përcaktimeve në statutin e UST-së.</i> e) <i>Mbështetjen, promovimin dhe pranimin për studime të sportistëve me status të nivelit të lartë, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.</i> f) <i>Të drejtën e hartimit dhe zhvillimit të programeve të studimeve dhe të projekteve të kërkimit shkencor në fushën e edukimit fizik, atij shëndetësor dhe sporteve, të veprimtarisë fizike, rekreacionit, turizmit sportiv dhe rehabilitimit.</i> g) <i>Hartimin e kriterëve dhe testeve fizike të pranimin me konkurrim të kandidatëve për studentë në UST.</i> Referuar statusit të veçantë, UST është institucion publik dhe financohet nga Buxheti i Shtetit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore

	në fuqi, si dhe akteve rregullatore të institucionit. UST funksionon mbi bazën e parimeve të autonomisë financiare. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studimeve dhe financimi i veprimtarisë akademike, kërkimore shkencore dhe administrative të institucionit janë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe statusin e veçantë të UST. Në përmbushje të statusit të veçantë, UST harton buxhetin vjetor dhe afatmesëm, bazuar në propozimet e njësive kryesore dhe planit strategjik të institucionit. Gjithashtu, UST gjeneron edhe të ardhura nga shërbimet me të tretë dhe aktivitete të tjera, të cilat i përdor në përputhje me kushtet, qëllimet dhe objektivat strategjike të zhvillimit institucional. <i>Ref. 3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 4. Plan Strategjik FSHR 2021-2026;</i> <i>Ref. 4.1. Plan strategjik UST 2021-2026;</i> <i>Ref. 4.2. Plan Strategjik UST 2021-2025;</i> <i>Ref. 28.1. Pasqyrat financiare vjetore 2023;</i> <i>Ref. 28. Pasqyrat financiare vjetore 2023 Tab 18;</i> <i>Ref. 16. Vendim senati Nr 1 për detajimin e grantit;</i> <i>Ref. 29. Kalendar i aktiviteteve FSHR për vitet 2023-2024;</i> <i>Ref. 2. Urdhër i brendshëm.</i>
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet	Ky program studimi është unik dhe ofrohet vetëm në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Edhe pse organizimi dhe përmbajtja e strukturës së programit të studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” janë në përputhje me kërkesat dhe kuadrin ligjor, në planin mësimor dhe syllabuset e çdo lënde mungon kodifikimi i tyre. Në këtë aspekt, në dokumentacionin e vendosur në dispozicion për vlerësim, nuk është përshkruar pse kodet e lëndëve mungojnë dhe në cilën fazë ndodhet procesi i kodifikimit të tyre, nëse ka nisur si proces. Për këtë arsye, GVJ sugjeron adresimin e mungesës së kodeve të lëndëve të programit nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, përkatësisht Departamenti i Kineziologjisë. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i>

	Ref 5. VKM Nr 41 IAL 24.01.2018; Ref. 6. Rregullore e MP; Ref. 14. Plani mësimor 2023-2024; Ref. 20. Dosja e programeve-syllabuse; Ref. 23.4. Tabela përmbledhëse, model programi.
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky nuk është një program i përbashkët por ofrohet vetëm nga UST.
Konkluzione	UST është një institucion publik i arsimit të lartë, i krijuar më 17.02.2010, me status të veçantë, që ofron programe studimi në fushat e edukimit fizik, sporteve, turizmit sportiv dhe rehabilitimit. UST financohet nga Buxheti i Shtetit dhe ka autonomi financiare për të zhvilluar aktivitete të ndryshme. Buxheti hartohet çdo vit dhe afatmesëm, duke përfshirë të ardhurat nga shërbime dhe aktivitete të tjera që mbështesin zhvillimin strategjik të institucionit. Programi i studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport", i cili ka filluar më 14.08.2023, është i ciklit të dytë, me një vit kohëzgjatje dhe ofron 60 kredite, të ndara në pesë kategori: lëndë bazë (6 ECTS), lëndë karakterizuese (20 ECTS), lëndë ndërdisiplinore (18 ECTS), lëndë plotësuese (6 ECTS), dhe detyrimi përfundimtar (provimi, 10 ECTS). Ai është i organizuar në dy semestra, me 30 ECTS për secilin. Një kredit përfaqëson 25 orë mësimore, përfshirë aktivitete në auditor dhe punë individuale. Programi është në përputhje me rregulloret e UST-së dhe FSHR-së, dhe në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore kombëtare në fuqi. Programi Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" përgatit profesionistë për trajtimin e dëmtimeve sportive, me fokus në rehabilitim traumatologjik dhe ortopedik. Programi ofron mundësi profesionale dhe intelektuale dhe është vlerësuar pozitivisht nga studentët për mundësitë e karrierës që ofron. Pavarësisht përputhshmërisë së strukturës së programit të studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" me kërkesat ligjore, në planin mësimor dhe syllabuset, mungojnë kodet e lëndëve. GVJ sugjeron që Departamenti i Kineziologjisë të adresojë këtë mangësi.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” ofrohet nga UST. Njësia Kryesore që ofron këtë program studimi, FSHR, ka në përbërjen e saj 3 Njësi Bazë, përfshirë njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit, Departamenti i Kineziologjisë. Ky departament e ushtron veprimtarinë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi që nga koha e krijimit të FSHR, me VKM Nr. 495, datë 11.10.2019. FSHR, përmes njësive bazë përbërëse, ofron programe studimi të ciklit të parë që prej vitit 2020 (Programi i ciklit të parë të studimeve Bachelor, Urdhri Nr. 245, datë 22.07.2020, Nr. Prot 3641/1 të MASR) dhe të dytë profesional. Personeli akademik në nivel njësie kryesore është në total 10, përkatësisht: 2 - Profesor Doktor, 5 - Profesor i Asociuar, 3 - Lektor me gradën Doktor/Docent. Personeli akademik në nivel Departamenti PAE, është i angazhuar gjithsej 14, përkatësisht: 3 - Profesor Doktor, 6 - Profesor i Asociuar (PAE) dhe 1 - Profesor i Asociuar (PAK), dhe 4 - Lektor me gradën Doktor/Docent. FSHR dhe DK demonstrojnë se disponojnë kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e këtij programi studimi, në përputhje me fushën e veprimtarisë, objektivat e programit dhe statusin e veçantë të UST, si i vetmi institucion publik i arsimit të lartë në Shqipëri me status të veçantë, me fokus në zhvillimin e veprimtarive akademike në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fushën e edukimit fizik dhe shëndetësor, sporteve, rekreacionit, turizmit sportiv dhe rehabilitimit. UST është institucion i arsimit të lartë i akredituar dhe infrastruktura në funksion të mësimdhënies është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për ofrimin e programit të studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”. <i>Ref. 3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e DK;</i>

	Ref. 6. Rregullore e MP; Ref. 8. Rregullore FSHR; Ref. 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore; Ref. 23.1. Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit; Ref. 23.5. Të dhëna tabelore për infrastrukturën, laboratore; Ref. 23.5.1. Të dhëna për infrastrukturën; Ref. 23.6. Të dhëna tabelore për infrastrukturën mbështetëse për procesin mësimor; Ref. RVB (Raporti i Vlerësimit të Brendshëm në FSHR); -Vizita në institucion.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Bazuar në Rregulloren e UST-së, neni 40, personeli ndihmës akademik me karakter mësimor, kërkimor-shkencor dhe administrativ duhet të jetë pjesë e stafit të angazhuar për çdo program studimi që institucioni ofron. Detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik në lidhje me programet e studimit që njësia përgjegjëse për programin e studimit ofron janë të përcaktuara qartë edhe në Rregulloren e DK. Por, GVJ evidenton se rregullorja e programit të studimit nuk përmban informacion në lidhje me rolin e personelit ndihmës akademik/administrativ në realizimin e procesit mësimor. Gjithashtu, nga evidenca e dosjes së vlerësimit në lidhje me dhënat tabelore për infrastrukturën mbështetëse për procesin mësimor, nuk ka të dhëna në lidhje me numrin e stafit ndihmës akademik të angazhuar në programin e studimit. Edhe nga vizita në institucion u evidentua se personeli ndihmës akademik në funksion të mësimdhënies ishte i kufizuar dhe i angazhuar kryesisht në nivel institucional. Për këtë arsye, GVJ sugjeron: 1. Përditësimin e Rregullores së DK, ku të përfshihet edhe informacioni në lidhje me rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e personelit ndihmës akademik në realizimin e procesit mësimor dhe përmbushjen e objektivave të lidhura. 2. Angazhimin me kohë të plotë të personelit ndihmës akademik me karakter mësimor-kërkimor në nivel njësie bazë. Angazhimi i tyre në procesin mësimor, kryesisht në orët e laboratorëve (UST disponon 7 laboratore profesionale), konsiderohet nga GVJ shumë i rëndësishëm, duke pasur parasysh dhe karakterin profesional të programit të studimit. GVJ mendon se mosangazhimi i personelit ndihmës akademik në programin e studimit Master Profesional në "Rehabilitim

	Fizioterapeutik në Sport” konsiderohet si pikë e dobët e programit. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e DK;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 23.6. Të dhëna tabelore për infrastrukturën mbështetëse për procesin mësimor;</i> <i>Ref. 23.5- Të dhëna tabelore për infrastrukturën, laboratore;</i> <i>-Vizita në institucion.</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” ofrohet në nivel njësie baze, konkretisht nga Departamenti i Kineziologjisë. Ky departament është përgjegjës për implementimin dhe realizimin e procesit mësimor që lidhet me programin e studimit. Ndërkohë, për realizimin e objektivave të programit, bashkëpunon edhe me njësitë e tjera bazë të FSHR, njësinë kryesore ku bën pjesë, strukturat administrative dhe personelin ndihmës akademik të UST dhe partnerët e tjerë. Referuar Rregullorës së UST-së, drejtuesi i njësisë bazë është personi përgjegjës për organizimin e punës për hartimin e programeve të studimit dhe më pas mbikëqyrjen e ecurisë së programit. Koordinatori i programit të studimit (neni 12, Rregullore e DK) ka një sërë përgjegjësish dhe detyrash të mirëpërcaktuara për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor-kërkimor të programit të studimit dhe zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale dhe veprimtari të tjera të lidhura. Kompetencat e Koordinatorit të programit të studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” ishin të parashikuara qartë edhe në rregulloren e programit të studimit (neni 33). <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e DK;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 23.2. Të dhëna tabelore për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse.</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” ofrohet nga UST dhe menaxhohet nga FSHR, e cila ka në përbërje të saj Departamentin e Kineziologjisë. Programi Master në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”</i>

	ofrohet nga Departamenti i Kineziologjisë, i cili është përgjegjës për procesin mësimor. Koordinator i programit ka përgjegjësi për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktivitetet përkatëse, siç përcaktohet në rregulloren e programit. Ky program studimi është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ka filluar të ofrohet që nga viti 2023. Personeli akademik i angazhuar përfshin 21 individë në nivel njësie kryesore dhe 14 në nivel programi studimi. UST ka kapacitetet dhe burimet e nevojshme për të ofruar këtë program, me një infrastrukturë të përshtatshme për mësimdhënie. GVJ ka vërejtur se rregullorja e programit të studimit nuk specifikon rolin e personelit ndihmës akademik dhe mungojnë të dhëna për numrin e tij në program. GVJ sugjeron përditësimin e rregullores për të përfshirë detyrat e këtij personeli dhe angazhimin e tij me kohë të plotë në nivel njësie bazë, veçanërisht në laboratorë. Mosangazhimi i këtij personeli konsiderohet një pikë e dobët për programin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” ofrohet nga UST. Dokumentacioni për programin e studimit disponohet nga Njësia Kryesore që ofron këtë program studimi, përkatësisht FSHR. Statuti dhe Rregullorja e Institucionit përcaktojnë rregullat, ndërsa detaje të tjera për programin (Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”) jepen në Rregulloren e programit dhe të Njesisë Bazë. Ato përfshijnë strukturën, format e mësimit, kriteret e vlerësimit, pranimin dhe detyrat e studentëve. Gjatë vizitës u raportua se Departamenti i Kineziologjisë përgjegjës për programin e studimit dhe pjesë përbërëse e FSHR, disponon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të programit të studimit, përfshirë planin mësimor, syllabuset dhe tezat e provimeve. Në rregulloren e FSHR dhe DK, përcaktohen qartë të gjithë elementët e programve të ciklit të parë dhe të dytë të studimit. Ato përfshijnë strukturën e studimeve,

	format e mësimdhënies dhe frekuentimit, procedurat dhe kriteret e vlerësimit, pranimin si dhe detyrat e studentëve. <i>Ref. 3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e DK;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 39. Tabelat përmbledhëse institucionale;</i> <i>-Vizita në institucion.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” përfshin ndarjen e moduleve, kategoritë e tyre, ngarkesën mësimore, semestrin për secilën lëndë/modul, orët në auditor si dhe jashtë auditorit, kreditet sipas formave të mësimdhënies (leksione, seminare, praktika, laboratore dhe veprimtari formuese), kreditet totale të lëndëve, formën e vlerësimit dhe informacion mbi orët e studimit individual. Informacion i detajuar për çdo modul, përfshirë ngarkesën, kreditet, orët e studimit, etj. është i përfshirë edhe në syllabuset e lëndëve. <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 14. Plani mësimor 2023-2024;</i> <i>Ref. 20. Dosja e Programeve -Syllabe;</i> <i>Ref. 22. Model program i lëndës Rehabilitim në Dëmtimet Sportive.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve të ciklit të dytë janë të përfshira në Rregulloren e Institucionit (neni 59 dhe Kreu III, Organizimi dhe zhvillimi i procesit të transferimit të studimeve dhe regjistrimit në programe të dyta studimi). Informacioni për të gjitha ciklet e studimit në lidhje me transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e moduleve është i përcaktuar edhe në Rregulloren e FSHR (nenet 73-82). Në Rregulloren e programit të studimit parashikohen politikat e pranimit, procedura që ndiqet, si dhe dokumentacioni i nevojshëm (nenet 25-26). Kriteret specifike akademike të pranimit të kandidatëve në programin e studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” përcaktohen dhe miratohen në fillim të çdo viti akademik nga Njësia Bazë përgjegjëse dhe organet e tjera kolegjiale në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Kriteret bëhen publike edhe nëpërmjet faqes Ueb të FSHR. Evidentohet se Rregullorja e Njesisë Bazë, Departamenti i Kineziologjisë, përgjegjës për programin e

	studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” nuk ka informacion të përcaktuar lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve për programe të ciklit të dytë të studimeve. GVJ sugjeron përditësimin e rregullores së njësise bazë dhe përfshirjen e informacionit të nevojshëm për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve të ciklit të dytë. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 8. Rregullore FSHR;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e DK;</i> <i>Ref. 17. Përcjellje e kriterëve të pranimit në MP;</i> <i>-Vizita në institucion, takimet me Drejtuesit e Njësise Kryesore dhe Bazë.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” në planin mësimor të tij përmban në mënyrë të detajuar informacionet e nevojshme për lëndët/modulet që përfshihen, duke përcaktuar qartë dhe ngarkesën e çdo aktiviteti formues dhe formën e mësimdhënies në përputhje me aktet rregullatore të UST (Rregullore UST, neni 82 dhe Rregullore FSHR, neni 45). Çdo syllabus i lëndëve të programit të studimit ofron informacion të detajuar për ngarkesën totale në kredite ECTS të lëndës, orët përkatëse sipas formave të mësimdhënies, tipologjinë e lëndës, vitin akademik dhe semestrin kur zhvillohet lënda, llojin e lëndës (me detyrim ose me zgjedhje), programin e studimit ku ofrohet dhe adresën elektronike të titullarit/pedagogut të lëndës. Syllabuset e lëndëve hartohen nga titullari dhe miratohen nga Drejtuesi i Njësise Bazë. Kjo procedurë u konfirmua dhe në takimin e zhvilluar me stafin akademik gjatë vizitës institucionale. Në syllabuse janë të përcaktuara edhe forma e kontrollit të dijeve, literatura bazë e detyrueshme dhe literatura e rekomanduar. GVJ evidentoi se literatura bazë e detyruar ishte e vjetër (10-15 vite të fundit) dhe shpesh herë një miks i literaturës në gjuhë të huaj dhe shqipe, pa një literaturë bazë të mirëfilltë referencë. Për këtë arsye, GVJ sugjeron që është shumë e rëndësishme që literatura bazë të përditësohet sa më shpejt, duke pasur parasysh dhe faktin që programi i studimit është relativisht i ri (vetëm 1 vit që është hapur) dhe, si rrjedhojë, literatura duhet t’i përgjigjet kërkesave të kohës së

	sotme që lidhen me rehabilitimin fizioterapeutik në sport në funksion edhe të përmbushjes së standarteve të cilësisë. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 8. Rregullore FSHR;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 20. Dosja e Programeve -Syllabe;</i> <i>Ref. 22. Model program i lëndës Rehabilitim në Dëmtimet Sportive;</i> <i>-Vizita në institucion, takimi me stafin akademik.</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Përmirësimi dhe përditësimi i vazhdueshëm i çdo programi studimi, kryesisht në fillim të çdo viti akademik, është pjesë e politikave për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë për të gjitha programet e studimit që institucioni ofron. Kjo gjë evidentohet në analizën vjetore të punës së çdo njësie, por edhe gjatë takimeve në institucion me stafin akademik dhe studentët. Propozimet e studentëve dhe stafit akademik që lidhen me programin e studimit diskutohen, dokumentohen dhe i përcillen dekanatit për miratim. Ndryshimet mund të bëhen deri në masën 20%. Megjithatë, ky kriter nuk është i aplikueshëm në këtë fazë të vlerësimit të programit, duke qenë se programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” është relativisht i ri, i ofruar në vitin akademik 2023-2024. <i>Ref. 18. Model analize vjetore e DK;</i> <i>Ref. 18.1. Model analize vjetore FSHR;</i> <i>-Vizita në institucion, takimet me stafin akademik, studentët dhe autoritetet drejtuese.</i>
Konkluzione	Programi Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” ofrohet nga UST dhe rregullohet nga Statuti dhe Rregullorja e Institucionit. Detajet e programit, përfshirë strukturën, mësimin, vlerësimin dhe kriteret e pranimi, përshkruhen në rregulloret përkatëse. Plani mësimor përfshin ndarjen e moduleve, ngarkesën mësimore, kreditet, orët dhe informacionin për studimin individual. Rregullorja e Departamentit të Kineziologjisë ka nevojë për përditësim pasi informacionet për pranimin dhe transferimin nuk janë të përfshira. Syllabuset e lëndëve përfshijnë detaje të plota dhe janë miratuar nga Drejtuesi i Njesisë Bazë. GVJ sugjeron përditësimin e literaturës bazë, pasi ajo është e vjetër dhe nuk është homogjene. Përmirësimi i programeve bëhet çdo vit akademik, por për programin Master Profesional në “Rehabilitim

	<i>Fizioterapeutik në Sport", ky proces nuk aplikohet ende për shkak të hapjes së tij rishtazi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Në programin e studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport", çdo lëndë e planit mësimor ka të përcaktuar qartë përbërjen e saj si ngarkesën, përkatësisht në leksione, seminare, ushtrime praktike në terren, ushtrime/detyra kursi, praktikë, laboratore/praktikë klinike dhe profesionale dhe veprimtari të tjera formuese në varësi të specifikave të lëndëve. Kjo u jep mundësi studentëve të ndërthurin njohuritë që marrin në secilin formë të mësimdhënies dhe të thellojnë njohuritë e tyre në këtë fushë, sidomos në aplikimin praktik të këtyre njohurive. Studentët që përfundojnë programin e studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" kanë mundësi të punësohen në një gamë të gjerë shërbimesh që lidhen me rehabilitimin sportiv dhe jo vetëm. Ky fakt u konfirmua edhe nga takimi me studentët të cilët pohuan se arsyeja kryesore që kishin zgjedhur këtë program studimi ishte pikërisht larmishmëria që ofronte në punësim. Shumica e studentëve që ndiqnin programin e studimit kishin përfunduar në UST edhe ciklin e studimeve bachelor. <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 14. Plan mësimor 2023-2024;</i> <i>Ref. 20. Dosja e Programeve -Syllabe;</i> <i>-Vizita në institucion, takimi me studentët.</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe	Programi i studimeve Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" ka si qëllim formimin e profesionistëve të fizioterapisë, të cilët do të jenë të aftë të zhvillojnë njohuri, aftësi dhe shkathtësi të thelluara profesionale në fushën e rehabilitimit. Ata mund të punojnë në ekipe sportive, shërbime shëndetësore të nivelit primar, sekondar dhe terciar, me fokus në trajtimin e dëmtimeve traumatologjike, ortopedike dhe kirurgjikale. Arritja e

rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.	qëllimeve të programit dhe rezultateve të pritura të të nxëniet sigurohet përmes planit mësimor të strukturuar, i cili përmban një kombinim të lëndëve bazë, specifike, ndërdisiplinore dhe shtesë, duke respektuar kuadrin ligjor përkatës. Lëndët janë të shpërndara në dy semestere, me nga 30 kredite secili, për një total prej 60 kredite për të gjithë kohëzgjatjen 1 vjecare të programit. Lëndët e programit ofrojnë mundësinë e një formimi të plotë profesional dhe shkencor për studentët, ndërkohë që çdo syllabus përcakton qartë objektivat, qëllimet dhe rezultatet e pritshme të të nxëniet. <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 14. Plan i mësimor 2023-2024;</i> <i>Ref. 20. Dosja e Programeve -Syllabe;</i> <i>Ref. 22. Model program i lëndës Rehabilitim në Dëmtimet Sportive.</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i studimeve Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” ka një total prej 1500 orësh (619 orë në auditor dhe 881 orë jashtë auditorit) për të gjithë kohëzgjatjen e programit, që është 1 vit akademik. Lëndët e programit përfshijnë orë praktike dhe teorike. Sipas planit mësimor, orët jashtë auditorit janë 174, të cilat përfshijnë laboratore, praktika klinike dhe profesionale, ndërsa 619 orë janë të dedikuara për mësim në auditor, dhe 881 orë për studim individual. Gjatë vizitës institucionale dhe takimeve me grupet e ndryshme, është theksuar se struktura e programit është hartuar duke u mbështetur në programe të ngjashme të ofruara nga institucione të njohura ndërkombëtare të arsimit të lartë me të njëjtin fokus, për të siguruar që studentët të pajisen me njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale. <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 14. Plan i mësimor 2023-2024;</i> <i>Ref. 20. Dosja e Programeve -Syllabe;</i> <i>-Takimi me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>-Takimi me stafin akademik.</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,	Programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” ka një total prej 60 kreditesh, të cilat studentët mund t'i fitojnë brenda një (1) viti akademik. Programi përmban lëndë për secilin semestër, si dhe kredite për çdo lëndë. Sipas planit mësimor, lëndët bazë përfshijnë 6 kredite, lëndët karakterizuese 20 kredite, lëndët ndërdisiplinore 18 kredite, 6 kredite për lëndët plotësuese dhe 10 kredite për provimin përfundimtar (detyrimet përmbyllëse). Rregulloret e institucionit



mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	parashikojnë mundësinë e transferimit të studimeve për studentët gjatë ose pas përfundimit të programit. Gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët, u theksua se institucioni është aktiv në mobilitete studentore, kryesisht në kuadër të programit Erasmus+. Megjithatë, nuk u përmendën mobilitete të realizuara në lidhje me programin e studimit specifik. GVJ mendon se institucioni duhet të përqendrohet më shumë në këtë drejtim dhe të krijojë një strategji të qartë për mundësitë e mobiliteteve studentore, duke marrë parasysh edhe kohëzgjatjen njëvjeçare të programit. Për studentët që përfundojnë studimet Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”, mund të hapen mundësi për punësim ose studime të mëtejshme, sidomos në shërbime rehabilitimi sportive dhe më gjerë. Kjo konsiderohet nga GVJ si një nga pikat më të forta të programit të studimit. <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 8. Rregullore FSHR;</i> <i>Ref. 14. Plan i mësimor 2023-2024;</i> <i>-Vizita në institucion, takimet me stafin akademik dhe studentët.</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabuset e lëndëve të programit të studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” hartohen nga titullari i lëndës dhe miratohen nga Drejtuesi i Njesisë Bazë. Kjo procedurë është konfirmuar nga takimet me stafin akademik dhe është dokumentuar në dosjen e programit të studimit. Edhe pse institucioni ka praktikuar përditësimin e vazhdueshëm të programeve të lëndëve, i pohuar nga takimet me stafin akademik dhe drejtuesit e njësive kryesore dhe bazë, specifikisht për këtë program studimi, i cili është ofruar për herë të parë gjatë vitit akademik 2023-2024, ky kriter nuk është plotësisht i aplikuar. Megjithatë, GVJ mendon se hapja e programit të studimit, e bazuar në një analizë të thelluar të tregut të punës, është një hap pozitiv. Po ashtu, vihet re që, megjithëse programi është relativisht i ri, literatura bazë dhe ndihmëse në syllabuset e lëndëve është e vjetër dhe ka nevojë për përditësim. <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 8. Rregullore FSHR;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e DK;</i> <i>Ref. 20. Dosja e Programeve -Syllabe;</i>


	<i>Ref. 4.3. Studimi i tregut të punës;</i> <i>-Takimi me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë;</i> <i>-Takimi me stafin akademik.</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” përfshin elementë të ndryshëm në planin mësimor, si leksione, seminare, laboratore, praktika profesionale, etj. Syllabuset e lëndëve kanë të përcaktuara qartë objektivat formues, aftësitë dhe kompetencat që studentët do të zhvillojnë në përfundim të secilës lëndë. Pas përfundimit të programit të studimit, studentët do të kenë mundësinë të zhvillojnë njohuri dhe aftësi të avancuara profesionale në trajtimin fizioterapeutik të pacientëve të traumatizuar, duke njohur protokollet, teknikat dhe metodat fizioterapeutike specifike për dëmtimet sportive, të tilla si ato traumatike dhe kronike. Në këtë mënyrë, programi ofron mundësinë për fitimin e një gamë të gjerë aftësish dhe njohurish profesionale që ofrojnë mundësi punësimi të ndryshme në fushën e rehabilitimit sportiv për studentët që përfundojnë këtë program. Të gjitha mundësitë që programi ofron, si në aspektin profesional, ashtu edhe për zhvillimin e kapaciteteve intelektuale për të kuptuar në mënyrë kritike parimet akademike të rehabilitimit në sport, janë të përcaktuara qartë në rregulloren dhe planin mësimor të programit. Studentët raportuan se bashkëpunimi me Federatën Shqiptare të Futbollit dhe klubet sportive për zhvillimin e praktikave profesionale i ndihmon ata të përfitojnë njohuritë dhe aftësitë e synuara, duke i bërë ata më të përgatitur për të përballuar tregun e punës <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 20. Dosja e Programeve -Syllabe;</i> <i>Ref. 14. Plani mësimor 2023-2024;</i> <i>-Takimi me studentët.</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.	Studentët që përfundojnë programin e studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” kanë mundësi të vazhdojnë studimet e tyre, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, si dhe të punësohen në shërbime të ndryshme rehabilituese dhe jo vetëm. Studentët e angazhuar në këtë program kishin përfunduar ciklin e parë të studimeve në UST. Pothuajse të gjithë studentët kishin si synim punësimin, kryesisht në klube sportive ose në shërbime rehabilituese që lidhen me trajtimin e dëmtimeve sportive. Gjatë takimeve në institucion, u theksua mungesa e profesionistëve të specializuar në rehabilitimin fizioterapeutik në sport, në tregun e

	punës, e cila theksonte edhe më shumë arsye për zgjedhjen e këtij programi nga studentët, duke pasur parasysh kërkesat dhe pritshmëritë e larta të tregut të punës për këtë profesion. <i>Ref. 14. Plani mësimor 2023-2024;</i> - Takimi me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takim me stafin akademik; - Takim me studentët.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" ofron një strukturë mësimore të diversifikuar në përputhje me objektivat formuese dhe nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve. Programi ofron një strukturë mësimore me lëndë bazë, specifike dhe ndërdisiplinore, të shpërndara në dy semestre, gjithsej me 60 kredite. Programi i studimeve ka një total prej 1500 orësh, përfshirë 619 orë mësim në auditor dhe 881 orë jashtë auditorit. Lëndët përfshijnë orë praktike dhe teorike, me 174 orë për laboratorë dhe praktika klinike, dhe 881 orë për studim individual. Struktura e programit është hartuar duke u mbështetur në programe të ngjashme ndërkombëtare, për të siguruar zhvillimin e njohurive dhe aftësive profesionale të studentët. Programi ofron mundësi për transferimin e studimeve dhe mobilitete studentore, kryesisht në kuadër të Erasmus+. GVJ sugjeron që institucioni të krijojë një strategji më të qartë për mundësitë e mobiliteteve. Syllabuset e lëndëve përcaktojnë qartë objektivat, aftësitë dhe kompetencat që studentët do të zhvillojnë. GVJ vlerëson hapin pozitiv të hapjes së programit pas një analize të tregut të punës, por thekson nevojën për përditësimin e literaturës në syllabuset e lëndëve. Bashkëpunimi me Federatën Shqiptare të Futbollit dhe klubet sportive i ndihmon studentët të përfitojnë njohuri praktike dhe t'i përgatisë ata për tregun e punës. Studentët e programit Master në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" mund të vazhdojnë studimet ose të punësohen në shërbime rehabilituese dhe klube sportive. Pothuajse të gjithë studentët synojnë punësimin në këtë fushë, pasi ka një mungesë profesionistësh të specializuar në rehabilitimin fizioterapeutik në sport. Mundësia për punësim që programi i studimit ofron konsiderohet nga GVJ si pika e fortë e programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” është hapur mbi bazën e studimit të tregut të punës, programeve të ngjashme të ofruara në institucione partnere të huaja, por edhe duke marrë parasysh propozimet e ish-diplomuarve. Kjo gjë u theksua pothuajse në të gjitha takimet gjatë vizitës në institucion, si takimi me drejtuesin e njësisë kryesore, bazë, takimi me stafin akademik dhe studentët. Pavarësisht se praktika e përmirësimit të programit të studimit nuk mund të jetë e aplikueshme për këtë program, pasi ka vetëm 1 vit që është hapur, institucioni për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë zhvillon pyetësorin e studentëve të diplomuar duke marrë informacion nëse janë punësuar apo jo, sa të kënaqur ndihen me cilësinë e programeve të studimit, sa të mbështetur janë ndjerë nga institucioni në lidhje me punësimin, sa të aftë ndihen për t’u përballur me tregun e punës etj. Ndërkohë që nëpërmjet platformës https://alumni.ust.edu.al/ studentët kanë mundësi të kontrollojnë dhe të aplikojnë në ofertat e punës që lidhen me fushën e tyre të ekspertizës. Gjithashtu, nëpërmjet NJSBC, institucioni organizon fokus grupe me studentët për vlerësimin e procesit të mësimdhënies. Sugjerimet e dhëna nga studentët përbëjnë bazën e përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Megjithatë, dokumentimi i përfshirjes së rregullt të aktorëve të jashtëm do t’i japë mundësi UST të përshtatë akoma dhe më mirë programet e studimit në bazë të nevojave të tregut të punës, duke qenë se një nga pikat e dobëta të evidentuara gjatë fokus grupeve, sidomos në masterin profesional, janë kufizimet në bashkëpunimet me klinika profesionale dhe moderne për zhvillimin e praktikave profesionale. <i>Ref. 4.3. Studimi i tregut të punës;</i> <i>Ref. 32. Model pyetësori;</i> <i>Ref. 32.1. Model raport i fokus grupeve të studentëve;</i> <i>Ref. 32.8. Model raporti i analizës vjetore të NJSBC 2023-2024;</i> <i>- Takimi me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>- Takimi me stafin akademik;</i>



	<i>-Takimi me GVB;</i> <i>- Takimi me studentët.</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Studentët janë pjesë aktive në përmirësimin e programeve të studimit nëpërmjet plotësimit të pyetësorit mbi cilësinë e mësimdhënies si dhe diskutimeve të fokus grupeve që organizohen nga NJSBC. Pas përfundimit të pyetësorit, zyra e NJSBC harton raporte periodike duke evidentuar pikat e dobëta dhe rekomandimet për adresimin e tyre. Raportet u përcillen njësive respektive. Studentët raportuan se janë pjesë aktive e plotësimit të pyetësorit dhe janë të përfshirë në përmirësimin e programit të studimit nëpërmjet përfaqësuesve të tyre. Përfshirja e studentëve të diplomuar mundësohej nëpërmjet platformës online https://alumni.ust.edu.al/. Nga të dhënat për punësimin e studentëve, Alumni u evidentua se nga 16 studentë të diplomuar në Programin e studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”, vetëm 10 prej tyre ishin punësuar në përputhje me diplomën. Zyra së Këshillimit dhe Karrierës është njësia përgjegjëse për mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me ish studentët dhe marrjen e mendimeve të tyre për përmirësimin e programit të studimit. <i>Ref. 4.3. Studimi i tregut të punës;</i> <i>Ref. 32. Model pyetësori;</i> <i>Ref. 32.1. Model raport i fokus grupeve të studentëve;</i> <i>Ref. 32.8. Model raporti i analizës vjetore të NJSBC 2023-2024;</i> <i>Ref 32.3. Model raporti i FSHR NJSBC;</i> <i>Ref. 36. Të dhëna tabelore për punësimin e studentëve ALUMNI;</i> <i>Ref. 37. Relacioni i aktivitetit të Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës;</i> <i>- Takimi me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës;</i> <i>- Takimi me studentët.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe	UST ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike, private, njësi të pushtetit vendor, Federatën Shqiptare të Futbollit etj., në sajën e të cilave organizon aktivitete të ndryshme, ku studentët janë pjesë aktive. Gjithashtu, studentët janë aktive edhe në kryerjen e praktikave profesionale në institucionet dhe organizatat me të cilat UST bashkëpunon. Njësia përgjegjëse, konkretisht Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikut dhe Studentëve harton raporte periodike të përfitimeve që institucioni ka nga këto marrëveshje, dhe çdo sugjerim i dhënë shërben për përditësimin dhe përmirësimin e programit të studimit. Kjo gjë ndihmon që nëpërmjet analizës së situatës të japin propozime konkrete për përmirësimin e

institucione publike e private.	programit të studimit, për shembull në përmirësimin e infrastrukturës laboratorike apo praktikave profesionale. Dokumentimi i përfitimeve të marrëveshjeve të bashkëpunimit nga institucioni konsiderohet nga GVJ si shembull i praktikës së mirë. <i>Ref. 24.1. Marrëveshje bashkëpunimi me Federatën Kombëtare të Futbollit;</i> <i>Ref. 24.2. Marrëveshjet në klubet sportive për organizimin e praktikave profesionale;</i> <i>Ref. 24. Lista e marrëveshjeve kombëtare ndërkombëtare;</i> <i>Ref. 25. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit;</i> <i>Ref. 25.1. Raport mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, projekti E - PHYSIO;</i> - Takimi me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takimi me stafin akademik; - Takimi me studentët.			
Konkluzione	<i>Programi i Masterit Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" është hapur pas studimit të tregut të punës dhe sugjerimeve nga ish-studentët dhe diplomuarit. Institucioni mbledh feedback nga studentët për kënaqësinë dhe mundësitë e punësimit dhe organizon pyetësorët dhe fokus grupe për të përmirësuar cilësinë e programeve të studimit dhe mësimdhënien. Nga 16 diplomuar në Masterin e "Rehabilitimit Fizioterapeutik në Sport," vetëm 10 janë punësuar në fushën e tyre. Zyra e Këshillimit dhe Karrierës mban kontakte me ish-studentët për feedback.</i> <i>UST ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, ku studentët janë pjesë aktive, sidomos në praktikat profesionale. Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë harton raporte përfitimesh nga këto marrëveshje, dhe sugjerimet që dalin shërbejnë për përmirësimin e programit të studimit, si për shembull përmirësimi i infrastrukturës laboratorike. Dokumentimi i këtyre përfitimeve konsiderohet nga GVJ si praktikë e mirë. Megjithatë, GVJ evidenton kufizimet në bashkëpunimet me klinikat profesionale për zhvillimin e praktikave, që ka nevojë për përmirësim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” bazohet në parimet e lirisë dhe cilësisë akademike. Këto parime janë përfshirë në rregulloren e programit, ku liria akademike nënkupton respektimin e mendimeve dhe metodave të ndryshme, si dhe zhvillimin kritik dhe krijues të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Kërkimi shkencor është në përputhje me fushat e ekspertizës dhe statusin e UST, i cili është një institucion i pavarur dhe i veçantë në arsimin e lartë, me fokus akademik dhe olimpiq. Sipas statutit të UST, ky institucion ofron programe studimi në të gjitha ciklet, përfshirë ato profesionale në fushat e edukimit fizik, sporteve, menaxhimit sportiv dhe rehabilitimit. Qëllimi i UST është të konsolidojë vlerat akademike dhe kulturore, duke ofruar kualifikime në fushën e edukimit fizik dhe sportiv, menaxhimit sportiv, rekreacionit dhe shëndetit. Programi Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" synon të formojë profesionistë të aftë për rehabilitimin e dëmtimeve sportive, me mundësi karriere në ekipet sportive dhe shërbime shëndetësore. Programi është hartuar në përputhje me vizionin, statusin, misionin dhe objektivat strategjike të UST. <i>Ref. 3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 14. Plani mësimor 2023-2024;</i> <i>Ref. 20. Dosja e programeve-syllabuse;</i> <i>Ref. 23.4. Tabela përmbledhëse, model programi.</i> <i>Ref. 4. Plani Strategjik FSHR 2021-2026;</i> <i>Ref. 4.1. Plani strategjik UST 2021-2026;</i> <i>Ref. 4.2. Plani Strategjik UST 2021-2025.</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Në Rregulloren e programit të studimit (neni 8), Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”, janë të përcaktuara qartë parimet e zhvillimit të veprimtarisë mbi baza të lirisë dhe cilësisë akademike. Liria akademike në mësimdhënien akademike nënkupton respektimin e shumëllojshmërisë së opinioneve, ideve e metodave dhe garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Kjo liri akademike ushtrohet në përputhje me planet dhe programet mësimore të hartuara e miratuara nga strukturat akademike të FSHR, UST, për

	të gjitha lëndët/modulet që përfshihen në të. Kërkimi shkencor në fushën e edukimit fizik dhe shëndetësor, sporteve, rekreacionit, turizmit sportiv dhe rehabilitimit që zhvillon stafi akademik është në bazë të fushës së ekspertizës dhe statusit të veçantë të institucionit. <i>Ref. 3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> - Takimi me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takimi me stafin akademik.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit Master Profesional “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” me kohëzgjatje 1 vit akademik (2 semestra) dhe në total 60 kredite, nuk përfshin module specifike me qëllim rritjen e kapaciteteve kërkimore-shkencore të studentëve. Edhe pse studentët raportuan se, sipas dëshirës, mund të ishin pjesë e aktiviteteve shkencore që UST organizonte, angazhimi i tyre në këto aktivitete dhe në projekte kërkimore nuk ishte i dokumentuar. GVJ sugjeron që përfshirja e studentëve në veprimtari kërkimore-shkencore duhet të jetë në fokus të politikave institucionale dhe dokumentimi i përfshirjes së tyre duhet të jetë praktikë e rregullt në institucion. <i>Ref. 14. Plani mësimor 2023-2024;</i> <i>Ref. 20. Dosja e programeve-syllabuse;</i> <i>Ref. 23.4. Tabela përmbledhëse, model programi;</i> - Takimi me Drejtuesit e Njesisë Kryesore, Bazë; - Takimi me stafin akademik; - Takim me studentët.
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Në takimet e zhvilluara me Drejtuesit e Njesisë Kryesore, Bazë, përfaqësues të zyrës së projekteve dhe kërkimit shkencor, dhe me stafin akademik, u raportua se stafi akademik mbështetet rregullisht financiarisht nga UST për pjesëmarrje në aktivitete shkencore, për publikim artikujsh, apo në përfitimin e granteve kërkimore institucionale nëpërmjet aplikimit për grante për projekte apo botim të artikujve. Në pasqyrat financiare vjetore të dhënat e kërkimit shkencor janë të prezantuara në mënyrë të detajuar sipas llojit të aktiviteteve në nivel njësie bazë. Në vitet e fundit, numri i botimeve të stafit akademik efektiv të DK përgjegjës për programin e studimit është 37, numri i projekteve kërkimore shkencore të fituara dhe

	zbatuara janë respektivisht 4, numri i aktiviteteve të organizuara është 4, dhe numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore është 8. Ref. 3. Statuti i Universitetit të Sporteve; Ref. 7. Rregullore UST; Ref. 28. Pasqyrat financiare vjetore 2023 TAB 18; - Takimi me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë; - Takimi me stafin akademik.			
Konkluzione	UST ofron programe në ciklet e ndryshme të studimit, me fokus në edukimin fizik, sportet dhe rehabilitimin. Programi i Masterit Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" synon të formojë profesionistë për rehabilitimin e dëmtimeve sportive dhe mundësi karriere në ekipet sportive dhe shërbime shëndetësore. Programi i studimit fokusohet në lirinë dhe cilësinë akademike, duke inkurajuar mendime dhe metoda të ndryshme, si dhe zhvillimin e kërkimit shkencor. Programi zhvillohet në një periudhë 1-vjeçare dhe përmban gjithsej 60 kredite të shpërndara në lëndët sipas strukturës së planit mësimor. Plani mësimor nuk përfshin module për rritjen e kapaciteteve kërkimore-shkencore të studentëve, edhe pse ata mund të angazhohen në aktivitete shkencore që nuk janë specifikisht të dokumentuara. GVJ sugjeron që përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor të bëhet pjesë e politikave institucionale. Në takimet me drejtuesit dhe stafin akademik, u raportua se stafi mbështetet financiarisht nga UST për aktivitete shkencore, publikime dhe grante kërkimore. Në pasqyrat financiare vjetore, aktivitetet e kërkimit shkencor janë të detajuara. Në vitet e fundit, stafi akademik i programit ka realizuar 37 botime, 4 projekte kërkimore dhe aktivitete shkencore, me 8 pjesëmarrës në to.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura	UST mbështet zhvillimin e kërkimit shkencor përmes pjesëmarrjes në projekte në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo pjesëmarrje në projekte ka sjell krijimin e partneriteteve me struktura dhe institucione kërkimore brenda dhe jashtë vendit. Pjesëmarrja aktive në projekte, aktivitete shkencore dhe përfitimet në programet e

të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	studimit që UST ofron u pohuan edhe nga takimet me anëtarët e Komisionit të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe stafin akademik. Bashkëpunimi me Federatën Shqiptare të Futbollit dhe klubet sportive u jep mundësinë studentëve dhe stafit akademik të zhvillojnë kërkime shkencore në fushën e rehabilitimit sportiv dhe jo vetëm. <i>Ref. 24.1. Marrëveshje Bashkëpunimi me Federatën Kombëtare të Futbollit;</i> <i>Ref. 24.2. Marrëveshjet në klubet sportive për organizimin e praktikave profesionale;</i> <i>Ref. 24. Lista e marrëveshjeve kombëtare ndërkombëtare;</i> <i>Ref. 26. Miratimi i projekteve shkencore 2023-2024;</i> <i>-Takimi me anëtarë të sektorit të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore;</i> <i>-Takimi me stafin akademik.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	UST merr pjesë rregullisht në projekte kërkimore shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Çdo vit, stafi akademik aplikon për projekte të financuara nga MASR, AKKSHI, ose thirrje të Bashkimit Evropian. Studentët angazhohen në këto projekte për aktivitete të ndryshme, si mbledhja e të dhënave dhe aktivitete të tjera mbështetëse. Raportet vjetore të njësive përgjegjëse paraqesin gjithashtu përfitimet e tjera të projekteve dhe aktiviteteve shkencore. <i>Ref. 18. Model analize vjetore e DK;</i> <i>Ref. 18.1. Model analize vjetore FSHR;</i> <i>Ref. 26. Miratimi i projekteve shkencore 2023-2024;</i> <i>Ref. 25.1. Raport mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, projekti E - PHYSIO;</i> <i>Ref. 39. Tabelat përmbledhëse institucionale;</i> <i>Ref. 38. Përcjellje e raportit vjetor 2023 në nivel rektorati;</i> <i>-Takimi me anëtarë të sektorit të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore;</i> <i>-Takimi me stafin akademik.</i>

Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Institucioni merr pjesë në konferenca dhe aktivitete kërkimore shkencore. UST mbështet gjithashtu aktivitetet individuale të stafit akademik, si botimet në revista shkencore, pjesëmarrjen në projekte kërkimore, dhe në konferenca shkencore brenda fushës dhe misionit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit. <i>Ref. 18. Model analize vjetore e DK;</i> <i>Ref. 18.1. Model analize vjetore FSHR;</i> <i>Ref. 26. Miratimi i projekteve shkencore 2023-2024;</i> <i>Ref. 25.1. Raport mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, projekti E - PHYSIO;</i> <i>Ref. 39. Tabelat përmbledhëse institucionale;</i> <i>Ref. 38. Përcjellje e raportit vjetor 2023 në nivel rektorati;</i> <i>-Takimi me anëtarë të sektorit të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore;</i> <i>-Takimi me stafin akademik.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit mundëson përgatitjen e studentëve për tregun e punës në fushën e rehabilitimit fizik. Zhvillimi i praktikave profesionale në klubet sportive dhe bashkëpunimi me Federatën Shqiptare të Futbollit u mundëson studentëve të kenë kontakt direkt me tregun e punës. Ndërthurja e leksioneve me seminarët, labororet dhe praktikat mësimore u jep mundësinë studentëve të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për tregun e punës. Në takimet e zhvilluara u raportua se pjesa më e madhe e studentëve të angazhuar në programin e studimit synonin tregun kombëtar të punësimit. Po ashtu të gjithë studentët ishin të ndërgjegjshëm që programi i studimit ofron larmishmëri punësimi dhe në tregun ndërkombëtar të punës. <i>-Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë;</i> <i>-Takim me stafin akademik;</i> <i>-Takim me studentët;</i> <i>-Takimi me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së	Gjatë takimit me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë, u evidentuan përpjekjet e institucionit për marrjen e licencës së studentëve të FSHR, sipas akteve ligjore të fushës. Kjo gjë u mundësonte atyre punësim në shumë sektorë të rehabilitimit sportiv dhe klinikave rehabilituese. <i>-Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Bazë.</i>

profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.				
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i studimit Master Profesional “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në vend, si dhe me rekomandimet ndërkombëtare dhe direktivat e Rregullores së Bashkimit Evropian. Rregullorja e programit është në përputhje me Ligjin 80/2015, si dhe me Rregulloren dhe Statutin e UST, ndërsa plani mësimor përfshin të gjithë elementët e nevojshëm për realizimin e objektivave të programit. <i>Ref. 3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 8. Rregullore FSHR;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e DK;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 14. Plan mësimor 2023-2024.</i>			
Konkluzione	<i>UST mbështet kërkimin shkencor përmes projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, duke krijuar partneritete me institucione kërkimore brenda dhe jashtë vendit. Pjesëmarrja në këto projekte është konfirmuar nga Komisioni i Kërkimit dhe stafi akademik. Bashkëpunimi me Federatën Shqiptare të Futbollit dhe klubet sportive mundëson zhvillimin e kërkimeve në rehabilitimin sportiv. Shumica e studentëve synojnë tregun kombëtar të punës, por janë të ndërgjegjshëm për mundësitë ndërkombëtare për punësim që ofron programi i studimit. Takimet me Drejtuesit theksuan përpjekjet për licencimin e studentëve të FSHR-së, duke u mundësuar atyre punësim në rehabilitimin sportiv dhe klinikat rehabilituese. Programi Master Profesional “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” është hartuar në përputhje me ligjet dhe rekomandimet ndërkombëtare, me një plan mësimor që mbulon të gjitha elementët e nevojshëm për realizimin e objektivave të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Veprimtaritë formuese dhe përbërëse mësimore të programit të studimit Master Profesional “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” përfshijnë dhe janë të organizuara në përputhje me Rregulloren e UST (neni 74) dhe Rregulloren e FSHR (neni 49). Komponentët mësimor ndahen në: mësim në auditor si leksione, seminarë, ushtrime, laboratorë, ushtrime fizike në terren, forma të kontrollit të vazhdueshëm, seanca të praktikave profesionale etj., studim individual si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje për provime dhe veprimtari të tjera si praktika profesionale në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private. Në Rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë organizimi dhe vlerësimi i praktikave profesionale (neni 13) dhe format e mësimin (neni 14). Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 75%, seminarët 100%, mësimi praktik 100% dhe frekuentimi i punëve laboratorike në masën 100%. Kohëzgjatja e seancave mësimore (në minuta) është sipas përcaktimeve të akteve nënligjore. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 8. Rregullore FSHR;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Për ofrimin e këtij programi, stafi akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, si diskutime në klasë, laboratorë, raste klinike dhe ilustrime me video dhe foto. Ata gjithashtu përdorin prezantime në PowerPoint gjatë leksioneve, dhe infrastruktura në mbështetje të mësimdhënies është e përshtatshme. Ndërthurja e leksioneve me laboratorët dhe diskutimi i rasteve nga praktika u ofron studentëve mundësinë të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për tregun e punës. <i>Ref. 7. 23.5. Të dhëna tabelore për infrastrukturën, laboratore;</i> <i>Ref. 7. 23.5.1. Të dhëna për infrastrukturën;</i>

	<i>Ref. 7. 23.6. Të dhëna tabelore për infrastrukturën mbështetese për procesin mësimor;</i> <i>Ref. 39. Tabelat përmbledhese institucionale;</i> <i>-Takim me stafin akademik;</i> <i>-Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	UST mbështet stafin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike përmes mundësive të ndryshme. Stafi mbështetet financiarisht për pjesëmarrje në konferenca, simpoziume dhe për botime shkencore. Shkëmbimi i eksperiencave përmes programit Erasmus+ mundëson zhvillimin e mobiliteteve afatshkurtra për mësimdhënie ose trajnim. <i>Ref. 24. Lista e marrëveshjeve kombëtare ndërkombëtare;</i> <i>Ref. 39. Tabelat përmbledhese institucionale;</i> <i>-Takim me stafin akademik.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Një nga misionet e Planit Strategjik të UST është edhe kualifikimi i vazhdueshëm i stafit akademik dhe kërkimor shkencor në fushat e edukimit fizik, shëndetit dhe rekreacionit. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master Profesional “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” ka njohuritë, aftësitë dhe ekspertizën e duhur në përputhje me fushën e veprimtarisë së programit, të faktuara në dosjen personale të çdo anëtarit. Politikat e rekrutimit të stafit akademik bazohen në disa kritere specifike (përfshirë këtu notën mesatare të studimeve, gradën shkencore dhe titujt, veprimtarinë kërkimore shkencore dhe përvojën e mëparshme në mësimdhënie). Stafi akademik konfirmoi se përdor metoda interaktive gjatë mësimdhënies dhe se qëllimi i tyre është mësimdhënia me në qendër studentin, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të tyre në mësim me diskutime edhe të rasteve praktike, e konfirmuar edhe nga studentët. <i>Ref. 21.1. CV e stafit akademik;</i> <i>Ref. 21.Formati i dosjes personale të stafit akademik;</i> <i>Ref. 11.1. Procedurë rekrutimi personel akademik UST;</i> <i>Ref. 11.2. Relacion mbi procedurën e rekrutimit të personelit akademik;</i> <i>-Takim me stafin akademik;</i> <i>-Takim me studentët.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe	Studentët e programit Master Profesional “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” janë të angazhuar në vlerësimin e metodave të mësimdhënies përmes pyetësorëve dhe diskutimeve

përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	në fokus grupe. Ata mund të shprehin lirshëm mendimet dhe idetë e tyre në lidhje me pedagogët e lëndës. Respektimi i kodit të etikës është një detyrim për të dyja palët, stafin akademik dhe studentët. NJSBC përpunon të dhënat e pyetësorëve dhe harton raporte, ndërsa në bazë të rezultateve, ndërmerren hapa për përmirësimin e çështjeve të raportuara nga studentët dhe stafi akademik. <i>Ref. 32. Model pyetësori;</i> <i>Ref. 32.1. Model raport i fokus grupeve të studentëve;</i> <i>Ref. 32.8. Model raporti i analizës vjetore të NJSBC 2023-2024;</i> <i>Ref. 32.3. Model raporti i FSHR NJSBC;</i> <i>-Takim me stafin akademik;</i> <i>-Takim me përfaqësues të NJSBC;</i> <i>- Takimi me studentët.</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Institucioni ka ngritur NJSBC-në, e cila harton standardet për sigurimin e cilësisë së brendshme në përputhje me Kodin e Cilësisë Institucionale. Përfaqësues të sektorit raportuan se janë të angazhuar në të gjitha proceset e përmirësimit të cilësisë, të cilat zhvillohen sipas detyrimeve ligjore dhe procedurave standarde të UST. Në nivel institucional, funksionojnë komisione të përhershme, si Komisioni i promovimit të personelit akademik, Komisioni i kërkimit, projekteve dhe botimeve shkencore, Komisioni i marrëdhënieve me studentët dhe Komisioni i sigurimit të cilësisë dhe kurrikulave https://ust.edu.al/#. Këto komisione asistojnë stafin akademik në përmirësimin e aftësive të tyre, duke organizuar aktivitete shkencore dhe duke mbështetur pjesëmarrjen në aktivitete akademike dhe shkencore. <i>Ref. 3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 32.7. Rregullore e NJSBC;</i> <i>-Takim me stafin akademik;</i> <i>-Takim me përfaqësues të NJSBC.</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master Profesional "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" zhvillohet sipas Rregulloreve të UST dhe FSHR, duke përfshirë leksione, seminare, praktika dhe detyra individuale. Frekuentimi është i detyrueshëm: 75% për leksionet, 100% për seminarët dhe praktikën, dhe 100% për laboratorët. Stafi përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, si diskutime, laboratorët dhe raste klinike, duke përfshirë prezantimet në</i>



	<i>PowerPoint. Kombinimi i teorisë dhe praktikave zhvillon aftësitë e studentëve për tregun e punës. Plani Strategjik i UST synon kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik. Stafi i programit ka ekspertizën e nevojshme dhe përdor metoda interaktive për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të studentëve. Studentët vlerësojnë mësimdhënien përmes pyetësorëve dhe diskutimeve në fokus-grupe, duke respektuar kodin e etikës. NJSBC, njësia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, përpunon të dhënat dhe ndërmerr masa për përmirësimin e problematikave të raportuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në Rregulloren e UST (nenet 80-82) dhe të FSHR (nenet 68-70) janë përcaktuar mënyrat e testimit dhe vlerësimit të studentëve. Sistemi i vlerësimit është me 10 nota, ku nota minimale kaluese është 5 dhe nota maksimale është 10. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit janë të përcaktuara edhe në rregulloren e programit (neni 19). Format e vlerësimit përfshijnë provime me shkrim, me gojë, detyra kursi, dhe kombinime të këtyre formave. Vlerësimi për secilën lëndë bëhet pas përfundimit të saj dhe jepet në sistemin e notave. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 8. Rregullore FSHR;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 20. Dosja e programeve-syllabuse.</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në Rregulloren e UST (nenet 80-82) janë të përcaktuara metodat e vlerësimit dhe se mënyrat e vlerësimit duhet të jenë të pasqyruara në programin lëndor (syllabuset e çdo lënde) dhe në rregulloren e programit të studimit dhe t'i bëhen të ditura studentëve nga pedagogu i lëndës në fillim të procesit mësimor. Studentët orën e parë të lëndës informohen nga pedagogu respektiv mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Ky fakt u konfirmua edhe gjatë takimeve si nga stafi akademik, po ashtu dhe nga studentët.

	Ref. 7. Rregullore UST; Ref. 8. Rregullore FSHR; Ref. 6. Rregullore e MP; Ref. 20. Dosja e programeve-syllabuse; Ref. 22. Model program i lëndës Rehabilitim në Dëmtimet Sportive; -Takim me stafin akademik; -Takimi me studentët.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme dhe përfshin kontrollin dhe vlerësimin e vazhdueshëm dhe përfundimtar për çdo modul. Kontrolli i vazhdueshëm për lëndët teorike përfshin vlerësimin për përmbushjen e detyrimeve të lëndës (10%), provim të ndërmjetëm (20%) dhe provim përfundimtar (70%). Sistemi i vlerësimit të dijeve, format e vlerësimit dhe format e kontrollit të dijeve (me shkrim, me gojë ose të kombinuara) janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e UST (nenet 68-70) dhe të pasqyruara në syllabusin e çdo lënde të programit. Rezultati përfundimtar i kontrollit të dijeve përfshin vlerësimin e të gjithë elementëve të studimit të parashikuar në programin mësimor. Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj me sistemin e notave, ku 5 është nota minimale kaluese dhe 10 është nota maksimale. Ref. 7. Rregullore UST; Ref. 8. Rregullore FSHR; Ref. 6. Rregullore e MP; Ref. 20. Dosja e programeve-syllabuse; Ref. 22. Model program i lëndës Rehabilitim në Dëmtimet Sportive.
Konkluzione	Në Rregulloren e UST (nenet 80-82) dhe të FSHR (nenet 68-70) janë përcaktuar metodat dhe format e vlerësimit të studentëve. Sistemi i vlerësimit është me 10 nota, ku nota minimale kaluese është 5 dhe nota maksimale është 10. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit janë pasqyruar në syllabusin e secilës lëndë dhe në rregulloren e programit të studimit. Studentët informohen për metodologjinë e testimit dhe vlerësimit nga pedagogu në fillim të procesit mësimor. Testimi dhe vlerësimi përfshin kontrollin e vazhdueshëm dhe përfundimtar për çdo modul. Për lëndët teorike, vlerësimi bëhet me detyrime të përmbushura (10%), provim të

	ndërmjetëm (20%) dhe provim përfundimtar (70%). Rezultati përfundimtar përfshin vlerësimin e të gjithë elementëve të programit mësimor dhe jepet me nota nga 5 deri në 10.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i studentit mbështetet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe përfundimtar semestral të çdo lënde të planit mësimor. Vlerësimi i vazhdueshëm për përmbushjen e detyrimeve të lëndës përfshin vlerësimin e seminareve, punëve laboratorike, përgatitjes së detyrave të kursit dhe praktikave profesionale, etj. Ky vlerësim përbën 10% të vlerësimit të përgjithshëm të lëndës. Provimi i ndërmjetëm është pjesë e kontrollit të vazhdueshëm të njohurive dhe përbën 20% të vlerësimit të përgjithshëm, ndërsa provimi përfundimtar përbën 70% të vlerësimit të përgjithshëm. Modalitetet e testimit dhe vlerësimit të njohurive janë të paracaktuara qartë në rregulloren e UST-së. Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brenda lëndës janë të pasqyruara edhe në syllabusin e çdo lënde, dhe u bëhen të ditura studentëve nga pedagogu i lëndës në orën e parë të mësimin të secilës lëndë. Në fund të çdo lënde, studenti vlerësohet me notë, e cila është shuma e peshës specifike të formave të kontrollit të vazhdueshëm të paracaktuara në syllabusin e çdo lënde. Vlerësimi i vazhdueshëm u diskutua gjithashtu në takimet me stafin akademik dhe studentët. <i>Ref. 7.1. Rregullore UST NENI 82;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 22. Model program i lëndës Rehabilitim në Dëmtimet Sportive;</i> <i>-Takim me stafin akademik;</i> <i>-Takimi me studentët.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme	Programi i studimit Master Profesional “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” përbëhet nga një plan mësimor i organizuar në lëndë teorike dhe praktike në raportin 40%:60%. Si rrjedhojë, siç u raportua nga takimet me stafin akademik, sistemi

abuzimi dhe rrisin transparencën.	elektronik i testimit nuk aplikohet. Rezultatet e testimeve u bëhen të ditura studentëve përmes platformës Pitagora, në respekt të konfidencialitetit dhe transparencës. Kjo bën që studentët të informohen në kohë reale për rezultatet e vlerësimit. <i>Ref. 14. Plani mësimor 2023-2024;</i> <i>Ref. 30.1. Udhëzues për përdorimin e sistemit PITAGORA;</i> <i>-Takim me stafin akademik;</i> <i>-Takimi me studentët.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet sipas përcaktimeve të parashikuara në syllabusin e çdo lënde në përputhje me aktet rregullatore institucionale dhe legjislacionin në fuqi. Vlerësimi përfundimtar i lëndëve teorike përfshin: vlerësimin për përmbushjen e detyrimeve të lëndës (10%), provimin e ndërmjetëm (20%) dhe provimin përfundimtar (70%). Në rastin e praktikës profesionale, studenti duhet të paraqesë një relacion të punës së kryer dhe vlerësohet nga mbikëqyrësi i praktikës. Të gjitha vlerësimet merren në konsideratë nga komisioni i departamentit për vlerësimin e studentit me notë. Nëse studenti nuk paraqitet në datën e caktuar, në procesverbalin e praktikës shënohet “Nuk u paraqit” dhe ai shpallet mbetës. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 20. Dosja e programeve-syllabuse.</i> <i>-Takim me studentët;</i> <i>-Takim me stafin akademik.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Rezultatet e provimeve u bëhen të njohura studentëve nga komisioni pas zhvillimit të provimit me gojë dhe pas përfundimit të korrigjimit të provimeve me shkrim. Pedagogu i lëndës informon studentët për pikët e marra në provime, kontrollin e ndërmjetëm, provimin përfundimtar dhe detyrat e kursit. Po ashtu, ai u komunikon studentëve edhe notën përfundimtare të lëndës ose të Praktikës Profesionale në platformën PITAGORA. Pas shpalljes së rezultateve paraprake në sistem ose komunikimit të tyre, studentët kanë mundësi t'i kontrollojnë notat dhe mund të kontestojnë rezultatet brenda afateve të përcaktuara në rregullore, nëse është e nevojshme. Nëse nuk ka kontestime, nota përfundimtare merret si e tillë dhe komisioni e mbyll procesverbalin në sistem. Në rastet kur detyrat e kursit paraqiten në formë prezantimesh orale, pedagogu mban shënime gjatë



	prezantimit dhe ia komunikon studentit vlerësimin përfundimtar, duke përfshirë edhe pikët. Po ashtu, gjatë korrigjimit të provimeve me shkrim, bëhen shënime për përgjigjet e sakta dhe ato të gabuara, të cilat mund të shqyrtohen nga studentët gjatë konsultimeve të tezës. Studentët gjithashtu kanë mundësi të diskutojnë me pedagogun për paqartësitë ose gabimet që mund të kenë pasur në provim. Ky proces është pohuar edhe nga takimet me studentët dhe stafin akademik. <i>Ref. 7. Rregullore UST; RVB (Raporti i Vlerësimit të Brendshëm në FSHR) -Takim me stafin akademik. Takim me studentët.</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Mënyra e organizimit të provimeve dhe rregullat që duhet të zbatohen gjatë zhvillimit të tyre janë të parashikuara në rregulloren e institucionit (neni 99). Komisioni i provimit është përgjegjës për mbarëvajtjen e provimit dhe asistohet në këtë proces edhe nga personeli ndihmës akademik. Gjatë zhvillimit të provimit ndalohet hyrja e personave të jashtëm, qofshin edhe anëtarë të stafit akademik të universitetit. Bëjnë përjashtim vetëm personat e autorizuar me shkrim nga Dekani apo Rektori për të kryer kontroll. Studentët duhet të paraqiten në provim vetëm me kartën e identitetit dhe nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë. Kopjimi dhe komunikimi me studentë të tjerë ndëshkohet me përjashtimin nga provimi dhe vlerësimin me notë jo kaluese. <i>Ref. 7. Rregullore UST; RVB (Raporti i Vlerësimit të Brendshëm në FSHR) -Takim me stafin akademik.</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Afatet dhe modalitetet për dhënien e rezultateve të kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit. Dorëzimi i vlerësimit të provimeve me gojë duhet të bëhet të ditura studentëve në përfundim të provimit nga pedagogu i lëndës. Në rastin e provimeve me shkrim, rezultatet bëhen të ditura brenda 5 ditëve nga data e zhvillimit të provimit. Informimi i studentëve në lidhje me rezultatet bëhet në sistemin elektronik dhe pranë sekretarisë mësimore nëse sistemi elektronik për arsye të ndryshme nuk funksionon. Një kopje të pasqyrës së detyrimeve dhe provimit ruhet në sekretari. Rezultatet e vlerësimit bazohen në merita. Nëse një student nuk është i kënaqur me rezultatin, ka të drejtë të përmirësojë notën (neni 59,

	Rregullore e UST). Kërkesa për përmirësim note i paraqitet dekanit në fillim të sezonit të vjeshtës. Nëse dekanati miraton kërkesën, drejtuesi i departamentit dhe sekretaria mësimore bashkërendojnë punën për të realizuar të gjithë procedurën e përmirësimit të notes sipas akteve rregullatore institucionale. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>-Takim me stafin akademik;</i> <i>-Takim me studentët.</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë në provim, nëpërmjet ankimit zyrtar drejtuar pedagogut të lëndës dhe dekanit (Rregullore e UST, neni 104). Pas përfundimit të vlerësimit, çdo pedagog i mundëson studentëve konsultimin në kohë reale të rezultateve nëpërmjet platformës online PITAGORA. Nëse studenti nuk është dakord me rezultatet e vlerësimit, bazuar në rregullore ka të drejtë që brenda 48 orëve nga komunikimi i rezultateve të rishikojë dhe sqarohet çdo pretendim që ka në lidhje me vlerësimin. Nëse brenda afatit të përcaktuar nuk ka kontestime, printohet <i>Pasqyra e rezultateve</i>, e cila nënshkruhet nga pedagogu /komisioni i provimit dhe dorëzohet në Sekretarinë Mësimore. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>-Takim me stafin akademik;</i> <i>-Takim me studentët.</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Ankimi i studentëve në lidhje me rezultatet e vlerësimit është i parashikuar në rregulloren e UST (neni 102). Ankesa bëhet me shkrim brenda 2 ditëve të punës nga dita e shpalljes së rezultatit të provimit dhe i drejtohet pedagogut të lëndës dhe dekanit. Dekani përcakton nëse ankesa është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës brenda dy ditëve nga paraqitja e ankesës. Vendimi është i formës së prerë. Nga takimet e bëra nuk u raportua asnjë rast ankimimi të studentëve për vlerësimin e dijeve/njohurive. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>-Takim me stafin akademik;</i> <i>-Takim me studentët.</i>
Konkluzione	<i>Vlerësimi i studentëve në programin e studimit "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" përfshin një sistem të strukturuar që</i>

	<i>mbështetet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe përfundimtar. Vlerësimi i vazhdueshëm përfshin seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit dhe praktikat profesionale, dhe ka një peshë prej 10% të vlerësimit të përgjithshëm. Provimi i ndërmjetëm ka një peshë 20%, ndërsa provimi përfundimtar merr 70% të vlerësimit. Rezultatet e vlerësimit bëhen të njohura për studentët përmes platformës elektronike PITAGORA. Procedurat për vlerësim janë të pasqyruara qartë në syllabusin e çdo lënde dhe rregulloren e institucionit. Studentët kanë mundësi të ankimjnë rezultatet nëse nuk janë të kënaqur, dhe kërkesat për përmirësimin e notës mund të bëhen brenda afateve të përcaktuara. Vlerësimi përfshin gjithashtu mundësinë për të diskutuar me pedagogun për paqartësitë dhe gabimet që mund të kenë ndodhur gjatë provimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<i>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</i>	Programi i studimit “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” është program i Ciklit të Dytë të Studimeve që ofrohet në Departamentin e Kineziologjisë, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, Universiteti i Sporteve Tiranë. Programi Master Profesional zgjat 1 vit, 2 semestra akademike me kohë të plotë, me 60 kredite (ECTS) gjithsej. Programi Master Profesional “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” ka si qëllim formimin e profesionistëve të fizioterapisë, të cilët do të jenë të aftë të zhvillojnë njohuri, aftësi dhe shkathtësi të thelluara profesionale në fushën e rehabilitimit. Ata mund të punojnë në ekipe sportive, shërbime shëndetësore të nivelit primar, sekondar dhe terciar, me fokus në trajtimin e dëmtimeve traumatologjike, ortopedike dhe kirurgjikale. Arritja e qëllimeve të programit dhe rezultateve të pritura të të nxënit sigurohet përmes planit mësimor të strukturuar, i cili përmban një kombinim të lëndëve bazë, specifike, ndërdisiplinore dhe shtesë, që mundëson dhe garanton thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive të veçanta profesionale.

	<i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 14. Plani mësimor 2023-2024.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit Master Profesional “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” nuk përfshin lëndë në fushën e teknologjisë së informacionit. Zhvillimi i aftësive të veçanta në fushën humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit mundësohet nga lëndë të tilla si: Principet e Menaxhimit dhe Sipërmarrjes, Fiziologjia dhe Principet e Lëvizjes në Performancën Fizike, Dhimbja, Menaxhimi dhe Rehabilitimi, të cilat janë pjesë e planit mësimor të programit të studimit. <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 14. Plani mësimor 2023-2024.</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblyëse.	Në përfundim të lëndës, pedagogu/pedagogët respektivë të lëndës/ve, si rregull, në seminarin e fundit, pas një përmbledhjeje të koncepteve dhe temave të zhvilluara gjatë gjithë semestrit, diskutojnë me studentët, i orientojnë ata për provimet dhe çfarë mund të përmirësohet në vijim. Edhe detyrat e kursit, diskutimi i rasteve nga praktika, ishte një metodë tjetër që përdorej për të evidentuar çështje të rëndësishme që lidhen me zhvillimin profesional të studentëve. Kjo metodologji pune u konfirmua si nga studentët dhe stafi akademik në takimet gjatë vizitës institucionale. <i>-Vizita në institucion: Takimi me stafin akademik dhe Takimi me studentët.</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e	Studentët për këtë program studimi zhvillojnë leksione, seminare, orë laboratorike si dhe praktikë profesionale. Paralelisht, Institucioni organizon rregullisht leksione të hapura, konferenca, workshop-e etj., të cilat u japin mundësinë të rrisin dhe të thellojnë njohuritë e tyre. Syllabuset e programit të studimit përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që marrin gjatë zhvillimit të moduleve/lëndëve. Studentët kanë mundësi të aplikojnë njohuritë teorike që marrin gjatë praktikave në klubet sportive dhe klinikat rehabilituese. Raporti teori-praktikë 40:60 i planit mësimor të programit tregon një orientim për krijimin e një klime të favorshme për përshtatje më të mirë me praktikat dhe punësimin. Diskutimi i hapur i rasteve nga praktika që mbështeste dhe punën në grup ishte një nga metodat e mësimdhënies që përdorej shpesh dhe u raportua si nga studentët dhe stafi akademik. Kjo ndihmonte në zhvillimin e ideve inovative dhe integrimin e teorisë në praktikë dhe

shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	anasjelltas. Institucioni është aktiv në mobilitete si të studentëve dhe stafit, të cilat ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve të mësimdhënies dhe përfitimin e përvojave të reja në këtë drejtim. <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 20. Dosja e programeve-syllabuse;</i> <i>Ref.29. Kalendari i aktiviteteve FSHR për vitet 2023-2024;</i> <i>-Takim me studentët;</i> <i>-Takim me stafin akademik.</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Institucioni organizon rregullisht orë të hapura dhe seminare mbi fushën e veprimtarisë të programeve të studimit që ofron. Këto aktivitete organizohen nga stafet akademike efektive me pjesëmarrjen e studentëve dhe të personaliteteve të njohura të fushës me impakt në zhvillimin profesional të studentëve. <i>Ref.29. Kalendari i aktiviteteve FSHR për vitet 2023-2024;</i> <i>Ref.38. Përcjellje e raportit vjetor 2023 në nivel Rektorati;</i> <i>-Takim me studentët;</i> <i>-Takim me stafin akademik.</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Pjesëmarrja dhe nxitja e studentëve për zhvillimin e ideve inovative është një nga objektivat e planit strategjik të institucionit. UST organizon periodikisht konferencën institucionale ndërkombëtare dhe studentët kanë sesionin e tyre të dedikuar për të prezantuar punimet e tyre kërkimore shkencore pa tarifë regjistrimi. Një pjesë nga granti kërkimor shkencor mund të përdoret për të mbështetur financiarisht aktivitete shkencore të studentëve. <i>Ref. 4.1. Plani strategjik UST 2021-2026 objektivat;</i> <i>Ref. 4.2. Plani strategjik UST 2021-2025 kërkimi shkencor;</i> <i>-Takim me stafin akademik;</i> <i>-Takim me studentët.</i>
Konkluzione	Programi i studimit "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" është një program masteri i orientuar drejt formimit të profesionistëve të fizioterapisë, të cilët do të jenë të aftë të trajtojnë dhe rehabilitojnë dëmtimet traumatologjike, ortopedike dhe kirurgjikale në fusha të ndryshme shëndetësore dhe sportiv. Ky program, me një periudhë 1-vjeçare dhe 60 kredite, ofron një plan mësimor të balancuar që kombinon lëndë teorike dhe praktike. Studentët zhvillojnë njohuri të thelluara në fizioterapi dhe kanë mundësi të aplikojnë ato në praktikat sportive dhe klinikat rehabilituese. Metodot e mësimdhënies përfshijnë leksione,

	seminare dhe praktika profesionale, duke ofruar mundësi për zhvillimin e ideve inovative dhe aftësive profesionale. Institucioni mbështet gjithashtu mobilitetin ndërkombëtar dhe ofron mundësi për zhvillimin e aktiviteteve shkencore dhe kërkimore për studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Neni 107 i Rregullores së Institucionit përcakton mënyrat e diplomimit të studentëve për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë. Studentët në programin e studimit Master Profesional "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar. Kriteret e diplomimit janë të përcaktuara specifikisht në Rregulloren e programit (neni 16, nenet 30-32). Në Rregulloren e Njesisë Kryesore (neni 50) dhe Rregulloren e DK nuk janë të përfshira kriteret e diplomimit të studentëve të ciklit të dytë të studimeve. GVJ sugjeron përditësim të rregulloreve me elementët përkatës të diplomimit. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 8. Rregullore FSHR;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e DK.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Për të marrë diplomën në ciklin e dytë të studimeve "Master Profesional", studenti duhet të kalojë me sukses provimin përfundimtar. Për t'u kualifikuar për të marrë pjesë në këtë provim, studenti duhet të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët dhe praktikat, duke plotësuar gjithashtu kreditet e kërkuara. Banka e pyetjeve përgatitet duke u bazuar në përzgjedhjen e lëndëve kryesore formuese. Studentët informohen për bankën e pyetjeve në fillim të semestrit të fundit. Teza përfshin gjithsej 100 pikë, të cilat ndahen në mënyrë të barabartë mes lëndëve që përfshihen në provimin e diplomës. Ajo hartohet nga komisioni, i cili përbëhet nga të paktën tre anëtarë të stafit

	akademik nga njësia që ofron programin e studimit. Zyra e Sekretarisë mësimore njofton studentët mbi organizimin e provimit të diplomimit, ndërsa departamenti përkatës u siguron studentëve materialet dhe udhëzimet e nevojshme. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 33. Rregullore e diplomimit neni 107;</i> <i>Ref.12. Model teze provimi i përgjithshëm;</i> <i>-Takim me stafin akademik;</i> <i>-Takim me përfaqësues të sekretarisë mësimore;</i> <i>-Takim me Drejtuesin e DK.</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar në studimet e ciklit të dytë përbëhet nga tre anëtarë të stafit akademik efektiv të njësive përgjegjëse që ofron programin e studimit. Modalitetet e diplomimit për ciklin e dytë të studimeve "Master Profesional" janë të përcaktuara në Rregulloren e diplomimit, neni 3. Modalitetet e organizimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar janë të përcaktuara qartë dhe në Rregulloren e programit (neni 31). Anëtarët e komisionit të posaçëm të diplomimit propozohen nga njësia përgjegjëse që mbulon programin e studimit dhe përfshijnë të gjitha lëndët e programit dhe miratohen nga Dekani i FSHR. <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 33. Rregullore e diplomimit neni 107;</i> <i>-Takim me stafin akademik.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Në programin e studimit Master Profesional "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport", studentët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar dhe jo me punim diplome.

Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në programin e studimit Master Profesional "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport", studentët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar dhe jo me punim diplome.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Organizimi dhe modalitetet e vlerësimit të provimit përfundimtar të përgjithshëm janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e programit (neni 31-32). Provimi përfshin lëndë të ndryshme nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit dhe organizohet me shkrim ose me gojë. Provimi realizohet përmes një komisioni të veçantë, të përbërë nga staf akademik efektiv. Komisioni i provimit vlerëson studentin në përfundim të provimit me notë dhe rezultati i bëhet i ditur studentit sipas akteve rregullatore institucionale të përcaktuara. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 8. Rregullore FSHR;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>-Takim me stafin akademik.</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të programit të ciklit të dytë të studimit, studentët pajisen me diplomën e programit përkatës, shoqëruar me suplementin e diplomës (neni 90, Rregullorja e UST). Suplementi i diplomës të programit të studimit "Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" është hartuar në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Suplementi i diplomës përmban të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me natyrën, nivelin, përmbajtjen e rezultateve të studimit dhe fushën e punësimit. Suplementi është në gjuhën shqipe dhe angleze. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 15. Suplementi i diplomës.</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Kopje e dokumentacionit të studentit ruhet në bazë të legjislacionit në fuqi në sekretarinë mësimore. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 8. Rregullore FSHR;</i> <i>-Vizita në sekretarinë mësimore.</i>
Konkluzione	<i>Neni 107 i Rregullores së UST përcakton mënyrën e diplomimit për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë. Studentët e</i>

	programit Master Profesional "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar, duke plotësuar kriteret e përcaktuara në rregulloret përkatëse. Për t'u pajisur me diplomën, studenti duhet të kalojë provimin përfundimtar dhe të ketë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët dhe praktikat dhe vlerësohet me notë. Teza ndahet në mënyrë të barabartë mes lëndëve të provimit dhe hartohet nga një komision i posaçëm (3 anëtarë të stafit akademik efektiv), që propozohet nga njësia përgjegjëse që mbulon programin e studimit dhe miratohet nga Dekani i FSHR. Pas përfundimit të studimeve, studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës, të cilat përmbajnë informacionin përkatës për natyrën dhe përmbajtjen e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Studentët e programit të studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" kanë mundësinë të përdorin ambientet e UST për të zhvilluar orë laboratorike. Laboratorët kishin pajisje bashkëkohore dhe të përshtatshme me natyrën dhe fushën e veprimtarisë së programit, por është e nevojshme që të zgjerohen hapësirat e tyre. Ky fakt u pohua edhe nga vizita në institucion. Studentët e programit të studimit mund të zhvillojnë praktikën profesionale në klubet sportive në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit tashmë të instaluar me Federatën Shqiptare të Futbollit dhe me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Kjo është një pikë e fortë e UST me impakt edhe të programi i studimit. Ref. 7. 23.5. Të dhëna tabelore për infrastrukturën, laboratore; Ref. 7. 23.5.1. Të dhëna për infrastrukturën; Ref. 7. 23.6. Të dhëna tabelore për infrastrukturën mbështetëse për procesin mësimor;

	<i>Ref. 39. Tabelat përmbledhese institucionale;</i> <i>Ref. 24.1. Marrëveshje Bashkëpunimi me Federatën Kombëtare të Futbollit;</i> <i>Ref. 24.2. Marrëveshjet në klubet sportive për organizimin e praktikave profesionale;</i> <i>Ref. 24. Lista e marrëveshjeve kombëtare ndërkombëtare;</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	UST për zbatimin e programit të studimeve Master Profesional në "Fizioterapi" bashkëpunon me Federatën Shqiptare të Futbollit dhe me klube të ndryshme sportive. Në këto klube, studentët kanë mundësinë të realizojnë praktikën e tyre mësimore për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë, duke u përshtatur me kërkesat e programit dhe teknologjinë moderne, si dhe për të rritur kompetencat dhe njohuritë profesionale. Studentët mund të zhvillojnë praktikën profesionale edhe në institucione të tjera publike dhe private me të cilat UST ka marrëveshje. FSHR angazhon mbikëqyrës për praktikën profesionale nga stafi akademik me kontratë në FSHR, të cilët janë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe realizimin e tyre. Mbikëqyrësit e praktikave profesionale vlerësojnë dhe ndjekin studentët në bashkëpunim me fizioterapistët e punësuar me kohë të plotë në klube sportive me të cilat institucioni bashkëpunon. <i>Ref. 24.1. Marrëveshje Bashkëpunimi me Federatën Kombëtare të Futbollit;</i> <i>Ref. 24.2. Marrëveshjet në klubet sportive për organizimin e praktikave profesionale;</i> <i>Ref. 24. Lista e marrëveshjeve kombëtare ndërkombëtare;</i> <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 8. Rregullore FSHR;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Takim me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët.</i>
Kriteri 3. Praktikën profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në	Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" parashikon edhe zhvillimin e praktikës profesionale në semestrin e dytë, me 6 kredite (ECTS) dhe 120 orë. Programi i studimit përfshin edhe praktikën e lëndëve të programit që zhvillohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit

dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	të studimit (1 vit). Në total, orët praktike/laboratorike të lëndëve të planit mësimor janë 54. Në Rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë organizimi dhe vlerësimi i praktikave profesionale (neni 13) dhe format e mësimimit (neni 14). Frekuentimi i praktikave është i detyrueshëm në 75%. Zgjedhja e subjekteve për kryerjen e praktikës bëhet në përputhje me llojin e mundësive realizuese. Shlyerja e detyrimit të praktikës profesionale bëhet në afatin e përcaktuar nga DK dhe miratohet nga Dekani. FSHR angazhon mbikëqyrës për praktikat profesionale nga stafi akademik me kontratë në institucion, të cilët janë përgjegjës për mbikëqyrjen, realizimin dhe vlerësimin e praktikave në bashkëpunim me fizioterapistët e punësuar me kohë të plotë në klubet sportive ose klinika rehabilituese me të cilat institucioni bashkëpunon. <i>Ref. 7. Rregullore UST;</i> <i>Ref. 8. Rregullore FSHR;</i> <i>Ref. 6. Rregullore e MP;</i> <i>Ref. 14. Plani mësimor 2023-2024;</i> <i>-Takim me stafin akademik;</i> <i>-Takimi me studentët.</i>			
Konkluzione	<i>Studentët e programit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” mund të përdorin laboratorët e UST, të pajisur me teknologji moderne. Sidoqoftë, është e nevojshme zgjerimi i hapësirave. UST ka bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Futbollit dhe klube sportive, duke ofruar mundësi praktike për studentët. Ky bashkëpunim është një nga pikat më të forta të UST, duke pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e programit të studimit. Programi përfshin praktikë profesionale në semestrin e dytë, me 6 kredite dhe 120 orë praktike. Praktikrat janë të detyrueshme në masën 75%. Rregullorja e programit të studimit përcakton qartë mënyrën e organizimit dhe vlerësimit të praktikave profesionale (neni 13). FSHR angazhon mbikëqyrës për praktikat profesionale nga stafi akademik me kontratë, të cilët janë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe realizimin e tyre, në bashkëpunim me fizioterapistët e punësuar me kohë të plotë në subjektet ku kryhet praktika.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ bazuar në evidencat e vëna në dispozicion si dhe Takimi me Dekanin, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë konstaton se : Personeli akademik me kohë të plotë dhe më kohë të pjesëshme që angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit MP në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” plotëson të gjitha kërkesat që lidhen me detyrimet ligjore. I gjithë personeli përgjegjës për ofrimin e këtij programi studimi plotësojnë kriteret e përcaktuar në IAL sipas kategorive Profesor, Profesor i Asocuar dhe Doktor Shkencash, e në përputhje me aktet e brendshme të Universitetit të Sporteve të Tiranës. Në këtë program studimi angazhohen në total përkatësisht: 13 Personel akademik i brendshëm ku ndër to kemi (3 Prof.Dr, 6 Prof.Asc.Dr dhe 4 Dr), 1 Personel Akademik me Kontratë me titullin Prof.Asc.Dr, mbi 90% e stafit akademik janë pedagog me kohë të plotë në UST. <i>Ref.23. Të dhëna tabelore për personelin akademi në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.</i> <i>Ref.23.1, Të dhëna tabelore për Personelin akademik për vitet 2023-2024;</i> <i>Ref.21.1. Cv e stafit akademik të programit të studimit.</i> <i>Ref.11.1. Procedurë rekrutimi e stafit akademik/administrativ në UST-ë.</i> <i>-Vizita në institucion</i>

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Departamenti përmbush të gjitha detyrimet ligjore dhe nënligjore të organizimit dhe infrastrukturës akademike për realizimin me sukses të këtij programi përfshirë gradat, titujt dhe ngarkesat akademike. Nga evidencat GJV konstatoi se personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në masën pothuajse 99% dhe në masën 1% mbulohet nga personel akademik me kontratë. <i>Ref.21.1. Cv e stafit akademik të programit të studimit;</i> <i>Ref.23. Të dhëna tabelore për personelin akademi në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.</i> <i>Ref. 23.1, Të dhëna tabelore për Personelin akademik për vitet 2023-2024;</i> <i>Ref.14. Plani mësimor 2023-2024, MP në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport".</i> <i>Ref.20. Dosja e Program/Syllabus</i> <i>-Vizita në institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GJV konstaton se Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit ka një qëndrueshmëri të konsiderueshme, pasi shumica e stafit ka minimalisht mbi 5 vjet në UST-ë. Personeli akademik i FSHR-së dhe ai i angazhuar në programin e studimit, përbën një nga pikat më të forta të veprimtarisë akademike të këtij fakulteti. Shumica e personelit akademik kanë nisur karrierën e tyre në këtë fakultet dhe kanë avancuar në karrierën e tyre falë politikave mbështetëse të institucionit për promovimin e personelit akademik. Kjo mbështetje ka krijuar tek personeli një klimë pozitive e cila reflektohet në qëndrueshmërinë afatgjatë të personelit akademik. <i>Ref.4. Plani strategjik në FSHR 2021-2026, Misioni, pika 2.</i> <i>Ref.23. Të dhëna tabelore për personelin akademi në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.</i> <i>Ref. 23.1, Të dhëna tabelore për Personelin akademik për vitet 2023-2024;</i> <i>-Takimi me stafin akademik</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe	GJV në takimin me stafin akademik, zyrën e burimeve njerëzore , bazuar dhe në Rregullore të institucionit e cila përcakton që kriteret e punësimit të personelit akademik, u informua se kërkesat për rekrutim stafi propozohen nga departamenti përkatës dhe pas



specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	shqyrtimit nga Dekani, t'i përcillen Rektoratit për miratim. Vlerësimi i kandidatave bëhet në bazë të paketës së aplikimit (70%) dhe intervistës (30%). Kriteret e paketës së aplikimit dhe pyetjet e intervistës hartohen në përputhje me specifikat e vendit vakant të shpallur. GVJ verifikoi në mënyrë rastësore dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë, që rezultoi të ishin të plota në përputhje me procedurat dhe kërkesat përkatëse (CV, lista e notave , diplomave, gjuha e huaj e noterizuar, kontrata e punësimit, librezë e shëndetit, raporti mjekësor, titujt/gradat përkatëse, si dhe aktiviteti shkencor). Institucioni disponon rregullore të veçantë në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga UST-ë. Nga verifikimi u pa se dosjet e personelit ishin të plotësuar korrekt. Dosjet e pedagogëve ishin të azhurnuara me punimet e tyre të fundit. <i>Ref.13. Rregullore e brendshme e administrates, Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve.</i> <i>Ref.11.1. Procedurë rekrutimi e stafit akademik/administrativ në UST-ë.</i> <i>Ref.21. Formati i Dosjes Personale të Stafit Akademik.</i> <i>Ref.21.1. Cv e stafit akademik të programit të studimit;</i> <i>Ref.23. Të dhëna tabelore për personelin akademi në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse.</i> <i>Ref.23.1, Të dhëna tabelore për Personelin akademik për vitet 2023-2024;</i> <i>-Takimi me perfaqesuesit e Zyrës së Burimeve Njerëzore</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Nga evidencat rezulton se për këtë program studimi është i angazhuar një personel ndihmës akademik e cila mban gradën Msc. Gjatë vizitës në Institucion dhe në dokumentacion, u evidentua angazhimi i personelit ndihmës akademik, asistojnë dhe realizojnë orët laboratorike dhe gjithashtu realizojnë mirëmbajtjen e laboratoreve. <i>GVJ mendon se një personel ndihmës akademik është i pamjaftueshëm për menaxhimin e tre laboratoreve , duke patur parasysh kompetencat dhe angazhimin e duhur për realizimin e detyrave të tij.</i> Po kështu GVJ konstatoi se kabinetet që shërbenin për laboratorët dhe praktika të studentëve , ishin hapësira të vogla në m², pavarësisht se ishin të kompletuara me aparatura bashkëkohore. GVJ sygjeron:

	Rritjen e numrit të stafit ndihmës akademik. Rrrritjen e sipërfaqeve të kabineteve të vëna në dispozicion të studentëve. <i>Ref.18.1. Model Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit;</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit Përgjegjës për programin e studimit, Departamenti i Kineziologjisë.</i> <i>Ref.38. Përcjellje e raportit vjetor të 2023 në nivel Rektorati.</i> <i>-Takimi me Dekanin, përgjegjësit e departamenteve</i> <i>-Vizita në institucion.</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem GVJ konstatoi se UST/FSHR, disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit MP në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”. Pranë zyrës së Burimeve Njerëzore ku disponohen dosjet personale të stafit akademik e cila mban dhe marrëveshjen për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semester si dhe dosjen personale për staf jo akademik. Dosjet e pedagogëve ishin të azhuruara me punimet e tyre në revista apo konferenca dhe me trajnimet apo workshopet e realizuara nga stafi. Nga verifikimi i GVJ u pa se dosjet e personelit nuk kishin mangësi në plotësimin e tyre. Këto të dhëna shërbejnë më pas për analiza, raporte të ndryshme që kryhen institucioni në kuadër të vlerësimit të performancës dhe vetëvlerësimit për procese të ndryshme. Pavarësisht kësaj, GVJ sugjeron që nga sektori përkatës të shihet mundësia e unifikimit të formatit të CV të stafit akademik. <i>Ref.13. Rregullore e brendshme e administrates, Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve</i> <i>Ref.18.1. Model Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit;</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit Përgjegjës për programin e studimit, Departamenti i Kineziologjisë.</i> <i>Ref.21. Formatit i Dosjes Personale të Stafit Akademik.</i> <i>-Takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe stafin akademik</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim	UST realizon praktikat profesionale në klubet përkatëse të futbollit, volejbollit dhe basketbollit në bazë të akteve ligjore dhe

me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	janë përgjegjëse për mbështjen e realizimit të këtyre praktikave. FSHR angazhon personel mbikëqyrës së praktikave profesionale nga personel akademik me kontratë në FSHR, që janë përgjegjës për ndjekjen dhe realizimin e praktikës profesionale. FSHR ka angazhuar 2 PAK mbikëqyrës së praktikave profesionale, të cilët ndjekin dhe vlerësojnë studentët së bashku me fizioterapeftët që janë të punësuar me kohë të plotë në këto klube sportive. <i>Praktikat lëndore zhvillohen në laboratorët e institucionit të FSHR-ës dhe GVJ nga vizita në institucion evidentoi se këto laboratore plotësojnë më së miri kushtet me aparatura bashkëkohore për një zhvillim dhe realizim normal të praktikave lëndore, por hapësirat duhet të zgjerohen sic u shprehëm dhe më lartë.</i> <i>Ref.18.1. Model Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit;</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit Përgjegjës për programin e studimit, Departamenti i Kineziologjisë;</i> <i>Ref.35. Tabela Përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe praktikën profesionale, (tabela nr.5);</i> <i>Ref.24.1. Marrëveshje Bashkëpunimi me Federatën Shqiptare të Futbollit;</i> <i>Ref.24.2. Marrëveshje Bashkëpunimi me Klubet Sportive për organizimin e Praktikave Profesionale.</i> <i>-Takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Burimeve Njerëzore</i> <i>-Takimi me studentët, me stafin akademik, përgjegjësit e departamenteve dhe stafin mbikqyrës në praktika profesionale.</i> <i>- Vizita në institucion</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbylljen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Federatat së bashku me klubet përkatëse sportive, sipas akteve ligjore, ofrojnë ambjente të përshtatshme për realizimin e praktikave profesionale. Mes UST-së dhe këtyre institucioneve si: FSHF, FSHV dhe FSHB kanë marrëveshje bashkëpunimi për pritjen e studentëve për realizimin e praktikave profesionale. Në Rregulloren e programit të studimit, praktikat vlerësohen nga pedagogu i lëndës përkatëse së bashku me mbikëqyrës së praktikave profesionale. <i>Ref.24.1. Marrëveshje Bashkëpunimi me Federatën Shqiptare të Futbollit;</i>

	<i>Ref.24.2. Marrëveshje Bashkëpunimi me Klubet Sportive për organizimin e Praktikave Profesionale.</i> <i>Ref.6. Rregullore e Programit të studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport.</i> <i>Ref.21.1. Cv e stafit akademik të programit të studimit;</i> <i>-Takimi me studentët, me stafin akademik, përgjegjësit e departamenteve dhe stafin mbikqyrës në praktika profesionale.</i>			
Konkluzione	<i>Departamenti përgjigjës për programin e studimit MP në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" plotëson kriteret ligjore lidhur me Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit. Rekrutimii stafit akademik realizohet sipas legjislacionit në fuqi dhe urdhrave të brendshëm të UST-ës. Institucioni ka një data bazë për stafin akademik, administrativ dhe ndihmës mësimorë, Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Federata dhe Klube Sportive për realizimin e praktikës profesionale. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale studentët mbikqyren nga stafi akademik dhe përfaqësues i institucionit ku kryhet praktika. GVJ konstatoi se janë present marrëveshjet dypalëshe.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita në institucion u vërejt se mjediset mësimore janë të madhësive të ndryshme në përshtatje me natyrën e procesit mësimor që zhvillohet në to. GVJ gjatë guidës në institucion vuri re se ky Institucion ka hapësirat e nevojshme për zhvillimin e programit mësimor si: Sallat e leksioneve, të seminareve, laboratorët, biblioteka, etj. Hapësirat mësimore janë pajisur me infrastrukturën e nevojshme didaktike për zhvillimin e leksioneve, seminareve, laboratoreve dhe orëve praktike. Sallat e leksioneve janë pajisur me PC dhe projektor për prezantimin e leksioneve në Power Point.

	<i>Ref.18.1. Model Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit;</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit Përgjegjës për programin e studimit, Departamenti i Kineziologjisë.</i> <i>Ref.38. Përcjellje e raportit vjetor të 2023 në nivel Rektorati.</i> <i>Ref.23.5. Të dhëna tabelore për infrastrukturën, laboratorët.</i> <i>Ref.23.5.1. Të dhëna tabelore infrastruktura.</i> <i>Ref.23.6. Të dhëna tabelore për infrastrukturën në mbështetje të procesit mësimor.</i> <i>-Vizita në institucion</i> <i>-Takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Sekretarisë mësimore</i> <i>-Vizita në bibliotekë dhe në ambjentet e UST-së.</i> <i>-Takimi me studentët, me stafin akademik, përgjegjësit e departamenteve</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	UST/FSHR disponon ambjente të mjaftueshme për leksionet, seminarët, praktikat e laboratorët mësimore. Sallat mësimore janë të gjitha të pajisura me mjetet e nevojshme audiovizive dhe didaktike (PC, projektorë, internet, mikrofonë, tabela etj.). Sallat laboratorike janë të bollshme dhe të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillin normal të mësimit dhe që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. <i>Ref.23.5. Të dhëna tabelore për infrastrukturën, laboratorët.</i> <i>Ref.23.5.1. Të dhëna tabelore infrastruktura.</i> <i>Ref.23.6. Të dhëna tabelore për infrastrukturën në mbështetje të procesit mësimor.</i> <i>-Vizita në institucion</i> <i>-Takimi me studentët dhe me stafin akademik</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit janë në përdorim 3 laboratorë, laborator i rehabilitimit, laborator i fizioterapisë TIKA dhe laborator i vlerësimit postural DIERS. Nga vizita në institucion dhe evidencat GVJ konstaton se FSHR, në partneritet me projektin e AKKSH-it dhe me "The Turkish Development Cooperation Model" (TIKA) ka 2 laboratorë modernë për fizioterapi. Këta laboratorë përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit MP në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport".

	<i>Ref.18.1. Model Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit;</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit Përgjegjës për programin e studimit, Departamenti i Kineziologjisë.</i> <i>Ref.38. Përcjellje e raportit vjetor të 2023 në nivel Rektorati.</i> <i>Ref.23.5. Të dhëna tabelore për infrastrukturën, laboratorët.</i> <i>Ref.23.5.1. Të dhëna tabelore infrastruktura.</i> <i>Ref.23.6. Të dhëna tabelore për infrastrukturën në mbështetje të procesit mësimor.</i> <i>Ref.24. Lista e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Kombëtare.</i> <i>-Vizita në institucion</i> <i>-Takimi me studentët dhe me stafin akademik</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	UST/FSHR ka në përdorim për studentët sallën e informatikës me një kapacitet prej 36 kompjuterash. Nga vizita në institucion, takimi me studentët dhe me stafin akademik, GVJ konstatoi se FSHR ka laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. Në të gjitha ambjentet akademike e administrative ka mbulim me internet për përdorim nga stafi akademik, sekretaria mësimore dhe studentët. Nga projekti E-Physia një projekt i FSHR-ës me Erasmus+, FSHR-ës i është shtuar edhe një laborator informatike me 7 PC dhe 5 laptop. <i>Ref.23.5. Të dhëna tabelore për infrastrukturën, laboratorët.</i> <i>Ref.23.5.1. Të dhëna tabelore infrastruktura.</i> <i>Ref.23.6. Të dhëna tabelore për infrastrukturën në mbështetje të procesit mësimor.</i> <i>Ref.25.1. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, Projekti E-Physio.</i> <i>-Vizita në institucion</i> <i>-Takimi me studentët dhe me stafin akademik</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të	UST/FSHR disponon ambjente dhe kapacitetet e mjaftueshme për praktikantët e laboratorit mësimor. Vetë UST zotëron kapacitete salla, laboratore klinike për realizimin e këtyre praktikave. Gjithashtu UST/FSHR ka siguruar mjedise të mjaftueshme, të posaçme dhe të përshtatshme nëpërmjet marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve me Federatën dhe Klube Sportive. UST/FSHR ka marrëveshje bashkëpunimi për pritjen e studentëve për realizimin e praktikave profesionale me: Federatën Shqiptare të Futbollit,

mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Federatën Shqiptare të Volejbollit dhe Federatën Shqiptare të Volejbollit. <i>Ref.24.1. Marrëveshje Bashkëpunimi me Federatën Shqiptare të Futbollit;</i> <i>Ref.24.2. Marrëveshje Bashkëpunimi me Klubet Sportive për organizimin e Praktikave Profesionale.</i> <i>Ref.25. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</i> -Vizita në institucion -Takimi me studentët dhe me stafin akademik			
Konkluzione	Institucioni siguron Infrastrukturën e nevojshme si mjediset mësimore/auditore, laboratorët e zhvillimit të praktikave mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor. FSHR zotëron laboratorët mësimor në funksion të programit të studimit MP në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/të printuara për programet e studimit. Biblioteka është e pajisur me poste interneti, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Biblioteka e institucionit ishte e mirë organizuar kishte 12 laptop dhe tavolina kompjuteri, por hapësira e vënë në dispozicion ishte e vogël. Biblioteka ka në përdorim rreth 21 tekste periodike. Biblioteka ka një sipërfaqe 38 m ² , që sipas mendimit të GVJ është hapësirë e vogël. Biblioteka qëndronte e hapur në dispozicion të studentëve, stafit akademik çdo ditë nga ora 8.00- 16.00. GVJ sygjeron : Zgjerim të hapësirave për bibliotekën

	<i>Ref.19. Lista e teksteve periodike në Bibliotekë.</i> <i>Ref.19.1. Manual për përdorimin e bibliotekës online, Platforma U-Library.</i> <i>-Takimi me studentët dhe stafin akademik</i> <i>-Vizita në institucion, bibliotekë.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Stafi i FShR-ës pasuron bibliotekën me literaturë të fundit me libra për rehabilitimin dhe fizioterapinë, çdo fillim viti departamentet e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit bëjnë kërkesë me shkrim për librat e 5 viteve të fundit, kësaj kërkesë i bashkëngjitet një fond i veçantë. Literatura e të gjitha moduleve dhe burimet e paraqitur në syllabus aprovohet në fillim të vitit akademik nga njësia bazë. Një kopje e syllabusit i dërgohet Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave. Nga takimi me Zyrën e Kurrikulave u tha që çdo fillim viti kjo zyrë mirëpret përditësimet e Program/Syllabuseve që dorëzohen nga secila njësi bazë. <i>Ref.19. Lista e teksteve periodike në Bibliotekë.</i> <i>Ref.20. Dosja e Program/Syllabuseve.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyrën e Kurrikulave</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka është në dispozicion të stafit dhe studentëve në mënyrë të barabartë në të gjitha programet dhe ciklet e studimit. Biblioteka ka një rregullore të brendëshme që respektohet me seriozitet për sa i përket mënyrës së tërheqjes, shfrytëzimit dhe trajtimit të librave. Nuk ka asnjë kufizim të shfrytëzimit të librave në bibliotekë që lidhet me programin apo fushën e studimit. Studentët mund të shfrytëzojnë gjithë fondin e bibliotekës, pavarësisht nga fusha që studiojnë. Nga vizita në institucion biblioteka është funksionale dhe ka të depozituara disertacionet, botimet shkencore dhe tekstet mësimore të personelit akademik të institucionit. <i>Ref.19. Lista e teksteve periodike në Bibliotekë.</i> <i>Ref.19.1. Manual për përdorimin e bibliotekës online, Platforma U-Library.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët</i> <i>-Vizita në bibliotekën e UST-ës;</i> <i>-Takimi me përgjegjësen e bibliotekës së UST-ës.</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë,	Në bibliotekën e institucionit ka literaturë të mjaftueshme që pasurohet në mënyrë periodike me botime (revista shkencore, libra, etj). Titujt në bibliotekë janë klasifikuar sipas profileve dhe

literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	disiplinave dhe informatizimi i saj është i pasuruar me informacion të gjerë mbi materialin në brendësi të librit. Nga takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët dhe vizita në bibliotekën e UST-ës GJV konstatoi se studentët dhe stafi përdorin si librat hard-copy në bibliotekë si dhe bibliotekën online. (https://ulibrary.rash.al/). <i>Ref.19. Lista e teksteve periodike në Bibliotekë.</i> <i>Ref.19.1. Manual për përdorimin e bibliotekës online, Platforma U-Library.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët</i> <i>-Vizita në bibliotekën e UST-ës.</i>												
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Nga takimi me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik dhe studentët, GJV konstatoi se FSHR ka për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online si biblioteka “U-library, Koha. Nga vizita në bibliotekën e FSHR-ës u vërejt prania e studentëve në sallën e bibliotekës duke shfrytëzuar kryesisht bibliotekën online. <table><tr><th>Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj</th><th>Emertimi</th><th>Kohëzgjatja e kontratës aktuale</th></tr><tr><td>Platformat on-line</td><td>Pitagora</td><td>RASH (pa limit)</td></tr><tr><td>Biblioteka online</td><td>KOHA</td><td>Open source (pa limit)</td></tr><tr><td>Struktura e teknologjisë së informacionit qe menaxhon IAL</td><td>*Serveri i KOHA *Sëitch & Router per menaxhimin e rrjetit te brendshem dhe internetit (wireless dhe me kabëll)</td><td></td></tr></table>	Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj	Emertimi	Kohëzgjatja e kontratës aktuale	Platformat on-line	Pitagora	RASH (pa limit)	Biblioteka online	KOHA	Open source (pa limit)	Struktura e teknologjisë së informacionit qe menaxhon IAL	*Serveri i KOHA *Sëitch & Router per menaxhimin e rrjetit te brendshem dhe internetit (wireless dhe me kabëll)	
Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj	Emertimi	Kohëzgjatja e kontratës aktuale											
Platformat on-line	Pitagora	RASH (pa limit)											
Biblioteka online	KOHA	Open source (pa limit)											
Struktura e teknologjisë së informacionit qe menaxhon IAL	*Serveri i KOHA *Sëitch & Router per menaxhimin e rrjetit te brendshem dhe internetit (wireless dhe me kabëll)												



	<i>Ref.19. Lista e teksteve periodike në Bibliotekë.</i> <i>Ref.19.1. Manual për përdorimin e bibliotekës online, Platforma U-Library.</i> <i>Ref.39. Tabelat përmbledhëse të institucionit.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët</i> <i>-Vizita në bibliotekën e UST-ës</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga takimi me stafin akademik, studentët dhe vizita në bibliotekën e FSHR-ës, GVJ konstatoi se biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Gjithashtu, kjo bibliotekë ofron mundësi shfrytëzimi të sallës së leximit dhe kompjuterave. <i>Ref.19. Lista e teksteve periodike në Bibliotekë.</i> <i>Ref.19.1. Manual për përdorimin e bibliotekës online, Platforma U-Library.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët</i> <i>-Vizita në bibliotekën e UST-ës</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e FSHR-ës është e konceptuar të ketë një sallë studimi me pajisje kompjuterike (kompjuter, videoprojektor) që krijon mundësinë për të punuar në mënyrë individuale apo edhe në grup. Orari i shfrytëzimit të bibliotekës është i përshtatshëm për studentët në përputhje me orarin e tyre të mësimi (8.00 – 16.00). Nga takimi me stafin akademik, studentët dhe vizita në bibliotekën e FSHR-ës GVJ konstatoi se ambienti i bibliotekës, sallës së leximit përdoret nga studentët jo vetëm për lexim por edhe për organizimin e takimeve studentore. <i>Ref.19. Lista e teksteve periodike në Bibliotekë.</i> <i>Ref.19.1. Manual për përdorimin e bibliotekës online, Platforma U-Library.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët</i> <i>-Vizita në bibliotekën e UST-ës</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe	Stafi akademik orioenton studentët për shfrytëzimin e librave duke u kërkuar atyre me rigorozitet përgatitjen e detyrave të kursit dhe duke evidentuar literaturën e shfrytëzuar, duke u nisur nga kërkesat e stafit akademik dhe studentëve, mbi bazën e propozimeve të departamenteve të FSHR- bëhet kërkesa për

fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	pasurimin e titujve të rinj. Kjo kërkesë i drejtohet administratorit të universitetit. Nga dokumentat e dorëzuara, kërkesa e fundit për pasurimin e bibliotekës ishte viti 2022. Drejtuesit e Njësisë Kryesore/Bazë e justifikuan këtë për shkak të librave on-line. Në takimin me studentët, ata raportuan se e frekuentojnë bibliotekën. <i>Ref.16. Mbi miratimin e propozimit për detajimin e të ardhurave, Vendim Senati Nr. 1 date 05.01.2024 Për miratimin e propozimit të detajimit të grantit të mesimdhënies për vitin 2024 të UST.</i> <i>Ref.16. l. Vendim Qarkullues Nr.01 date 05.01.2024 "Miratimin e detajimit të grantit të mesimdhënies për Vitin Akademik 2024 në UST".</i> <i>Ref.28. Pasqyrat Financiare Vjetore 2023, të dhenat Tabelore.</i> <i>Ref. 28.1. Relacion mbi pasqyren Financiare Vjetore të UST-ës.</i>			
Konkluzione	<i>UST/FSHR ka një Bibliotekë Universitare që kanë hapësira të dedikuara dhe të bollshme për studentët. Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. UST/FSHR ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë, si të bibliotekës fizike ashtu dhe asaj on-line. Literatura në bibliotekë është e pasur dhe e azhornuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim. Që nga momenti i regjistrimit online në U-Albania të studentëve dhe pajisjen e tyre me numrin unik nga RASH, të dhënat pasqyrohen në sistemin e Pitagorës të UST-ës nga sekretaria mësimore ku edhe pasqyrohet aktiviteti i studentit gjatë gjithë kohës së studimit. <i>Ref.30. Manuali i Studentit.</i> <i>Ref.30.1. Udhëzues për përdorimin e sistemit Pitagora.</i>

	<i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët.</i> <i>-Vizita në sekretarinë mësimore</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	UST ka vite që ka kaluar në sistemin e ri Pitagora të sekretarisë mësimore ku përveç shërbimeve të sekretarisë mësimore mundësohet edhe administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Në sistemin e brendshëm gjithashtu hidhen të dhënat e të gjithë stafit të angazhuar në varësi të njësisë kryesore, bazë dhe statusit të punësimit (Burimet njerëzore). <i>Ref.30. Manuali i Studentit.</i> <i>Ref.30.1. Udhezues per perdorimin e sistemit Pitagora.</i> <i>-Vizita në sekretarinë mësimore</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, studentët.</i> <i>-Vizita në bibliotekën e UST-ës.</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Studentët e UST-ës informohen për gjithçka nëpërmjet platformës elektronike Pitagora, që është një sistem i brendshëm menaxhimi të dhënash ku studentët logohen individualisht me të dhënat e tyre personale dhe mund të marrin çdo informacion që lidhet me performancën e tyre akademike dhe jo vetëm. Gjithashtu në këtë platformë studentët regjistrohen online për provime në sesionet e provimeve (vjeshtë, mbartje etj.) Çdo student dhe anëtar i stafit akademik apo administrativ, përmes adresës elektronike që disponon, ka akses në këtë sistem. Për stafin akademik dhe administrativ përdoret email (emër.mbiemër.ust.edu.al), për studentët (emër.mbiemër@student.ust.edu.al). Funksionalitetet kryesore të përfshira në platformën e re Pitagora, janë: Zona Didaktike (struktura akademike, menaxhimi i karrierës së studentit, provime dhe tema e diplomës), Zona Administrative (pranimi dhe regjistrimi, orari dhe provimet, menaxhimi i studentëve), Tarifatat (menaxhimi i tarifave të studimit, bursa për studentët, periudha financiare), Diplomimi (provimet e Shtetit, praktika studentore, diploma online dhe suplementi). <i>Ref.30. Manuali i Studentit.</i> <i>Ref.30.1. Udhezues per perdorimin e sistemit Pitagora.</i>

	-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, studentët. -Vizita në bibliotekën e UST-ës -Takimi me Zyrën e sekretarsë mësimore.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Ky sistem nëpërmjet një portali të posaçëm, studentët informohen jo vetëm me njoftimet për procesin mësimor por edhe për veprimtari të tjera apo informacione të nevojshme që lidhen me kërkimin shkencor, aktivitetet studentore, mobilitetet etj. <i>Ref.30. Manuali i Studentit.</i> <i>Ref.30.1. Udhezues për përdorimin e sistemit Pitagora.</i> -Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët. -Vizita në Sekretarinë mësimore e UST-ës
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ konstatoi se institucioni në përgjithësi punonte me sistemin e Pitagorës. Pitagora është një program i sekretarisë mësimore ku mund të hyj sekretaria, përgjegjësit e programeve, stafi akademik dhe studentët. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Nëpërmjet faqes zyrtare, pasqyrohet veprimtaria administrative, institucionale, zgjedhjet, programin e transparencës, akademike, kulturore e sociale Për komunikim të brendshëm, përveç sistemeve të sipërcituara, stafi përdor e-maillet zyrtare të institucionit, google classroom, googlesite, googlemeet pa limit për personelin akademik dhe studentët e institucionit. Falë Zyrës së IT bëhej e mundur mirëmbajtja e sistemit duke bërë të mundur përdorimin në çdo kohë. <i>Ref.30. Manuali i Studentit.</i> <i>Ref.30.1. Udhezues për përdorimin e sistemit Pitagora.</i> <i>Ref.31. Rregullore e Departamentit të Shkencave Biomjeksore dhe Humane, Vendim Nr. Prot. 3642/1, date 22.07.2020 mbi Departamentet përgjegjëse për programet e studimit të FSHR.</i>

	<i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit te Kineziologjise.</i> <i>-Vizita në Sekretarinë mësimore e UST-ës;</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët;</i> <i>-Takimi me përfaqësuesit Zyrës së burimeve njerëzore</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të UST-ës që është aktive në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, e cila përditësohet periodikisht me aktivitetin e fakultetit dhe departamenteve. Studentët dhe të gjithë të interesuarit mund të hyjnë lehtësisht dhe të marrin informacione për programet dhe për aktivitetin akademik të Universitetit. UST zotëron një faqe Web aktive në dy gjuhë; shqip dhe anglisht, që mund të aksesohet nga çdo njeri. Kjo faqe është dinamike dhe jep informacione të ndryshme. <i>Ref.30. Manuali i Studentit.</i> <i>Ref.31. Rregullore e Departamentit te Shkencave Biomjeksore dhe Humane, Vendim Nr. Prot. 3642/1, date 22.07.2020 mbi Departamentet pergjegjese per programet e studimit te FSHR, Eëbi aktiv ne dy gjuhe.</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit te Kineziologjise.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët.</i> <i>-Vizita në Sekretarinë mësimore e UST-ës.</i>			
Konkluzione	<i>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për studentët dhe pedagogët. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidencialë merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik në mënyrë konfidenciale. Sistemi ka të përfshirë edhe komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacioneve. Faqja zyrtare e UST/FSHR është aktive në dy gjuhë; shqip dhe anglisht. Studentët dhe të gjithë të interesuarit mund të hyjnë lehtësisht dhe të marrin informacione për programet dhe për aktivitetin akademik të Universitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në UST/FSHR, përgatitja e buxhetit, mënyra e shpërndarjes së fondeve dhe përdorimit të tyre, është kompetencë e institucionit dhe menaxhohet nga Bordi i Administrimit. Në hartimin e buxhetit merren parasysh të ardhurat e gjeneruara nga institucioni nga studentët, shërbimet, projektet etj. Politikat e shpërndarjes së burimeve financiare dhe përdorimi i tyre kryhet në përputhje me nevojat që kanë njësitë përbërëse të institucionit. Plani i financimit ka përshkruar të gjitha kostot e programit të studimit që përfshijnë burimet njerëzore dhe infrastrukturore, materialet e konsumit, pajisjet, zhvillimin e praktikave spitalore, pasurimit të bibliotekës, kostot e auditeve të brendshëm dhe të jashtëm. Nga shqyrtimi i evidencave GVJ konstaton praninë e raportit financiar të kostove të njësisë bazë për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi për një cikël të plotë studimi. <i>Ref.28. Pasqyrat Financiare Vjetore 2023, te dhenat Tabelore.</i> <i>Ref. 28.1. Relacion mbi pasqyren Financiare Vjetore te UST-ës.</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit të Kineziologjisë</i> <i>Ref.18.1. Model Analize vjetore te Fakuktetit te Shkencave te Rehabilitimit.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC.</i>



Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Proçesi i hartimit të planit financiar nis me diskutimet dhe marrjen e propozimeve nga njësia bazë dhe strukturat administrative të fakultetit. Pas shqyrtimit dhe miratimit të propozimeve, fakulteti përcjell planin në nivel fakulteti në Rektorat. Në këto të dhëna financiare të UST-ës për alokim buxheti janë parashikuar financimi i burimeve njerëzore, pagat, shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e saj, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja, bursat e studentave, kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet. <i>Ref.16. Mbi miratimin e propozimit per detajimin e te ardhurave, Vendim Senati Nr. 1 date 05.01.2024 Për miratimin e propozimit e detajimit te grantit te mesimdhënies per vitin 2024 te UST.</i> <i>Ref.16. l. Vendim Qarkullues Nr.01 date 05.01.2024 "Miratimin e detajimit te grantit te mesimdhënies per Vitin Akademik 2024 ne UST".</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit te Kineziologjise</i> <i>Ref.18.1. Model Analize vjetore te Fakultetit te Shkencave te Rehabilitimit.</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Në përfundim të vitit kalenderik hartohen pasqyrat financiare të cilat tregojnë gjendjen e biznesit dhe masën e realizimit të Projekt-Buxhetit të përcaktuar. Institucioni kryen analiza periodike dhe harton raporte vjetore. Raportin e auditimit, në të cilin paraqiten rezultatet paraprake të auditimit të kryer në institucion dhe i vihet në dispozicion titullarit të tij. Bordi i administrimit dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. Të gjitha të dhënat, analizohen nga organet drejtuese të UST-ës, Bordi i Administrimit dhe Senati akademik, evidentohen problematikat në politikat e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në favor të procesit akademik. <i>Ref.16. Mbi miratimin e propozimit per detajimin e të</i>



	<i>ardhurave, Vendim Senati Nr. 1 date 05.01.2024 Per miratimin e propozimit e detajimit te grantit te mesimdhenies per vitin 2024 te UST.</i> <i>Ref.16. l. Vendim Qarkullues Nr.01 date 05.01.2024 "Miratimin e detajimit te grandit te mesimdhenies per Vitin Akademik 2024 ne UST".</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, në nivel Rektorati.</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit të Kineziologjise</i> <i>Ref.18.1. Model Analize vjetore te Fakuktetit te Shkencave te Rehabilitimit.</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ nga shqyrtimi i evidencave, takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe NJSBC, konstaton se monitorimi i ecures së veprimtarive akademike të UST/FSHR, kontrolli, auditimi dhe raportimi është i vazhdueshëm nëpërmjet raportit vjetor i cili hartohet në zbatim të nenit 32 të IAL 80/2015. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. <i>Ref.10. Ligji i Arsimit te Larte Nr80/2015, Neni 3, pika lb dhe neni 32.</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit te Kineziologjise</i> <i>Ref.18.1. Model Analize vjetore te Fakuktetit te Shkencave te Rehabilitimit.</i> <i>Ref.32.8. Model Raporti i Analizes Vjetore te NJSBC 2023-2024. -Takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC.</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni	UST/FSHR garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit dhe të ardhurat nga shërbimet që kryhen. Nga takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC dhe shqyrtimi i evidencave, GVJ konstaton se FSHR dëshmon qëndrueshmëri financiare, mirëmenaxhon të ardhurat dhe kontributet financiare me efikasitet dhe transparencë në zhvillimin e infrastrukturës e logjistikës në funksion të mësimdhënies, praktikave profesionale dhe kërkimit shkencor. (Tabela nr.18, Financimi i FSHR-ës).

planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati. Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit te Kineziologjise Ref.18.1. Model Analize vjetore te Fakultetit te Shkencave te Rehabilitimit. Ref.32.8. Model Raporti i Analizes Vjetore te NJSBC 2023-2024.			
Konkluzione	Çdo vit akademik UST/FSHR harton raportin financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Fondet burojnë nga ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit dhe të ardhurat nga shërbimet që kryhen. Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ konstatoi se institucioni (senati dhe bordi administrimit) harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Në bazë të Rregullores së departamentit, Koordinator i programit të studimit është përgjegjës për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit dhe praktikave profesionale. Paralelisht, ai informon drejtuesin e departamentit për problematikat e ndryshme.

	Fakulteti cakton çdo vit një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori propozohet nga drejtuesi i departamentit dhe miratohet nga Dekani. <i>Ref. 5. VKM Nr.41, date 24.01.2018, "Per elementet e programeve te studimit te ofruara nga IAL.</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit te Studimit MP ne Rehabilitim Fizioterapeutik ne Sport,</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit te Sporteve,</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës,</i> <i>Ref.23.5. Te dhena Tabelore per infrastrukturen; Labororet.</i> <i>Ref.23.5.1. Te dhena per infrastrukturen.</i> <i>Ref.23.6. Te dhena Tabelore per infrastrukture mbeshetese per procesin mesimor.</i> <i>Ref. 17. Percjellje e kriterëve te pranimit ne ciklin e dyte te studimeve Master Profesional.</i> <i>Ref.31. Rregullore e Departamentit te Shkencave Biomjekesore dhe Humane, Vendim Nr. Prot. 3642/1, date 22.07.2020 mbi Departamentet pergjegjese per programet e studimit te FSHR.</i> <i>Ref.31.1.Rregullore e Departamentit te Kineziologjise.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, Zyrën e Burimeve Njerëzore, NJSBC.</i> <i>-Vizita në ambientet e FSHR-ës.</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	FSHR ndjek politika dhe procedura si dhe ofron mundësi të barabarta për të gjithë studentët e programit të studimit. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente duke respektuar meritokracinë. Gjatë vizitës në institucion, në sekretarinë mësimore, GVJ vuri re se FSHR bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Shqiptar, nr. 80/2015, statutin e UST-ës siguron barazinë bazuar mbi kriteret dhe procedurat për të gjithë kandidatët për tu regjistruar në Programin e Studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport". Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesëmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme. <i>Ref.3. Statuti i Universitetit te Sporteve,</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit te Sporteve,</i> <i>Ref. 17. Percjellje e kriterëve te pranimit ne ciklin e dyte te studimeve Master Profesional,</i>

	<i>Ref.27. http://ust.edu.al/programi-i-transparences/ Programi i Transparences per Universitetin e Sporteve te Tiranes.</i> <i>Ref.27.1. http://ust.edu.al/politikat-e-privatesise/ Politikat e Privatesise</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët.</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	GVJ në takimin me stafin akademik dhe studentet, si dhe dokumentat e vëna në dispozicion, u informua dhe konstatoi se para çdo viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR organizohen "ditët e informimit të maturantëve". Modalitetet e pranimit në të gjitha programet e studimit përcaktohen me vendim senati në mbështetje të kriterëve kombëtarë të përcaktuara në LAL dhe propozimeve të njësisë bazë për kriteret të veçanta. Kriteret shpallen dhe u bëhen të ditur të gjithë aplikantëve gjatë periudhës së informimit dhe gjithashtu publikohen në Ualbania. <i>Ref.3. Statuti i Universitetit te Sporteve,</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit te Sporteve,</i> <i>Ref. 17. Percjellje e kriterëve te pranimit ne ciklin e dyte te studimeve Master Profesional,</i> <i>Ref.27. http://ust.edu.al/programi-i-transparences/ Programi i Transparences per Universitetin e Sporteve te Tiranes.</i> <i>Ref.27.1. http://ust.edu.al/politikat-e-privatesise/ Politikat e Privatesise</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët.</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Institucioni gjithashtu planifikon kuota për transferim të studimeve nga insitucione të tjera dhe programe të dyta studimi. Kushtet dhe procedura e transferimit të krediteve gjithashtu janë të kuptueshme dhe u bëhen të ditur aplikantëve nga stafi dhe sekretaria mësimore. Në rregulloren e programit të studimit neni 25 specifikon kriteret e pranimit. Neni 78 i Rregullores së Njësisë Kryesore përcakton shkëputjen dhe ndërprerjen e studimeve. FSHR çdo vit akademik përcakton kriteret e pranimit si mesatarja dhe programet nga mund të transferohen me njohje të plotë ose të pjesshme të krediteve si studentë që duan si diplomë të dytë, studentë që kanë mbaruar bachelor për fizioterapi në IAL publike dhe IAL jo publike , apo që kanë mbaruar studime në fakultet të mjekësisë, edukim në sporte etj.



	GVJ konstatoi se pranimi i transferimit të studentëve në programin e studimit bëhet në përputhje me procedurat e transferimit të studentëve të UST-ës dhe Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Shqipërisë. <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve,</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-se</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport,</i> <i>Ref.31. Rregullore e Departamentit të Shkencave Biomjekësore dhe Humane, Vendim Nr. Prot. 3642/1, date 22.07.2020 mbi Departamentet përgjegjëse për programet e studimit të FSHR.</i> <i>Ref. 17. Përcjellje e kriterëve të pranimit në ciklin e dytë të studimeve Master Profesional.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ u informua se para fillimit të vitit akademik Institucioni organizon fushatën e informimit për të gjitha programet e studimit. Institucioni prej vitesh merr pjesë në Panairët Work & Study të organizuar në rrethe dhe në Tiranë në afatet e përcaktuara nga MAS sipas një kalendari të shpallur paraprakisht, me përfaqësues nga zyra e Informimit dhe Njësitë akademike. Informacion të bollshëm ka dhe në katalogun e universitetit, faqe zyrtare të UST-ës, rrjete të komunikimit social si profili në Facebook, llogaria në Instagram, numra telefoni në dispozicion, si dhe vë në dispozicion të studentëve materiale informuese si broshura, fletëpalosje duke informuar studentët kandidatë rreth programeve që ofron. <i>Ref.29. Kalendari i aktiviteteve FSHR për vitet 2023-2024.</i> <i>Ref.37. Relacion i aktivitetit të zyrës së keshillimit dhe karrierës.</i> <i>Ref.34. Të dhëna tabelore për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve.</i> <i>35. Tabele përmbledhese me institucionet bashkepunuese, për programin e studimit dhe për praktiken profesionale. (tab 5)</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e	UST/FSHR harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi ndryshe, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. UST/FSHR ndjek një politikë të barabartë pranimi për të gjithë kandidatët qofshin këta me aftësi të

kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	veçanta apo përkatësi të ndryshme (studentë romë ballkano egjiptian, studentët me statusin e jetimit, fëmijë të policëve të rënë në detyrë). GVJ konstatoi se infrastruktura e FSHR-ës, e vënë në dispozicion, është përshtatshme për t'u aksesuar si me këmbë ashtu edhe me mjete ndihmëse si rampa, ashensorë etj, për studentët me aftësi ndryshe. Në këtë mënyrë sigurohet barazia për të gjithë kandidatët me aftësi të veçanta. <i>Ref.31. Rregullore e Departamentit të Shkencave Biomjeksore dhe Humane, Vendim Nr. Prot. 3642/1, date 22.07.2020 mbi Departamentet përgjegjëse për programet e studimit të FSHR.</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjise.</i> <i>Ref. 17. Percjellje e kriterëve të pranimit në ciklin e dytë të studimeve Master Profesional.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ bazuar në rregullore të institucionit si dhe statutin e UST, Neni 90 i Statutit të Institucionit raporton se në programet e studimit pranohen student vendas dhe të huaj ndërsa detajet për pranimin e tyre përfshihen në rregulloren e programit të studimit. Neni 78 i rregullores së Institucionit të UST-ës përcakton mundësinë e transferimit të studimeve ndërsa në Rregulloren e Njësisë Kryesore, në nenet 74 dhe 75 raportohet mbi transferimet e mundshme si dhe njohjeve të krediteve. <i>Ref.31. Rregullore e Departamentit të Shkencave Biomjeksore dhe Humane, Vendim Nr. Prot. 3642/1, date 22.07.2020 mbi Departamentet përgjegjëse për programet e studimit të FSHR.</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjise.</i> <i>Ref.3. Statuti i Universitetit të Sporteve neni 90.</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Neni 74, 75;</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në takimin me stafin akademik, drejtues të institucionit, studentët, GVJ konstaton se UST/FSHR ndjek politikë mbështetëse për studentët me aftësi të ndryshe, studentët me një prind, fëmijë të policëve të rënë në detyrë, studentë romë dhe ballkano-egjiptian duke i ndihmuar si nga ana ekonomike ashtu dhe për integrimin sa më të mirë të tyre në rastet kur ata e dëshmojnë këtë përkatësi. Për studentët me nevoja dhe statuse të veçanta institucioni ofron lehtësira financiare (bursa studimi), të cilat parashikohen në



	kontratat individuale të cilat rimbursohen nga buxheti i shtetit për llogari të UST-ës, pas depozitimit të kërkesës në departamentin përkatës. <i>Ref.31. Rregullore e Departamentit të Shkencave Biomjekesore dhe Humane, Vendim Nr. Prot. 3642/1, date 22.07.2020 mbi Departamentet përgjegjëse për programet e studimit të FSHR.</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjise.</i> <i>Ref.3. Statuti i Universitetit të Sporteve neni 90.</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Neni 74, 75;</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.</i>			
Konkluzione	UST/FSHR ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit bazuar në aktet ligjore. UST, ndjek politikë mbështetëse për studentët romë dhe ballkano-egjiptian duke i ndihmuar si nga ana ekonomike dhe studentët me nevoja dhe statuse të veçanta institucioni ofron lehtësira financiare të cilat parashikohen në kontratat individuale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ, referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit të studimit, regjistrave themeltar të sekretarisë dhe takimit me përfaqësues të tij, konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore. Gjithashtu u konstatua se studentët informoheshin nga zyra e karrierës, përgjegjësi i programit të studimit dhe tutori i vitit përkatës në lidhje me rregulloret e shkollës, rregulloren e programit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit, pikëzimet, etj.

	Informacioni zyrtar në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin përfshihen në sistemin e menaxhimit të universitetit. <i>Ref.31. Rregullore e Departamentit të Shkencave Biomjeksore dhe Humane, Vendim Nr. Prot. 3642/1, date 22.07.2020 mbi Departamentet përgjegjëse për programet e studimit të FSHR.</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjise.</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve,</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-se</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport.</i> <i>Ref.37. Relacion i aktivitetit të zyres së keshillimit dhe karrieres</i> <i>Ref.38. Përcjellje raporti vjetor për vitin 2023, në nivel Rektorati.</i> <i>Ref.32.3. Model Raporti I FSHR-se i NJSBC</i> <i>Ref. 32.6. Plan Veprimi i Kalendarik i NJSBC.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ konstaton se FSHR përmes Zyrës së Sekretarisë Mësimore ofron informacion dhe udhëzime të hollësishme për studentët mbi procedurat, në bazë të kushteve të njohjes dhe transferimit të krediteve. Në rregulloren e programit të studimit neni 25 përcakton kriteret e regjistrimit. Procedura e transferimi nuk është e detajuar/specifikuar. Neni 74 dhe 75 i Rregullores së Njesisë Kryesore përcakton shkëputjen dhe ndërprerjen e studimeve. Kriteret e pranimit dhe kuotat për program studimi miratohen nga Senati Akademik. <i>Ref.31. Rregullore e Departamentit të Shkencave Biomjeksore dhe Humane, Vendim Nr. Prot. 3642/1, date 22.07.2020 mbi Departamentet përgjegjëse për programet e studimit të FSHR.</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjise.</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve,</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-se</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport.</i> <i>Ref.37. Relacion i aktivitetit të zyres së keshillimit dhe karrieres.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.</i>

Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstatoi nga vizita me studentët se studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara dhe prezantimit të pedagogut përkatës në orën e parë të mësimit, si dhe nga sekretaria mësimore e departamentit. Vlerësimi zhvillohet në bazë të nenit 103 të Rregullores së institucionit (Sistemi i Vlerësimit), 101 nenit të Rregullores së Njesisë Kryesore dhe nenit 22 të Rregullores së Programit të studimit. Në këto nene raportohen kriteret dhe mënyrat e tesimit dhe vlerësimit të dijeve. Syllabuset përcaktojnë mënyrën e vlerësimit për secilën lëndë/modul. Procedura e vlerësimit siç parashikohet në kuadrin ligjor, u raportua dhe nga stafi akademik e studentët. <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjise.</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve,</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-se</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport.</i> <i>Ref. 20. Dosja e Program/Syllabus</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ në takimin me shefin e departamentit u informua se përgjegjësi i programit informon studentët për procedurat e diplomimit në fillim të shkollës në mënyrë që ata të përgatiten. Në dokumentat rregullatorë përshkruhen dy mënyra për mbrojtjen e diplomës. Në këtë program studimi është parashikuar mbrojtje e diplomës me provimin përfundimtar me shkrim, studentëve paraprkasht ju vihet në dispozicion matërialet, temat që duhet të përgatiten për provimin e diplomës. Në rregulloren e FSHR shpjegohet i gjithë procesi i diplomimit të studentit. <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjise.</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve,</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-se</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport.</i> <i>Ref.33. Rregullore e Diplomimit, Neni 107.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e kurrikulës.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në	Nga takimi me studentët dhe stafi akademik, GVJ konstatoi se studentët dhe gjithë të interesuarit kanë mundësi të marrin

mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	informacion për programin e studimit nëpërmjet faqes zyrtare, katalogut të shkollës, fletëve informuese, sekretarisë, stafit akademik dhe përgjegjësit të programit në çdo ditë të vitit dhe veçanërisht në muajin shtator gjatë periudhës së informimit. Në mënyrë periodike duke marrë pjesë në Panairin Work & Study të organizuara nga MAS dhe duke organizuar ditët e hapura për maturantët. <i>Ref.31. Rregullore e Departamentit të Shkencave Biomjeksore dhe Humane, Vendim Nr. Prot. 3642/1, date 22.07.2020 mbi Departamentet përgjegjëse për programet e studimit të FSHR.</i> <i>Ref.31.1. Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë.</i> <i>Ref.37. Relacion i aktivitetit të zyrës së keshillimit dhe karrierës;</i> <i>Ref.29. Kalendari i aktiviteteve FSHR për vitet 2023-2024.</i> <i>Ref.30. Manuali i Studentit.</i> <i>Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore. zyrën e kurrikulës, NJSBC-së.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurën vlerësimit të dijeve, kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UST/UST Informon publikun për programet e studimit që ofron duke organizuar takime të hapura me të interesuarit dhe studentët e ardhshëm mbi programin e studimit, fletë palosjeve informuese, informacionit në faqen e Eëbit të universitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------



Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Përgjegjësi i programit u jep studentëve gjithë informacionin e detajuar për organizimin e procesit mësimor, kalendarin akademik ku përfshihen datat e fillimit dhe mbarimit të procesit mësimor, periudhat e teorisë dhe praktikës, sesionet e provimeve dhe mbrojtja e diplomës. Nga takimi me studentët, stafin akademik, sekretarinë mësimore dhe evidencat GVJ konstatoi se studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit në mënyra të ndryshme siç janë e-maillet, takimet në Zyrën e Karrieres, stafin akademik, si dhe vënies në dispozicion të studentëve të rregullores së brendshme dhe rregullores së programit të studimit, ose përmes faqes zyrtare http://umed.edu.al, si dhe mund të aksesojnë në formatin hardcopy dosjen e programit të studimit pranë zyrave të shërbimit të studentëve pranë UST-ës. <i>Ref.31. Rregullore e Departamentit të Shkencave Biomjekesore dhe Humane, Vendim Nr. Prot. 3642/1, date 22.07.2020 mbi Departamentet përgjegjëse për programet e studimit të FSHR.</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjise.</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve</i> <i>-Takimi me studentët, stafin akademik, sekretarinë mësimore.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ bazuar në takimin me drejtues të institucionit, takimi me stafin akademik, sekretarinë mësimore si dhe takimi me studentët mendon se: FSHR informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve edhe nëpërmjet Web-it. Po ashtu në orën e parë studentët marrin informacion të detajuar nga pedagogët e lëndëve për syllabusin përkatës ku shprehen qartë: kreditet, kodin lëndor, raporti leksion/ seminar/ laborator/ praktik, temat, literaturë bazë dhe literaturën e rekomanduar, format e kontrollit dhe vlerësimit, detyrimet për lëndën (projekte, detyra kursi), niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës etj <i>Ref.31. Rregullore e Departamentit të Shkencave Biomjekesore dhe Humane, Vendim Nr. Prot. 3642/1, date 22.07.2020 mbi</i>



	<i>Departamentet përgjegjëse për programet e studimit të FSHR.</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë.</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve</i> <i>Ref.14. Plan i mesimor 2023-2024, MP në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport";</i> <i>Ref. 20. Dosja e Program/Syllabus</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e karrierës, NJSBC, Kurrikulave.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e karrierës, NJSBC, zyrën e Kurrikulave GVJ konstatohet se institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës nëpërmjet funksionimit të Zyrës së karrierës, duke ju ardhur në ndihmë të gjithë studentëve që vazhdojnë dhe që kanë përfunduar studimet në UST/FSHR, për të arritur potencialin e tyre maksimal dhe për të mirëorientuar në tregun e punës. Zyra e karrierës mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar për ndjekjen e karrierës së tyre profesionale si dhe për t'i njoftuar me mundësi punësimi dhe aktivitete të edukimit në vazhdim që organizohen nga UST si Panairin e Punës. <i>Ref. 23.3. Tabele përmbledhese me institucionet bashkepunuese, për programin e studimit dhe për praktiken profesionale.</i> <i>Ref.29. Kalendar i aktiviteteve FSHR për vitet 2023-2024.</i> <i>Ref.34. Te dhena tabelore për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve.</i> <i>Ref.35. Tabele përmbledhese me institucionet bashkepunuese, për programin e studimit dhe për praktiken profesionale. (tab 5)</i> <i>Ref. 36. Te dhena tabelore për punësimin e studentëve. http://alumni.ust.edu.al/</i> <i>Ref.37. Relacion i aktivitetit të zyrës së keshillimit dhe karrierës.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamentit, stafin akademik, studentët, zyrën e karrierës, NJSBC, Kurrikulave.</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidentoi që studentët informohen hollësisht dhe gjerësisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimi, aktiviteti jashtë kurrikular, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse. Praktika profesionale ofrohet sipas marrëveshjeve me Federatat dhe Klubet

	Sportive. Në funksion të studentëve është dhe biblioteka dhe shërbimet e sekretarisë. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij në fillim të çdo viti akademik. <i>Ref.30. Manuali i Studentit.</i> <i>Ref.30.1. Udhezues për përdorimin e sistemit Pitagora.</i> <i>Ref. 24. Lista e Marreveshjeve Nderkombetare dhe Kombetare.</i> <i>Ref.24.1. Marreveshje Bashkepunimi me Federatën Shqiptare të Futbollit, Tirane.</i> <i>Ref.24.2. Marreveshjet me Klubet Sportive për organizimin e Praktikave Profesionale.</i> <i>Ref.23.5. Te dhena Tabelore për infrastrukturën; Labororet.</i> <i>Ref.23.5.1. Te dhena për infrastrukturën.</i> <i>Ref.23.6. Te dhena Tabelore për infrastrukturë mbështetëse për procesin mësimor.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore, Karrierës, NJSBC</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidenton që studentët e UST/FSHR informohen për të gjitha nëpërmjet platformës elektronike (Pitagora) që është një sistem i brendshëm menaxhimi të dhënash ku studentët logohen individualisht me të dhënat e tyre personale dhe mund të marrin çdo informacion që lidhet me performancën e tyre akademike. Në këtë sistem ata futen nëpërmjet faqes zyrtare të Universitetit. Ky akses në platformën Pitagora është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë, nga çdo ambient ku mund të ndodhen. <i>Ref.30. Manuali i Studentit.</i> <i>Ref.30.1. Udhezues për përdorimin e sistemit Pitagora.</i> <i>Ref.23.5. Te dhena Tabelore për infrastrukturën; Labororet.</i> <i>Ref.23.5.1. Te dhena për infrastrukturën.</i> <i>Ref.23.6. Te dhena Tabelore për infrastrukturë mbështetëse për procesin mësimor.</i> <i>-Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, studentët, zyrën e sekretarisë mësimore, Karrierës, NJSBC.</i>
Konkluzione	UST/FSHR dhe programi i studimit i siguron infrastrukturën e nevojshme studentëve për marrjen e informacionit të hollësishëm lidhur me organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të

	<i>praktikave profesionale, literaturën e nevojshme dhe strukturat ndihmëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, takimi me përgjegjesit e departamentit, stafin akademik, zyrën e sekretarisë mësimore, GVJ konstaton se FSHR disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. Këto të dhëna (statistika të përgjithshme për numrin e studentëve, ndarjen e tyre sipas programit, notat, studentët e diplomuar dhe të dhënat e punësimit të tyre) mblidhen, përditësohen dhe analizohen nga departamenti, Sekretaria Mesimore, Drejtoria e kurrikulave, Zyra e Karrierës dhe Alumnit. <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit të Kineziologjisë</i> <i>Ref.18.1. Model Analize vjetore të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit.</i> <i>Ref.37. Relacion i aktivitetit të zyrës së keshillimit dhe karrierës.</i> <i>Ref.32.8. Model Raporti i Analizës Vjetore të NJSBC 2023-2024.</i> <i>Ref.29. Kalendari i aktiviteteve FSHR për vitet 2023-2024.</i> <i>-Takimi me përgjegjesit e departamentit, stafin akademik, studentet, zyrën e sekretarisë mësimore, Karrierës, NJSBC</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo	GVJ takimi në zyrën e sekretarisë mësimore konsaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. FSHR ruan në regjistrat fizikë dhe elektronikë gjithë dokumentacionin vjetor për regjistrimin, ngrirjen e studimeve dhe

mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

largimin e studentëve gjatë ciklit të studimit. Ky informacion është i ruajtur në kohë reale në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave nga sekretaria mësimore si dhe në dosjen e secilit student në sekretari, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ASCAL-it apo QSHA-së.

GVJ bazuar në informacionin e marrë në institucion , u informua se numri i studentëve është në rritje nga viti në vit , por kuotat e miratuar nga MAS nuk janë plotësuar sipas tabelës së mëposhtme:

FSHR MP	Kuota të miratuara nga MAS	Studentë të Regjistruar	Studentë Kalues	Studentë të Diplomuar
Viti 2023-2024	50	23	16	16
Viti 2024-2025	50	30	-	-
Viti 2025-2026	50	-	-	-

GVJ sygjeron : Të punohet më shumë me marketingun e këtij programi për të bërë të mundur plotësimin e kuotave të miratuara nga MAS.

Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit të Kineziologjise

Ref.18.1. Model Analize vjetore të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit.

Ref.38. Percjellje raporti vjetor për vitin 2023, në nivel

Rektorati. Ref.39. Tabelat Permbledhese Institucionale

-Takimi me zyrën e sekretarisë mësimore, Karrierës, NJSBC.

Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Sekretaria mësimore disponon të gjithë dokumentacionin e duhur për arritjet e studentëve në bazë të moduleve dhe cikleve akademike. Ky informacion është në formë fizike me nënshkrimet e personave sipas karakteristikës së dokumentit dhe i ruajtur elektronikisht në sistemin e brendshëm ku secili person i autorizuar ka akses të kufizuar në bazë të pozicionit të punës.

Nga takimi me sekretarinë dhe bazuar në rregulloren e sekretarisë GVJ konstaton se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit janë të sigurta dhe

	lehtësisht të verifikueshme nga stafi akademik, sekretaria mësimore dhe vetë studenti në llogarinë e tij. <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës,</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport,</i> <i>Ref.31.1. Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë</i> <i>-Takimi me studentët, stafin akademik, sekretarinë mësimore.</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Puna e sekretarisë mësimore është në monitorim të vazhdueshëm nga administratori i institucionit në kuadër të hierarkisë dhe mbikqyrjes. Nga auditimi i GJVJ u vërejt që në regjistrat dhe procesverbale ku janë të vendosura notat nuk kishte korigjime. Nga takimi me studentët ata shprehen se janë të kënaqur nga puna e zyrës së sekretarisë mësimore, respektimi i orareve dhe korrektësia e punës nga punonjësit e sekretarisë. <i>Ref.18. Model Analizë vjetore e Departamentit të Kineziologjisë</i> <i>Ref.18.1. Model Analizë vjetore të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit.</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor për vitin 2023, në nivel Rektorati.</i> <i>Ref.32.8. Model Raporti i Analizës Vjetore të NJSBC 2023-2024.</i> <i>-Takimi me studentët, stafin akademik, sekretarinë mësimore.</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Institucioni përpilon një raport vjetor gjithëpërfshirës të të gjitha njësive dhe programeve që ofrojnë, ku mes të tjerash analizohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sygjerohen masa për përmirësim. Njësia bazë harton raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. <i>Ref.18. Model Analizë vjetore e Departamentit të Kineziologjisë</i> <i>Ref.18.1. Model Analizë vjetore të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit.</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor për vitin 2023, në nivel Rektorati.</i> <i>Ref.32.8. Model Raporti i Analizës Vjetore të NJSBC 2023-2024.</i> <i>Ref. 32.6. Plan Veprimi i Kalendarik i NJSBC;</i> <i>Ref.32. Model Pyetësi i Studenteve 2023.</i>

	<i>Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve te Studenteve.</i> <i>Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit.</i> <i>Ref.32.3. Model Raporti I FSHR-se i NJSBC.</i> <i>-Takimi me studentët, stafin akademik, sekretarinë mësimore, Zyra e Karrierës.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Institucioni garanton të dhëna statistikore të studentëve që menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Nga takimi me studentët dhe stafin akademik si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit nga GVB, GVJ konsaton se studentët përfshihen dhe angazhohen në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Paralelisht, Institucioni ka ngritur dhe Këshillin studentor. Studentët janë dhe anëtarë të komisioneve të ndryshme që Institucioni ngre (përfshirë këtu edhe procesin e akreditimit). Gjithashtu ekziston senatori i klasës i cili bën të urrën lidhëse midis studentëve dhe strukturave dhe funksiononte më së miri. Këto u konfirmuan edhe në takimin e zhvilluar me studentët. <i>Ref.1. Mendimi i Dekanit</i> <i>Ref.3. Statuti i Universitetit te Sporteve</i> <i>Ref.4. Plani Strategjik FSHR 2021-2026,</i> <i>Ref.31. Rregullore e Departamentit te Shkencave Biomjekesore dhe Humane, Vendim Nr. Prot. 3642/1, date 22.07.2020 mbi Departamentet pergjegjese per programet e studimit te FSHR.</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit te Kineziologjise.</i>

	<i>Ref.32.4. Vendimi i Ngritjes se NJSBC. Vendim Senati 749 dt.19.05.2021.</i> <i>Ref. 32.5.</i> <i>https://ust.edu.al/epcontent/uploads/2021/05/Manuali-NJSBC.pdf</i> <i>-Takimi me studentët dhe stafin akademik</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstaton se FSHR përdor sistemin vlerësimit të performancës së stafit akademik, pyetësorëve me studentët për vlerësimin e stafit akademik dhe lëndëve sipas programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Përpunimi i të dhënave bëhet nga NJSBC dhe përfundon me hartimin e Raportit të Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve, i cili u komunikohet organeve drejtuese, individualisht secilit prej pedagogëve, dhe më pas përgjegjësit të njësisë bazë për të analizuar rezultatet dhe marrjen e masave përkatëse. Studentët konfirmuan që vlerësojnë stafin akademik. Ata marrin pyetësorin me email dhe e plotësojnë. Kjo është procedura që raportuan dhe përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Stafi akademik vlerësohet dhe nga Drejtuesi i Departamentit. Kjo u konfirmua dhe në takimin me stafin akademik. Nga takimi me studentët dhe stafin akademik si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konsaton se studentët janë pjesë e disa komisioneve në të cilën japin kontributin e tyre (Senati Akademik, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Këshilli i Etikës, Këshilli Studentor, Grupit të GVB). <i>Ref.32. Model Pyetesori i Studenteve 2023.</i> <i>Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve te Studenteve.</i> <i>Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit.</i> <i>Ref.32.3. Model Raporti I FSHR-se i NJSBC</i> <i>Ref.32.4. Vendimi i Ngritjes se NJSBC. Vendim Senati 749 dt.19.05.2021</i> <i>Ref. 32.5. https://ust.edu.al/ep-content/uploads/2021/05/Manuali-NJSBC.pdf</i> <i>Ref. 32.6. Plan Veprimi i Kalendarik i NJSBC.</i> <i>-Takimi me studentët, stafin akademik.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e	Bazuar në statutin e UST-ës zëri dhe përfshirja e studentëve në procese të rëndësishme akademike garantohej me pjesëmarrjen e tyre në organe dhe komisione të rëndësishme si NJSBC, GVB, Komisionet e Përhershme, Senat Akademik etj. Institucioni ka hartuar dy pyetësorë për vlerësimin e stafit akademik nga studentët, njëri për lëndën dhe tjeri për institucionin. Kjo është një procedurë standarde që UST përdor për të përfshirë studentët në

kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	përmirësimin e mësimdhënies. Stafi akademik raportoi se ata vlerësohen nga studentët. Ata raportuan se në vija të përgjithshme informohen për rezultatet. Studentët konfirmuan që vlerësojnë stafin akademik. Ata marrin pyetësorin me email dhe e plotësojnë. Nga takimi me studentët, stafin akademik dhe shqyrtimi i dokumnetacionit, GVJ konstaton se studentët ndjehen të përfaqësuar dhe se Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to. <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë;</i> <i>Ref.32.7. Rregullore e NJSBC;</i> <i>Ref.32. Model Pyetësori i Studenteve 2023.</i> <i>Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve të Studenteve.</i> <i>Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit.</i> <i>Ref.32.3. Model Raporti i FSHR-se i NJSBC.</i> <i>Takimi me studentët, stafin akademik.</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët kanë të përshkruara të drejtat e tyre në dokumentat rregullatorë dhe ato respektohen me rigozitet nga stafi akademik, administrativ, sekretaria dhe drejtuesit e institucionit. Ata kanë të drejtë të njihen me tezën e tyre të provimit me qëllim komentimin e rezultatit dhe kanë të drejtë të ndjekin të gjitha shkallët e ankimimit për rivlerësim. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. UST ka marrëveshje me AADF (Fondin Amerikan të Zhvillimit, CleanScore) për zbatim të sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit. Me qëllim vlerësimi të jetë i drejtë dhe i pa anshëm, përdoret sekretimi i provimeve. Sekretimi u konfirmua nga studentët dhe pedagogët dhe kjo është një pikë e fortë e Institucionit. <i>Ref.3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport;</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës;</i>



	<i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë.</i> <i>Ref. 23.7. Të dhëna Tabelore për Bashkëpunimin me AADF për korrigjimin elektronik. (Tabela nr 5).</i> <i>Ref.12. Model Teze e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar.</i> <i>Takimi me studentët, stafin akademik</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e UST/FSHR, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të universitetit. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura (NJSBC, GVB), por dhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me studentët, stafin akademik, Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Karrierës, GVJ konstatoi se FSHR ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. (Sekretaria Mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës dhe Alumni). <i>Ref.3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport;</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë;</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.</i>

	<i>Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit.</i> <i>Ref.32.3. Model Raporti I FSHR-se i NJSBC</i> <i>Takimi me studentët, stafin akademik, Sekretaria Mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve i përshkruar në Kriterin 1 është funksional dhe i përshtatshëm. Studentët u shprehën të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për pjesëmarrjen në konferenca shkencore, aktivitete të ndryshme shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët. <i>Ref.3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport;</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë;</i> <i>Ref. 36. Te dhena tabelore per punesimin e studenteve.</i> http://alumni.ust.edu.al/ <i>Ref.37. Relacion i aktivitetit të zyrës së këshillimit dhe karrierës;</i> <i>Ref.32.8. Model Raporti i Analizes Vjetore të NJSBC 2023-2024;</i> <i>Ref.26. Mbi miratimin e projekteve shkencore për vitin akademik 2023-2024;</i> <i>Takimi me studentët stafin akademik, Sekretaria Mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës.</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me studentët dhe Zyrën e Karrierës, GVJ konstaton se UST/FSHR, zyra e Karrierës dhe Alumnit, ju ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Nga takimi me studentët dhe stafin akademik u evidentua se një pjesë e vetë stafit akademik i kanë punësuar ish studentët e tyre apo i kanë referuar tek kolegët e tyre për punësim në klinikat private. <i>Ref.37. Relacion i aktivitetit të zyrës së këshillimit dhe karrierës;</i> <i>Ref. 36. Te dhena tabelore per punesimin e studenteve.</i> http://alumni.ust.edu.al/

	<i>Ref.34. Te dhena tabelore per cilesine ne hyrje dhe dalje te studenteve.</i> <i>Ref.4.3. Studimi i Tregut te punes.</i> <i>Takimi me studentet, stafin akademik, Zyra e Karrierës</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me studentët dhe Zyrën e Karrierës, GJV konstatoi se zyra e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. Ajo mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data-bazë të të dhënave të cilat përditësohen çdo vit. <i>Ref.37. Relacion i aktivitetit të zyrës së këshillimit dhe karrierës;</i> <i>Ref. 36. Te dhena tabelore per punesimin e studenteve.</i> http://alumni.ust.edu.al/; <i>Ref.34. Te dhena tabelore per cilesine ne hyrje dhe dalje te studenteve.</i> <i>Ref.4.3. Studimi i Tregut te punes.</i> <i>Takimi me studentët Sekretaria Mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës</i>			
Konkluzione	<i>UST/FSHR ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Në funksion të informimit të studentëve janë struktura të posaçme si (Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, Sekretaria mësimore, Drejtoria e Standarteve dhe e Sigurimit të Cilësisë, Zyra e IT). Institucioni ka vënë në shërbim të studentëve Zyrën e Këshillimit të Karrierës realizon informimin e studenteve dhe të gjitha shërbimet që nga momenti i rregjistrimit deri në diplomim. Zyra e Këshillimit të Karrierës asiston në gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ajo mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data-bazë të të dhënave të cilat përditësohen çdo vit. Këto të dhëna u vihen në dispozicion edhe departamenteve, duke i ndihmuar ata të kenë kontakte të vazhdueshme midis studentëve të diplomuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit, stafin, studentët, NJSBC, referencat e vëna në dispozicion, mendon se, FSHR, e ka të ngritur dhe funksional, Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe nëpërmjet NJSBC-së, siguron zbatimin e një strategjie institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. FSHR organizon trajnime për personelin akademik në lidhje me mësimdhënien në mënyrë që të realizohen metoda të ndryshme dhe inovative për mësimdhënien. Përfaqësuesit e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave raportuan se organizojnë aktivitete trajnuese, ndërsa përfaqësuesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin raportuan se cdo fundviti bëhen ndryshime kurrikulare rreth 20% sipas udhëzimeve të MAS(pavarësisht se kurrikula e MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport nuk është ndryshuar pasi ka dy vite që është hapur ky program studimi) <i>Ref.32.7. Rregullore e NJSBC;</i> <i>Ref.32.4. Vendimi i Ngritjes së NJSBC. Vendim Senati 749 dt.19.05.2021;</i> <i>Ref.32. Model Pyetësori i Studenteve 2023.</i> <i>Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve të Studenteve.</i> <i>Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit.</i> <i>Ref.32.3. Model Raporti i FSHR-së i NJSBC;</i> <i>Ref.32.5.https://ust.edu.al/ep-content/uploads/2021/05/Manuali-NJSBC.pdf</i> <i>Ref. 32.6. Plan Veprimi i Kalendarik i NJSBC.</i>

	<i>Takimi me studentët, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Referuar informacionit të paraqitur në GVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se NJSBC pranë UST-ës mbështetur në rregulloren për këtë njësi synon përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, për të përmbushur standartet e cilësisë të përcaktuar nga UST/FSHR, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. Përmirësimi i cilësisë realizohet nëpërmjet: kontrollit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ vërejtë se kontakti dhe monitorimi i vijueshmërisë së procesit mësimor nga përgjegjësi i departamentit, pyetësorët e studentëve, formularët e performances akademike janë mekanizma që identifikojë në vazhdimësi cilësinë e mësimdhënies. Stafi akademik raportoi se ata vlerësohen nga studentët me anë të pyetësorëve anonim. Pedagogët informohen për rezultatet e pyetësorëve dhe vlerësimeve përkatëse. <i>Ref.32. Model Pyetësori i Studenteve 2023.</i> <i>Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve të Studenteve.</i> <i>Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit.</i> <i>Ref.32.3. Model Raporti i FSHR-se i NJSBC;</i> <i>Ref.32.5. https://ust.edu.al/ep-content/uploads/2021/05/Manuali-NJSBC.pdf</i> <i>Ref. 32.6. Plan Veprimi i Kalendarik i NJSBC.</i> <i>Takimi me studentët, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Burimeve Njerëzore.</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Nga takimi me studentët, stafin akademik dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se FSHR garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies (pyetësori për studentët), të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve. Studentët shprehën se ata kanë marrë pjesë në pyetësorë (on line) ku janë shprehur lirshëm dhe në mënyrë anonime lidhur me mësimdhënien për pedagogët dhe lëndët e programit të studimit. Kjo është një procedurë standarde që UST përdor për të përfshirë studentët në përmirësimin e mësimdhënies. <i>Ref.32. Model Pyetësori i Studenteve 2023.</i> <i>Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve të Studenteve.</i> <i>Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i</i>

	Universitetit. Ref.32.3. Model Raporti I FSHR-se i NJSBC; Ref.32.5. https://ust.edu.al/ep-content/uploads/2021/05/Manuali-NJSBC.pdf Ref. 32.6. Plan Veprimi i Kalendarik i NJSBC Takimi me studentët, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie GJV konstaton se njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë çdo fund viti akademik publikon raportin vjetor i cili përmban edhe plan masa për përmirësimin e treguesve me vlerë të ulët. Në institucion, herë pas here lind nevoja e ngritjes së grupit të auditimit për problematika të ndryshme në monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit. Në çdo situatë të tillë grupi auditues harton një raport i cili i përcillet titullarit të institucionit. Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit të Kineziologjise Ref.18.1. Model Analize vjetore të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit. Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve të Studenteve. Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit. Ref.32.3. Model Raporti I FSHR-se i NJSBC Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	UST/FSHR në kuadër të planit të përgjithshëm strategjik rëndësi dhe vend të veçantë i kushton cilësisë së procesit mësimor si edhe të gjitha shërbimeve mbështetëse për realizimin e këtij procesi. I gjithë stafi akademik është i informuar, merr pjesë dhe dëshmon angazhim maksimal në proceset e sigurimit të cilësisë akademike. GJV konstatoi gadishmërinë e Institucionit për mbështetje për stafin akademik, si në funksion të realizimit të një procesi mësimor cilësor (kryesisht në infrastrukturë), ashtu edhe në funksion të kualifikimit shkencor (nxitja për pjesëmarrje në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, nxitja dhe mbështetja financiare për të botuar artikuj në revista me faktor të lartë impakti-Scopus, monografi dhe botime të ngjashme shkencore).

	<i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit te Kineziologjise</i> <i>Ref.18.1. Model Analize vjetore te Fakultetit te Shkencave te Rehabilitimit.</i> <i>Ref.26. Mbi miratimin e projekteve shkencore per vitin akademik 2023-2024;</i> <i>Ref.28. Pasqyrat Financiare Vjetore 2023, te dhenat Tabelore.</i> <i>Ref. 28.1. Relacion mbi pasqyren Financiare Vjetore te UST-es. Takimi me studentët, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron e vlerëson përmes njësive të posatëshme periodikisht programet e studimit. Ky sektor në zbatim të ligjit të Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore zhvillon në fund të çdo semestri pyetësorët studenteve për matjen performancës dhe cilësinë e mësimdhënies. Sistemi i sigurimit të cilësisë funksion në rang institucional dhe ka njësi të veçanta në çdo njësi kryesore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë 80/2015 dhe Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë (VKM 531/11.09.2018), institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e UST dhe në rregulloren e FSHR. Gjatë guidës në institucion GJVJ u informua se në mënyrë të vazhdueshme, realizohet një pyetësor anonim me studentët, me disa rubrika për mësimdhënien, programin, korrektësinë e stafit, ky vlerësim menaxhohet nga, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

	Ref.3. Statuti i Universitetit te Sporteve; Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport; Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve; Ref.8. Rregullore e FSHR-ës; Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë; Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati. Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit te Kineziologjise Ref.18.1. Model Analize vjetore te Fakuktetit te Shkencave te Rehabilitimit. Ref.32. Model Pyetensori i Studenteve 2023. Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve te Studenteve. Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit. Ref.32.3. Model Raporti I FSHR-se i NJSBC; Ref.32.5.https://ust.edu.al/ep-content/uploads/2021/05/Manuali-NJSBC.pdf Ref. 32.6. Plan Veprimi i Kalendarik i NJSBC Takimi me studentët, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GJV konstaton se FSHR ka të ngritur dhe e mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë duke përfshirë dhe studentët si pjesë e NJSBC, GVB. GJV konsaton se NJSBC e UST-ës ku FSHR është pjesë e saj, siguron zhvillimin e cilësisë së arsimit dhe ka hartuar një Plan Strategjik të Zhvillimit të UST-ës për periudhën 2021-2026 dhe një plan strategjik për Kërkimin Shkencor në Rritjen e Cilësisë së Arsimit të Lartë për periudhën 2021-2025. Ref.3. Statuti i Universitetit te Sporteve; Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport; Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve; Ref.8. Rregullore e FSHR-ës; Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë; Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.

	<i>Ref.4. Plani Strategjik FSHR 2021-2026, Misioni, pika 2;</i> <i>Ref.4.1. Plani Strategjik UST 2021-2026, Objektivat;</i> <i>Ref.4.2. Plani Strategjik UST 2021-2025, Objektivat, Kerkimi Shkencor.</i> <i>Takimi me stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Në përputhje me detyrimet ligjore për vlerësimin e jashtëm të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit, UST i është nënshtruar përdikisht akreditimeve me ekspertë vendas dhe të huaj të aprovuara nga ASCAL. Të gjitha vlerësimet janë konsideruar si një hap për përmirësime të mëtejshme dhe janë respektuar e plotësuar në kohë gjithmonë rekomandimet e grupeve audituese. Bazuar në konstatimet dhe detyrat që dalin nga kontrollet dhe mënyrat e tjera të verifikimit të fakteve NJSBC harton raporte periodike si dhe një raport vjetor i cili është transparent dhe bëhet i njohur për stafin, studentët dhe për të tretët. Kështu nga shqyrtimi i dokumnetacionit GVI konstatoi se nga Vendimi nr.2, datë 07.01.2022 i Bordit të Akreditimit, ASCAL rezulton se UST është akredituar pozitivisht për 6 vite me afat përfundimtar me datë 06.01.2028. Ndërsa programi i Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport akreditohet për herë të parë. <i>Ref.32. Model Pyetësi i Studenteve 2023.</i> <i>Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve të Studenteve.</i> <i>Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit.</i> <i>Ref.32.3. Model Raporti i FSHR-se i NJSBC;</i> <i>Ref.32.5. https://ust.edu.al/ep-content/uploads/2021/05/Manuali-NJSBC.pdf</i> <i>Ref. 32.6. Plan Veprimi i Kalendarik i NJSBC</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.</i> <i>Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të	Institucioni ka një hierarki funksionimi dhe mbikqyrje që mban nën kontroll të vazhdueshëm zbatimin me rigorozitet të rregulloreve. Dekani, përgjegjësi i departamentit dhe përgjegjësi i programit, përfaqësuesi i NJSBC në Fakultet koordinonë dhe mbikqyrin vazhdimisht zbatimin e programit mësimor. Institucioni organizon


parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	audite të brendshme të drejtuar nga NJSBC për dokumentacionin e çdo programi dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport;</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë;</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit te Kineziologjise</i> <i>Ref.18.1. Model Analize vjetore te Fakuktetit te Shkencave te Rehabilitimit</i> <i>Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>			
Konkluzione	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e UST-ës dhe në rregulloren e institucionit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit dhe funksionon me plan pune vjetor dhe ushtron një seri aktivitete bazuar në rregulloren NJSBC.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit	Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe takimi në institucion GJV konstaton se të gjitha gjetjet e vlerësimit vjetor janë pjesë e raportit vjetor të NJSBC, i cili i vihet në dispozicion rektoratit. Këto të dhëna janë bazë për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe vetëvlerësimit. Gjithashtu institucioni kryen një vlerësim të brendshëm vjetor gjithëpërfshirës që përfshin gjithë programet, njësitë kryesore/bazë dhe ndihmëse që e paraqet në një raport vjetor

të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	të Universitetit i cili shërben si një historik për performancën institucionale. Ky raport i përvitshëm dërgohet konform legjislacionit edhe në MAS. Institucioni prej kohësh ka bashkëpunim me aktorë të jashtëm për të vlerësuar performancën e stafit akademik dhe administrativ dhe institucionit në përgjithësi. Në përfundim të këtij kontrolli ky grup harton një raport që më pas i dërgohet institucionit dhe shërben si një udhërrëfyes i rëndësishëm sidomos për vitin pasardhës akademik. <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport;</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë;</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit te Kineziologjise</i> <i>Ref.18.1. Model Analize vjetore te Fakuktetit te Shkencave te Rehabilitimit</i> <i>Takimi me përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ konstatoi se në raportin vjetor të NJSBC përfshihen rezultatet e pyetësorëve që shoqëruar me grafik për çdo pyetje të drejtuar stafit ose studentëve duke vlerësuar përqindjet e çdo alternative për përgjigjet si dhe duke komentuar rezultatet. Në fund të paraqitjes së rezultateve të pyetësorëve bëhet një analizë mbi gjetjet dhe shprehen mundësitë e korrigjimit apo përmirësimit dhe rekomandohen plan masash me synim rritjen e cilësisë akademike. Të gjitha këto të dhëna paraqiten të detajuara në raportet vjetore dhe analizat vjetore periodike (për aktivitetin akademik e shkencor) në nivel të FSHR dhe UST. <i>Ref.3. Statuti i Universitetit te Sporteve;</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport;</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë;</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.</i>



	<i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit te Kineziologjise</i> <i>Ref.18.1. Model Analize vjetore te Fakuktetit te Shkencave te Rehabilitimit;</i> <i>Ref.32. Model Pyetesori i Studenteve 2023.</i> <i>Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve te Studenteve.</i> <i>Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit.</i> <i>Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Metodat e përdorura nga UST për vlerësimin dhe realizimin me efektivitet të procesit mësimor janë të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Vlerësimi i studentëve bëhet në format e përcaktuara ligjore të cilat janë inkorporuar në Statutin, Rregulloren e përgjithshme dhe në programet e veçanta të studimit. Për vlerësimin e studentëve përdoren të gjitha format e vlerësimit përfshirë këtu testimet, seminarët, detyra kursi, projektet, prezantime, sipas lëndëve specifike dhe nga pedagogu i lëndës i cili mban shënimet e veta për vlerësimet gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar. Këtë e referojnë studentët dhe pedagogët gjatë bashkëbisedimit në takimin në institucion. Të gjithë studentët gjatë kryerjes së praktikave të tyre mbikqyren nga infermierët mbikqyrës nga të cilët kërkohet vazhdimisht opinion në lidhje me frekuentimin, paraqitjen dhe cilësinë e punë së studentëve në ambientin klinik. <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë;</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit te Kineziologjise</i> <i>Ref.18.1. Model Analize vjetore te Fakuktetit te Shkencave te Rehabilitimit;</i> <i>Ref.32. Model Pyetesori i Studenteve 2023.</i> <i>Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve te Studenteve.</i> <i>Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit.</i>

	<i>Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	GVJ konstaton se FSHR në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor Metodën e tërthorta: Sondazhe nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, ku ata mund të shprehin në kushte anonimiteti për të gjitha këto procese (Pyetësori i studentëve në FSHR, Pyetësori I Vlerësimit I studentëve për lëndët e programit të studimit, Pyetësori i Vlerësimit të studentëve për UST). Stafit mësimdhënës i kërkohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik raporte mbi problematikat e hasura gjatë procesit akademik, gjithashtu një feedback merret edhe nga mbikqyrësit e praktikave në lidhje me mirëfunksionimin dhe angazhimin e studentëve në shërbimet profesionale. <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë;</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit te Kineziologjise</i> <i>Ref.18.1. Model Analize vjetore te Fakultetit te Shkencave te Rehabilitimit;</i> <i>Ref.32. Model Pyetesori i Studenteve 2023.</i> <i>Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve te Studenteve.</i> <i>Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit.</i> <i>Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Konkluzione	<i>UST përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e herë pas herë të programit të studimit. Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetësorët e studentëve për procesin e mësimdhënies, si dhe analizat periodike të punës në nivel departamenti. Vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik. Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, rezultatet e proceseve të anketimit të studentëve paraqiten në Raportin vjetor të institucionit dhe në raportin vjetor të NJSBC.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit, në përbërje të NJSBC ka nga një anëtar nga çdo Fakultet të UST-ës dhe një përfaqësues të unionit studentor. Megjithatë në funksion të procesit akademik ka një angazhim të shumëfishtë që përfshin personelin e pritjes, përgjegjësin e programit, sekretarinë mësimore si dhe drejtuesit e njësive bazë që janë në kontakte të vazhdueshme me studentët dhe stafin e çdo programi studimi. <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport;</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës;</i> <i>Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me aktorë të rëndësishëm të jetës akademike, Dekanin e FSHR, Përgjegjësit e Departamenteve, Përfaqësues të Stafit Akademik, me Grupin e vlerësimit të brendshëm, me përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Karrierës. Në këto takime doli në pah organizimi i mirë i punës së përditshme, koordinimi dhe angazhimi optimal në procesin e akreditimit, motivimi, përgjegjësia dhe entuziazmi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë. GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin të bashkëpunues dhe të koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve;</i>

	<i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë;</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit te Kineziologjise</i> <i>Ref.18.1. Model Analize vjetore te Fakuktetit te Shkencave te Rehabilitimit;</i> <i>Ref.32. Model Pyetesori i Studenteve 2023.</i> <i>Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve te Studenteve.</i> <i>Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit.</i> <i>Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë. Ne vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit “Master profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”, njësia bazë garanton përfshirjen e të gjithë strukturave në mënyrë transparente, të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit, sic është personelit akademik, ndihmes akademik e administrativ. <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit te Kineziologjise</i> <i>Ref.18.1. Model Analize vjetore te Fakuktetit te Shkencave te Rehabilitimit;</i> <i>Ref.32. Model Pyetesori i Studenteve 2023.</i> <i>Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve te Studenteve.</i> <i>Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit.</i> <i>Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin	GVJ konstatoi se lidhur me përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është respektuar liria dhe etika akademike si dhe kuadri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetsori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmangët cdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studenteve. <i>Ref.3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.32. Model Pyetesori i Studenteve 2023.</i> <i>Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve të Studenteve.</i> <i>Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit.</i> <i>Ref.32.7. Rregullore e NJSBC.</i> <i>Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës, GVJ konstatoi se pjesë aktive e procesit të vlerësimit shpesh janë dhe përfaqësues të institucioneve të bashkëpunimit të cilët japin sugjerime në lidhje me organizimin e procesit mësimor, përmirësimin e literaturës, organizimin e orëve laboratorike dhe praktikave klinike. <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport;</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës;</i> <i>Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit.</i> <i>Ref.32.7. Rregullore e NJSBC.</i> <i>Ref. 36. Te dhena tabelore për punësimin e studenteve.</i> http://alumni.ust.edu.al/. <i>Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në statutin, rregulloren dhe planin strategjik 2021-2025 të UST/FSHR, është ngritur dhe funksionon. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit. Prania e studenteve si anëtarë të komisionit krijon mundësinë e bashkëveprimit me studentët për të përfutur ndjesinë</i>



	<i>e tyre dhe për të bërë efektiv kontributin e tyre në sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstatoi se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit. Statuti, Rregulloret, vendime të senatit etj, gjenden të publikuara në këtë faqe të hapur për publikun e interesuar. Informacionet përcillen dhe në formë shkresore në njësinë kryesore dhe njësitë bazë ku janë të aksesueshme nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët. <i>Ref.3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë;</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport.</i> <i>Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ konstatoi se NJSBC realizon pyetësorët institucional në fund të cdo semestri në mënyrë elektronike, të cilët publikohen rregullisht duke rritur transparencën. Në hartimin e raportit NJSBC respekton lirinë akademike dhe kodin e etikës si dhe kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale (ligji 9887/10.03.2008 ndryshuar me ligjin 48/2012). Raporti i monitorimit u komunikohen strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studenteve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individëve. <i>Ref.3. Statuti i Universitetit të Sporteve;</i>

	<i>Ref.32. Model Pyetesori i Studenteve 2023.</i> <i>Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve te Studenteve.</i> <i>Ref.32.2. Model raporti mujor i NJSBC tek Rektori i Universitetit.</i> <i>Ref.32.7. Rregullore e NJSBC.</i> <i>Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë çdo fund viti akademik publikon raportin vjetor i cili i përcillet senatit akademik. Ky raport i dorëzohet Rektorit i detajuar, ndërsa publikohet një përmbledhje e tij pa emra konkret. Në përgjithësi, pas çdo procesi vlerësimi që shoqërohet me gjetje dhe detyra për njësitë /strukturat repsektive, hartohet plani i masave për përmbushjen e detyrimeve të lëna. <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport;</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë;</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.</i> <i>Ref.18. Model Analize vjetore e Departamentit te Kineziologjise</i> <i>Ref.18.1. Model Analize vjetore te Fakuktetit te Shkencave te Rehabilitimit</i> <i>Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstatoi se UST për të siguruar monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, mbledh Senatin Akademik të UST-ës për të monitoruar implementimin e përmirësimit të procesit mësimor, ku hartohen dhe një raport vjetor. Në këtë raport shqyrtohen problematikat dhe veprimet që duhen të ndërmerren për të siguruar përmirësimin. GVJ konstatoi se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport;</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve;</i>

	<i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë;</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.</i> <i>Ref.32. Model Pyetesori i Studenteve 2023.</i> <i>Ref.32.1. Model Raporti i Fokus Grupeve te Studenteve.</i> <i>Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	UST për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit organizon veprimtari të parashikuara në Plan veprimin per Rritjen e Cilesise se Arsimit te Larte dhe bën analizë në rang institucioni, dekanati, departamenti dhe kjo është një pikë e fortë e institucionit. Përfaqësuesi i NJSBC, stafi akademik si dhe përgjegjësit e programeve luajnë rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin për sigurimin e cilësisë në programin mësimor. GVJ konstaton se institucioni organizon veprimtari periodike me personelin akademik dhe studentët me qëllim informimin, asistencën dhe trajnimin për një pjesëmarrje aktive dhe efektive në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke i informuar dhe ndërgjegjësuar për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. <i>Ref.3. Statuti i Universitetit te Sporteve;</i> <i>Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MP në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport;</i> <i>Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve;</i> <i>Ref.8. Rregullore e FSHR-ës;</i> <i>Ref. 31.1. Rregullore e Departamentit të Kineziologjisë;</i> <i>Ref.38. Percjellje raporti vjetor per vitin 2023, ne nivel Rektorati.</i> <i>Ref.4. Plani Strategjik FSHR 2021-2026, Misioni, pika 2;</i> <i>Ref.4.1. Plani Strategjik UST 2021-2026, Objektivat;</i> <i>Ref.4.2. Plani Strategjik UST 2021-2025, Objektivat, Kerkimi Shkencor.</i> <i>Takimi me studentët, përgjegjësit e departamenteve, stafin akademik, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e kurrikulës.</i>
Konkluzione	<i>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit.</i>

	Rezultatet e vlerësimit të brendshëm, raportohen prane rektoratit dhe dekanateve te fakulteteve lidhur me pikat e forta dhe dobësite e tyre. GVJ thekson se raportimet e kryera nga UST/FSHR janë raporte përshkruese dhe analitike. Këto raporte shoqërohen me plane masash dhe adresimin e problematikave të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional/ i Shkencave/Arteve/ Program i Integruar i Nivelit të Dytë në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti I Sporteve të Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i Studimit Master Profesional “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” është një program që ekziston vetëm në UST (program unik kombëtar).
2. Qëndrueshmëria e stafit akademik, e cila lidhet me: cilësinë e stafit akademik përsa i përket titujve/gradave, formimit profesional dhe pothuajse 90% e stafit është me kontratë të plotë-definitive.
3. Marrëveshjet e bashkëpunimit të larmishme kombëtare dhe ndërkombëtare.
4. Dokumentimi nga institucioni i përfitimeve të marrëveshjeve të bashkëpunimit.
5. Kërkesa në rritje nga ana e studentëve për programin e studimit.
6. Laboratorë të pajisur me aparatura bashkëkohore.
7. Mundësitë e gjera për punësim që programi i studimit ofron. Pothuajse të gjithë studentët synojnë punësimin në vend si pasojë e mungesës së profesionistëve dhe kërkesës së lartë.

Pika të dobëta

1. Rregulloret e Njesisë Kryesore, Bazë e Programit të Studimit kanë mangësi në lidhje me elementët që janë specifike për programet e ciklit të dytë të studimeve dhe nuk janë të përditësuara.
 - Për shembull, në rregulloren e FSHR-së nuk janë të përfshira programet e ciklit të dytë.
 - Rregullorja e DK-së nuk përfshin informacion në lidhje me rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e personelit ndihmës akademik në realizimin e procesit mësimor dhe përmbushjen e objektivave të lidhura.
 - Rregullorja e programit të studimit nuk specifikon rolin e personelit ndihmës akademik dhe mungojnë të dhëna për numrin e tij në program.
 - Rregullorja e Njesisë Bazë, Departamenti i Kinziologjisë, përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” nuk ka informacion të përcaktuar lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve për programe të ciklit të dytë të studimeve.
2. Mungesa e kodeve të lëndëve në planin mësimor të programit.



3. Plani mësimor i programit nuk përfshin module për rritjen e kapaciteteve kërkimore-shkencore të studentëve.
4. Literatura në syllabuset e lëndëve të programit është e vjetër (10-15 viteve të fundit) pavarësisht se programi ka një vit që ofrohet.
5. Hapësira të pakta për laboratorin dhe bibliotekën (pavarësisht paisjeve me aparatura bashkëkohore) (Standarti IV/1, Kriteri 5; 6; 7; Standarti IV/3, Kriteri 1).
6. Numri i pakët i stafit ndihmës akademik (një staf ndihmës akademik) (Standarti IV/1, Kriteri 6).
7. Mungesa e një liste të plotë të kontratave me subjekte private të rehabilitimit.
8. Mungesa e një strategjie të qartë për mundësitë e mobiliteteve studentore, për programet e ciklit të dytë Master Profesional me kohëzgjatje njëvjeçare.

Rekomandime/sygjerime

1. Përditësim të të gjitha Rregulloreve me elementët që kanë lidhje me zhvillimin dhe garantimin e cilësisë së programit të studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” (Standarti II/2, Kriteri 2; Standarti II/3, Kriteri 3; Standarti III/5, Kriteri 1).
2. Përcaktimi i kodeve të lëndëve të planit mësimor të programit të studimit (Standarti II/1, Kriteri 8).
3. Përditësim të literaturës bazë të lëndëve të programit të studimit me literaturë bashkëkohore (Standarti II/4, Kriteri 5).
4. Rritjen e hapësirave, sipërfaqeve të kabineteve (m2) për laboratorin dhe bibliotekën (pavarësisht paisjeve me aparatura bashkëkohore) (Standarti IV/1, Kriteri 5; 6; 7; Standarti IV/3, Kriteri 1).
5. Rritjen e numrit të stafit ndihmës akademik, nisur dhe nga rritja e numrit të studentëve vit pas viti (Standarti II.2/, Kriteri 2; Standarti IV/1, Kriteri 5; 7).
6. Sigurimin e listës së plotë të kontratave me subjekte private të rehabilitimit.
7. Të krijohet një strategji e qartë për mobilitetin e studentëve që ndjekin programet e studimit Master Profesional (Standarti II/4, Kriteri 4).
8. Të punohet më shumë me marketingun e këtij programi për të bërë të mundur plotësimin e kuotave të miratuara nga MAS (Standarti V/4, Kriteri 2).



Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master "Physical Therapy Rehabilitation in Sports" provided by the Higher Education Institution "University of Sports of Tirana "

Strengths and affirmations

1. The Master's Professional Program "Physiotherapeutic Rehabilitation in Sports" is a program that exists only at UST (a unique national program).
2. The stability of the academic staff, which is related to: the quality of the academic staff regarding titles/degrees, professional training, and almost 90% of the staff has a full, permanent contract.
3. Diverse national and international cooperation agreements.
4. Documentation by the institution of the benefits gained from the cooperation agreements.
5. Increased demand from students for the study program.
6. Laboratories equipped with modern equipment.
7. Broad employment opportunities offered by the study program. Almost all students aim for employment locally due to the lack of professionals and high demand.

Weaknesses

1. The regulations of the Main Unit, Basis Unit and the Regulation of the Study Program, have shortcomings related to elements that are specific to second-cycle study programs and are not up-to-date.
 - For example, the regulations of FSHR do not include second-cycle programs.
 - The regulation of the DK does not include information about the role, duties, and responsibilities of academic support staff in the realization of the teaching process and the fulfillment of related objectives.
 - The program regulation does not specify the role of academic support staff, and there is a lack of data regarding their number in the program.
 - The regulation of the Main Unit, the Department of Kinesiology, responsible for the Master's Professional Program in "Physiotherapeutic Rehabilitation in Sports," does not have specific information related to the general and specific admission criteria, transfer, and equivalence of studies for second-cycle programs.
2. The lack of course codes in the curriculum of the program.
3. The program's curriculum does not include modules for enhancing students' research and scientific capacities.



4. The literature in the syllabi of the program's courses is outdated (10-15 years old), even though the program has been offered for a year.
5. Limited space for the laboratory and library (despite being equipped with modern apparatus) (Standard IV/1, Criterion 5; 6; 7; Standard IV/3, Criterion 1).
6. The small number of academic support staff (only one academic support staff member) (Standard IV/1, Criterion 6).
7. The absence of a complete list of contracts with private rehabilitation entities.
8. The lack of a clear strategy for opportunities for student mobility for one-year Professional Master's programs.

Recommendation

1. Update all Regulations with elements related to the development and assurance of the quality of the Master's Professional Study Program in "Physical Therapy Rehabilitation in Sports" (Standard II/2, Criterion 2; Standard II/3, Criterion 3; Standard III/5, Criterion 1).
2. Determination of course codes in the curriculum of the study program (Standard II/1, Criterion 8).
3. Update the core literature of the program's subjects with contemporary literature (Standard II/4, Criterion 5).
4. Increase the space and surface area of the laboratories and library rooms (m²), regardless of the equipment with modern apparatus (Standard IV/1, Criterion 5; 6; 7; Standard IV/3, Criterion 1).
5. Increase the number of academic support staff, due to the increase in the number of students year by year (Standard II/2, Criterion 2; Standard IV/1, Criterion 5; 7).
6. Ensure a complete list of contracts with private rehabilitation entities.
7. Create a clear strategy for student mobility for those enrolled in the Master's Professional Study Programs (Standard II/4, Criterion 4).
8. Increase efforts on marketing this program to ensure the fulfillment of quotas approved by the Ministry of Education and Sports (Standard V/4, Criterion 2).



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

